



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM

Programi i integruar i studimeve të Ciklit të Dytë Master i Shkencave në:

“Drejtësi”

ofruar nga

Universiteti European i Tiranës

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

Prof.As. Dr. Artan Spahiu

PhD. Valbona Ndrepepaj

Korrik / 2025

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al

1

Tabela përmbledhëse e të dhënave të programit të integruar të studimeve të ciklit të dytë Master i Shkencave në: “Drejtësi”

1	IAL aplikues:	Universiteti European i Tiranës
2	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti i Shkencave Juridike
3	Emërtimi i programit të studimit:	Program i Integruar i Studimeve të Ciklit të dytë Master i Shkencave në: “Drejtësi”
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	Urdhër MASR Nr. 235, datë 15.07.2020
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	-
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	-
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	-
8	Cikli i studimit:	Cikli i dytë
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	5 vite akademike
10	Kreditet në total (ECTS):	300 kredite
11	Forma e studimit:	Me kohë të plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Gjuha Shqipe
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	-
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	Niveli 7 (shtatë)
17	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit:	Viti akademik 2020-2021 9 PAE / 0 PAK; Viti akademik 2021-2022 14 PAE / 2 PAK; Viti akademik 2022-2023 16 PAE / 9 PAK; Viti akademik 2023-2024 15 PAE / 10 PAK; Viti akademik 2024-2025 13 PAE / 2 PAK;
18	Numri i studentëve:	Viti akademik 2020-2021 25 studentë; Viti akademik 2021-2022 35 studentë; Viti akademik 2022-2023 28 studentë;

		Viti akademik 2023-2024 36 studentë; Viti akademik 2024-2025 38 studentë;
19	Komente / të tjera:	-

PËRMBLEDHJE E TË DHËNAVE PËR PROGRAMIN NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Qëllimi i procesit të vlerësimit të jashtëm është të japë një mendim të pavarur për shkallën në të cilën institucioni në fjalë është i përgatitur dhe i angazhuar të përmbushë me efektivitet dhe përgjegjshmëri kërkesat dhe standardet akademike të diplomave që do të lëshojë. Për të arritur në këtë gjykim, GJVJ u mbështet në shqyrtimin e Raportit të Vlerësimit të Brendshëm, në dokumentacionin bazë mbi të cilin ngrihet veprimtaria e Universitetit, dosjen e programit të studimit me dokumentacionin shoqërues, takimet e vizitat e organizuara në institucion dhe dokumentacionin shtesë që institucioni përcolli në ASCAL. Vlerësimi i programit të studimit u fokusua në analizën e programit, në shqyrtimin e sillabuseve: vendosjen e objektivave të të mësuarit, kompetencat që synohen të fitohen, rrugët nëpërmjet të cilave fitohen (metodat e mësimdhënies), literaturën bazë dhe atë shtesë, mënyrat e vlerësimit të dijeve, përcaktimin e krediteve, kompetencën e stafit akademik, aktivitetin kërkimor - shkencor dhe atë ekstrakurrikular, kujdesin ndaj studentit, këshillimin e karrierës dhe tutoriatin, praktikën profesionale, bashkëpunimin ndërkombëtar dhe projektet, etj. Ky program është licensuar për herë të parë në vitin 2020, sipas UMASR Nr. 235, datë 15.07.2020, nga riorganizimi i programit Bsc. "Juridik i Përgjithshëm". Universiteti Europian i Tiranës (këtu e në vijim me shkurtimin UET) e ushtron aktivitetin e tij bazuar në Ligjin Nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë" si dhe të akteve të tjera nënligjore mbi arsimin e lartë, Statutin e Universitetit, Rregulloren bazë të tij dhe të akteve të tjera rregullatore të institucionit. UET është institucion i arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë, i akredituar me Vendim të Bordit të Akreditimit Nr. 12, datë 07.04.2017, dhe pas riorganizimit me Vendimin e Bordit të Akreditimit Nr. 46, datë 05.07.2019. Gjithashtu, UET ka marrë edhe akreditim institucional 5 vjeçar nga Quality Assurance Agency for Higher Education (QAA).

Fakulteti i Shkencave Juridike, Politike dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare është një nga njësitë kryesore të UET-së, në përbërje të të cilit është edhe Departamenti i Shkencave Juridike si njësi bazë e tij. Një nga programet e ciklit të dytë të studimeve që ofron ky departament është Master i Shkencave në Drejtësi, objekt i këtij procesi akreditimi. Ky program studimi zgjat pesë vite akademike, me kohë të plotë, ofrohet në gjuhën shqipe dhe në përfundim të tij studenti merr 300 kredite ECTS.

PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Pasi UET ka aplikuar për nisjen e procedurës së akreditimit të programit Master i Shkencave në "Drejtësi", ASCAL bazuar në *"Manualin për Procedurat dhe Afatet për Vlerësimin e Cilësisë nëkuadër të Akreditimit të Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe programeve të studimit 2017"*, ka përzgjedhur dhe kontraktuar dy vlerësues të jashtëm për të shqyrtuar dokumentacionin e përcjellë nga Universiteti, për të kryer vizitën në institucion dhe për të hartuar raportin e vlerësimit të jashtëm. Grupi i vlerësimit të jashtëm ka në përbërje: **Prof As.Dr. Artan Spahiu dhe PhD. Valbona Ndrepepaj**, profesorë në Universitetin e Tiranës. Gjatë vizitës në institucion dhe procedurës lidhur me vlerësimin e jashtëm, ekspertët e jashtëm u asistuan nga përfaqëuesja e ASCAL Znj. Majlinda Demireli. Ekspertëve të jashtëm iu vendos në dispozicion gjithë dokumentacioni i dorëzuar nga institucioni për vlerësim, fizikisht dhe përmes platformës e-ASCAL, si dhe dokumentacioni shtesë përsa institucioni solli. Gjatë vizitave ekspertëve iu vendos në dispozicion një sallë mbledhjesh për të kryer të gjitha takimet sipas agjendës së planifikuar. Meqë gjatë vizitës, u evidentua nevoja për dokumentacion shtesë, ky dokumentacion i kërkuar nga ekspertët u vu në dispozicion pas vizitës në institucion. Në vlerësimin që ka bërë, GJV ka qenë objektiv, i paanshëm dhe ka vlerësuar mbi bazën e dokumentacionit të sjellë nga IAL për këtë program studimi që i nënshtrohet akreditimit.

GJV ka përcaktuar shkallën e përmbushjes për secilën fushë në 4 nivele sipas sistemit të standarteve të vendosur nga ASCAL për këtë qëllim. GJV ka marrë kontakt sipas axhendës 2 ditore të vizitës në institucion. GJV falenderon UET për bashkëpunimin dhe disponibilitetin e treguar gjatë vizitës për këtë proces akreditimi.

Duke vlerësuar arritjet dhe punën pozitive të bërë për këtë program studimi, në fund të këtij raporti, janë dhënë edhe rekomandimet për institucionin si dhe është paraqitur analiza SWOT për programin e studimit që është objekt riakreditimi, me qëllimin e mirë për të ndihmuar në përmirësime të mundshme rregullatore, strukturore, organizimi dhe kompetencash për përmbushjen e standarteve dhe detyrimeve ligjore e statutoe, si dhe arritjen e objektivave të kërkuar për një program studimi të ciklit të dytë Master i Shkencave në standarte bashkëkohore dhe të krahasueshëm me programe të ngjashme të ofruara nga institucione të arsimit të lartë perëndimore.



Handwritten signature in blue ink, likely of the official responsible for the report.

Universiteti Europian i Tiranës, është njohur me Draft-Raportin e Vlerësimit të Jashtëm më datë 25.06.2025, përmes sistemit AMS, si dhe në formë zyrtare me anë të shkresës me Nr. 89/16 Prot, datë 25.06.2025. Universiteti Europian i Tiranës, më datë 03.07.2025, njofton, me anë të shkresës me Nr.118/6 Prot, datë 02.07.2025 “Kthim përgjigje shkresës suaj nr. 89/16 prot, datë 25.06.2025”.

Ekspertët e vlerësimit u njohën me këto komente dhe japin argumentat si më poshtë:

1. Në lidhje me sqarimin/komentin për konkluzionin e paraqitur në draft-RVJ, për përmbushjen e standartit I.2:

GVJ ka arritur në këtë konkluzion, bazuar në shqyrtimin e dokumentacionit të dosjes së vetvlerësimit. Në kushtet kur dhe nga përfaqësuesit e IAL-së pranohet si konkluzion, vlerësojmë që konkluzioni të mbetet në RVJ. **Raporti nuk ndryshon.**

2. Në lidhje me sqarimin/komentin e standartit I.3, kriteri 4;


GVJ gjykon se analiza e *përfitimeve në funksion të realizimit të programit të studimit* nuk i referohet vetëm realizimit të praktikave mësimore, por edhe psh rritjes së mundësive për realizimin e kërkimeve shkencore; organizimit të eventeve të përbashkëta; përmirësimit dhe pasurimit të kurrikulës, etj. Në këto kushte mendojmë së sugjerimi i paraqitur në draft RVJ, në konkluzionin e përmbushjes së standartit I.3, duhet të qëndrojë. **Raporti nuk ndryshon.**

3. Në lidhje me sqarimin/komentin e Standartit II.1, kriteri 3;

GVJ duke marrë në konsideratë komentin e instiucionit, dhe bazuar në Evidencën nr.14.2 “Plani mësimor i programit të integruar të ciklit të dytë “Master i Shkencave në Drejtësi”, Detyrimi përmbyllës “*Praktika Profesionale*” është paraqitur e ndarë në dy module, që zhvillohen në semestrin 1, me 7 ECTS dhe në semestrin 2, me 8 ECTS. Në total 15 kredite, në përputhje me Kurrikulën e Programit Mësimor. Për rrjedhojë, pranohet sqarimi i bërë nga Institucioni. **Raporti në këtë pikë ndryshon.**

4. Në lidhje me sqarimin/komentin e Standartit II.2, kriteri 2;

GVJ merr në konsideratë komentin e institucionit, si dhe vendimin e Senatit Akademik të UET, Nr.4, datë 14.02.2025 “Për miratimin e disa ndryshimeve në Dokumentin B.I. “Mbi Praktikën Profesionale”, pika B.I.4.2, paragrafi 2, për programin e integruar, ku parashikohet se: “*Praktika në programet e integruara të ciklit të dytë ka 8 ose 9 kredite, pra një detyrim prej 200 ose 225 orë punë për studentin, nga të cilat 8 orë zhvillohen në auditor (4 seanca nga 2 orë), mbi njohuri të përgjithshme të zhvillimit profesional dhe të karrierës, q që bëhen nga pedagogu Keshillues i karrierës ose me ekspertë të fushës, 152 ose 172 orë në institucion dhe 40 ose 45 orë punë individuale, në varësi të numrit të krediteve të praktikës*”.



Më këtë ndryshim të bërë me vendim të Senatit Akademik, nuk ka më mospërputhje midis Planit Mësimor të programit të studimit PIND “MSH në Drejtësi” (ku praktika profesionale rezulton me 8 kredite) dhe aktit rregullator të praktikës profesionale – Dokumentit B.I.4.2. Për rrjedhojë, pranohet sqarimi i bërë nga Institucioni. **Raporti në këtë pikë ndryshon.**

5. Në lidhje me sqarimin/komentin e Standartit IV.1, kriteri 6;

Në kushtet kur dhe nga përfaqësuesit e IAL-së pranohet si konkluzion, madje theksohet se e kanë paraprirë në zbatim këtë rekomandim, vlerësojmë që konkluzioni të mbetet në RVJ. **Raporti nuk ndryshon.**

6. Në lidhje me sqarimin/komentin e Standartit IV.2, kriteri 3;

GVJ merr në konsideratë komentin e instiucionit dhe bëhen ndryshimet e nevojshme në konstatimin e bërë në RVJ, tek Kriteri 3, i standartit IV.2 dhe tek konkluzionet e këtij standarti. **Raporti në këtë pikë ndryshon.**



Vlerësimi i Programit të Integruar të studimeve të ciklit të dytë Master i Shkencave në “Drejtësi”

I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi I.1	
Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij e që synon ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare, si dhe në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të tij.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare dhe synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	Programi i Studimit të Ciklit të Dytë Master i Shkencave në “Drejtësi” (program i integruar i studimeve) është program studimi që ofrohet për një kohëzgjatje 5 vjeçare, me 300 ECTS. Ky program ofrohet nga Departamenti i Shkencave Juridike (DSHJ), pranë Fakultetit të Shkencave Juridike, Politike, dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare (FSHJPMN) në Universitetin Europian të Tiranës (UET) dhe në përfundim studenti pajiset me diplomë universitare “Master i Shkencave” në “Drejtësi”. Programi nuk bie ndesh me interesat kombëtare. Programi mbështetet në misionin e universitetit, që është ofrimi i një edukimi cilësor për studentët, duke përkthyer rezultatet e kërkimit shkencor të vlefshëm në procesin mësimor, dhe t’i shërbejë dijes së shoqërisë shqiptare përmes mësimdhënies, kreativitetit, përdorimit të arritjeve më të mira shkencore, si dhe partneriteteve me tregun e punës dhe ato ndërkombëtare. Programi i studimit “Master i Shkencave në Drejtësi”, kontribuon në zhvillimin e shoqërisë, përmes tri shtyllave të misionit të arsimit të lartë publik: kërkim shkencor, edukim, si dhe shërbim ndaj publikut. <i>(Evidenca nr.2 “Statuti i UET-së”, neni 6)</i>
Kriteri 2. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.	Programi i integruar i studimeve të ciklit të dytë, Master i Shkencave në “Drejtësi”, është program i riorganizuar nga programi Bachelor në “Juridik i Përgjithshëm”, me 180 kredite, sipas Urdhërit MASR nr.235, datë 15.07.2020, dhe ofrohet nga Departamenti i Shkencave Juridike. Ky program është hartuar në përputhje me qëllimin dhe misionin e UET-së, duke u mbështetur tërësisht në Statutin dhe Planin Strategjik të UET-së.



	Ai ofrohet në përputhje me fushën e veprimtarisë të UET-së dhe Fakultetit të Shkencave Juridike Politike dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare. Ai ka si synim formimin e specialistëve në fushën e Drejtësisë, duke u fokusuar në zhvillimin e njohurive dhe kompetencave që lidhen drejtpërdrejt me këtë fushë. Kjo pasqyrohet në kurrikulën e programit të studimit dhe në planin mësimor. <i>Evidenca nr.2 "Stauti i UET-së;</i> <i>Evidenca nr.3 "Plani strategjik UET 2021- 2025";</i> <i>Evidenca nr.14 "Kurrikula e Programit MSHD";</i> <i>Evidenca nr.14.2 "Plani mësimor i programit të integruar të ciklit të dytë Master i Shkencave në Drejtësi";</i> <i>Evidenca nr.54.1 "Urdhëri i MASR mbi riorganizimin e programit të studimit";</i>
Kriteri 3. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim, të Statutit dhe Rregullores së Institucionit dhe në përputhje me fushat e drejtimet akademike të Institucionit.	Programi i studimit Master i Shkencave në "Drejtësi" hartohet dhe ofrohet në përputhje dhe në zbatim të Statutit të UET-së, Rregullores së UET-së, Planit Strategjik UET 2021-2025, si dhe Planit Strategjik "Për zhvillimin e programit të studimit të ciklit të dytë "Master i Shkencave" në "Drejtësi", ku parashikohet se IAL ka si qëllim të zhvillojë një program të integruar të studimeve për ciklin e dytë "Master i Shkencave" në fushën e Drejtësisë, duke garantuar cilësi të lartë akademike, përgatitje profesionale të studentëve, dhe një angazhim të fortë me kërkesat e tregut të punës, nevojat shoqërore dhe zhvillimet ligjore kombëtare dhe ndërkombëtare. Programi i studimit, bazuar në Statutin e UET-së, është hartuar dhe ofrohet në përputhje me fushat e drejtimet akademike të Institucionit. <i>Evidenca nr.2 "Stauti i UET-së;</i> <i>Evidenca nr.3 "Plani strategjik UET 2021- 2025";</i> <i>Evidenca nr.4 "Plani strategjik për zhvillimin e programit të studimit";</i>
Kriteri 4. Programi i studimit hartohet e zhvillohet në përputhje me strategjitë kombëtare të zhvillimit, interesit kombëtar dhe prijet globale	Programi i studimit Master i Shkencave në "Drejtësi" është hartuar dhe zhvillohet duke pasur parasysh interesat kombëtare dhe strategjitë kombëtare të zhvillimit. Ky program është zhvilluar në përputhje me Strategjinë e mëparshme Kombëtare për Zhvillim e Integrim 2015-2020. (Shih "Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2015-2020")

të zhvillimit mbështetur në dokumentacionin përkatës vendas dhe atë ndërkombëtar.	Programi vazhdon të zhvillohet në përputhje me Strategjitë: -Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim Evropian 2022-2030, ku ndër fushat me prioritet për integrimin e vendit në BE pëcaktohen <i>“Forcimi i pavarësisë, efikasitetit dhe llogaridhënies së institucioneve gjyqësore; Rritja e luftës kundër korrupsionit; Rritja e luftës kundër krimit të organizuar; Garantimi i mbrojtjes së të drejtave të njeriut, përfshirë të drejtat mbi pronën”</i>. -Strategjia Ndërsektoriale për Drejtësinë 2021-2025 e cila ka në fokus që në fazën e parë <i>“Përqasjen e sistemit të drejtësisë në Shqipëri me standardet më të mira evropiane”</i>. Gjithashtu, programi i studimit Master i Shkencave në “Drejtësi” është hartuar dhe zhvillohet duke pasur parasysh jo vetëm interesat kombëtare por edhe prirjet e zhvillimit global dhe interesat e dokumentave strategjike më të rëndësishëm në panoramën ndërkombëtare nga ku rezultojnë lidhja e së drejtës me çështjet globale si paqja, drejtësia dhe barazia gjinore. Këto dokumente strategjike kanë ndihmuar në skicimin e një programi studimi i cili formon juristë të aftë për t’iu përgjigjur nevojave të një skenari kombëtar dhe global në zhvillim të vazhdueshëm.			
Konkluzione	<i>GVJ konstaton se UET ofron programin e integruar të studimit të ciklit të dytë Master i Shkencave në “Drejtësi”, në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij, duke synuar në ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare, si dhe në përputhje me strategjitë kombëtare të zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të tij.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi I.2

Programi i studimit është në përputhje me fushën akademike të njësive kryesore dhe bazë përgjigjëse për programin e studimit në institucion.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e	Universiteti Evropian i Tiranës (UET) është ndër institucionet e para të arsimit të lartë privat të krijuara në Shqipëri, sipas VKM nr.636, datë 20.09.2006 “Për dhënien e lejes për hapjen e shkollës

duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë.	së lartë universitare jopublike “Universiteti European i Tiranë”. Fillimisht i emërtuar “Fakulteti Juridik”, Fakulteti i Shkencave Juridike, Politike dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare, ku përfshihet edhe programi i studimit, objekt vleresimi, ka një eksperiencë shumë vjeçare dhe është një nga fakultetet themelues të UET-it. Stafi akademik i Departamentit të Shkencave Juridike është i kualifikuar dhe i përmbush kriteret ligjore të kërkuar nga kuadri ligjor për arsimin e lartë, si njësi bazë që ofron këtë program studimi (neni 25, pika 4 e Ligjit Nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”). Për vitin 2024-2025, ky Departament ka gjithsej 11 pedagogë, nga të cilët 8 janë pedagogë efektiv (PAE) nga ku: - 3 kane titullin “Profesor i Asociuar”; - 4 kanë gradën Dr; - 1 është Dr. në process; dhe 3 pedagogë me kontratë (PAK) nga ku: - 1 ka gradën Dr.; - 2 Asistent Lektorë me Msc; UET përgjithësisht i ka kapacitetet dhe burimet e duhura akademike për këtë program studimi. Stafi akademik i angazhuar në këtë program studimi përbëhet nga personel akademik i kategorisë “Profesor”, “Lektor” “Asistent Lektor” i punësuar si PAE dhe PAK. <u>Si mangësi</u> konstatohet angazhimi në mësimdhënie edhe i stafit akademik (PAE dhe PAK) me kualifikimin “Master Shkencor”, çka bie ndesh me kërkesat e nenit 59, pika 6 Ligjit Nr. 80/2015, ku parashikohet se: “Personeli akademik, që angazhohet në mësimdhënie, duhet të ketë së paku kualifikim të ciklit pasardhës”. Për vitin akademik 2023-2024 dhe 2024-2025, mbi 70% e këtij programi studimi mbulohet nga personeli akademik efektiv i fushës përkatëse, duke përmbushur detyrimet ligjore por edhe duke siguruar cilësinë e mësimdhënies.
--	--

	<i>Evidenca Nr.02 "Tabelat përmbledhëse për aneks-RVB", tabela 1, 2;</i> <i>Evidenca Nr.02 "Tabelat përmbledhëse për aneks-RVB", tabela 4;</i>
Kriteri 2. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.	Fakulteti i Shkencave Juridike, Politike dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare, pranë të cilit ofrohet programi i studimit Master i Shkencave në "Drejtësi", zhvillon veprimtarinë akademike dhe shkencore në përputhje me fushën studimore të përgjithme dhe specifike të këtij programi studimi. Ky fakultet përfshin fusha studimi: Diplomë e Integruar në Drejtësi (DIND), Master i Shkencave në të Drejtë Publike, Master i Shkencave në të Drejtë Private. Vetë emërtimi i Fakultetit përmbledh të gjitha fushat e përgjithshme të studimit, në të cilat ofrohen programet specifike të studimit. Ky program studimi ofrohet duke u referuar në nivelin 7 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve dhe në përfundim të tij lëshohet diploma përkatëse bazuar në Udhëzimin Nr. 11, datë 02.04.2020 të MASR "Për përcaktimin e përmbajtjes dhe formës së suplementit të diplomës". <i>Evidenca nr.0.2 "Tabelat përmbledhëse për aneks RVB", Tabela 3.b. Të dhëna për programet që ofrohen në Fakultet;</i>
Kriteri 3. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë, përgjegjëse për programin e studimit. Në rastet e programeve ndërdisiplinore, të paktën një nga njësitë bashkëpunuese duhet ta sigurojë këtë përputhje.	Programi Masteri i Shkencave në "Drejtësi" ofron njohuri të thelluara teorike dhe praktike në fushën e të drejtës. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit është në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë, të Departamentit të Shkencave Juridike, përgjegjëse për këtë program studimi. <i>Evidenca nr.0.1- "Tabelat përmbledhëse për aneks RVB";</i> <i>Tabela nr. 2 dhe Tabela 6.1;</i> <i>Evidenca nr.1 "Mendimi i Dekanit";</i> <i>Evidenca nr.7 "Rregullore e Programit të Studimit DIND";</i>
Kriteri 4. Në rastet kur institucioni ofron program "Master profesional" në një drejtim specifik, jashtë profilin të institucionit, cilësia e tij garantohet nga institucionet partnere.	Nuk aplikohet



Kriteri 5. Institucioni i arsimit të lartë ofron trajnime profesionale të mëtijshme për studentët e diplomuar në bashkërendim me punëdhënësit.	Pranë Universitetit Europian të Tiranës, funksionon Zyra e Këshillimit të Karrierës dhe Kujdesit ndaj Studentit. Nëpërmjet kësaj zyre krijohen mundësi konsultash, orientimesh dhe trajnimesh të ndryshme. Shërbimet kryesore që ofron zyra janë: a. Këshillim të vazhdueshëm për studentët, duke i mbështetur në hartimin e CV, Letrës së motivimit & Korrespondencën me zyrat e Burimeve Njerëzore të kompanive/organizatave; letrës së falenderimit, letrës së refuzimit të pozicionit, (trajnime online dhe offline); b. Këshillim të studentëve për faza të intervistës së punës; c. Përgatit kalendarin e eventeve të lidhura me industrinë – Open Day dhe panairët e punës etj; <i>Evidenca nr.12 Dokumenti E.VII Mbi funksionimin e Zyres se Keshillimit te Karrieres dhe Kujdesit ndaj Studentit;</i>			
Konkluzione	<i>Programi i studimit të Ciklit të Dytë Master i Shkencave në “Drejtësi” është në përputhje të plotë me fushën akademike të njësisë kryesore dhe asaj bazë.</i> <i>UET përgjithësisht i ka kapacitetet dhe burimet e duhura akademike për këtë program studimi, por duhet të mos angazhojë në mësimdhënie staf akademik (as PAE dhe as PAK) me kualifikimin “Master Shkencor”, pasi kjo bie ndesh me kërkesat e nenit 59, pika 6 Ligjit Nr. 80/2015.</i> <i>Zyra e Këshillimit të Karrierës dhe Kujdesit ndaj Studentit krijon mundësinë për studentët aktualë dhe ata të diplomuar (ish-studentët, pjesë e UET Alumni) që të konsultohen në mënyrë të vazhdueshme për nevojat e tyre lidhur me karrierën dhe orientimin në tregun e punës.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi I.3

Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit




të programit të studimit, në kuadër të aftësimit profesional, kërkimit shkencor dhe mobilitetit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njërive e personelit, marrjes së përgjegjësi përkatëse dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.	Brenda institucionit ekziston një marrëdhënie e ngushtë bashkëpunimi mes strukturave akademike dhe atyre administrative në nivel fakulteti dhe rektorati. UET në përgjithësi dhe në vecanti Fakulteti i Shkencave Juridike ka siguruar marrëdhënie bashkëpunimi efektive brenda institucionit për ndarjen e detyrave dhe përgjegjësi, si dhe analizës periodike të punës së tyre – këto detyra përcaktohen në: Rregulloren e UET, Rregulloren e Programit të Studimit dhe aktet e tjera të brendshme të institucionit. Në aktet rregullatore përcaktohen roli i drejtuesit të njësisë bazë, përgjegjësit e grupit mësimor/koordinatorit të programit, si dhe detyrat e titullarit të lëndëve specifike. <i>Evidenca nr.5 "Rregullore e Universitetit European të Tiranës"; Evidenca Nr.6 "Dokumenti F.IV-F.V Mbi organizimin dhe funksionimin e Dekanatit dhe Departamentit";</i> <i>Evidenca nr.7 "Rregullore e Programit të Studimit DIND"; Evidenca Nr.36 "Vendim për emërimin e kordinatorëve të programeve të studimit";</i>
Kriteri 2. Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ose të huaj.	Në kuadër të mbarëvajtjes së realizimit të programit të studimit, nga UET janë vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me institucione që ushtrojnë veprimtari në fushën e drejtësisë, akademisë, mbrojtjes juridike, dhe administratës publike. Lidhja e marrëveshjeve ndërkombëtare zhvillohet në kuadër institucional (IAL), duke përfshirë këtu edhe programin e studimit të ciklit të dytë "Master i Shkencave" në "Drejtësi" GVJ konstaton se IAL (UET) ka marrëveshje bashkëpunimi me IAL të tjera si Uniersiteti i Camerinos, Itali, Universiteti i Prizrenit, Mitrovicës. Gjithashtu janë lidhur marrëveshje bashkëpunimi me banka, si Banka e Tiranës, Banka Credins, Union Bank, si dhe me shoqëri të sigurimit si INSIG, UNION Bank. Po kështu ka marrëveshje me institucione publike si Kuvendi i Shqipërisë, Bashkia e Tiranë, Komisionineri kundër Diskriminimit, Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas, INSTAT, etj., si dhe me persona juridike private si BALFIN, Dhoma e Tregtisë dhe Industrisë Durrës, Halimi Foundation Institute,

	Shoqata e Bankave, Shoqata e Siguruesve të Shqipërisë, etj. Fokusi i marrëveshjeve ka qenë realizimi i objektivave të programin e studimit, kryesisht kryerja e praktikave të studentëve, shkëmbimi i stafit, përmirësimi i kurrikulës. <i>Evidenca nr.32 - Lista e subjekteve dhe institucioneve bashkëpunuese për programin e studimit;</i> <i>Evidencat nr.34.1... deri 34.32;</i>
Kriteri 3. Për realizimin e programit të studimit, institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme me institucione, institute kërkimore, kompani të fushës përkatëse për realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës apo stazhit etj, dhe bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, për realizimin e kërkimeve shkencore dhe mobilitetit të personelit akademik dhe studentëve.	Në funksion të realizimit të praktikave profesionale, institucioni bashkëpunon me një sërë aktorësh dhe institucioneve. UET është përfshirë në shumë projekte zhvilluese akademike dhe shkencore, veçanërisht në kuadrin e projekteve europiane të arsimit të lartë (gjithsej 52 projekte gjatë viteve 2020-2024). Këto projekte synojnë zhvillimin e stafit akademik, mobilitetin e pedagogëve dhe studentëve, aplikimin e standarteve europiane të cilësisë, organizimin e konferencave shkencore të përbashkëta, përkthime dhe botime akademike dhe pedagogjike nga autorë të njohur ndërkombëtarisht, si dhe pajisjen e mjediseve mësimore dhe laboratorëve, etj. Nëpërmjet marrëveshjeve të krijuara është e mundur shkëmbimi i stafit për dhënien e mësimi në universitetet homologe, si dhe shkëmbimi i studentëve përmes programit Erasmus+. <i>Evidenca Nr. 28.1 Projektet UET;</i> <i>Evidenca nr.32 - Lista e subjekteve dhe institucioneve bashkëpunuese për programin e studimit;</i> <i>Evidencat nr.34.1... deri 34.32;</i>
Kriteri 4. Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit.	Për zbatueshmërinë apo përfitimin nga marrëveshjet e lidhura, nga UET, Fakulteti apo Departamenti përgjegjës <u>nuk ka analiza të detajuara të paraqitura në raporte periodike të përfitimit nga marrëveshjet e bashkëpunimit</u> (Pavarësisht se në RVB evidentohet se ka raporte periodike për këtë qëllim). Të dhëna të detajuara raportohen vetëm për mobilitetin e stafit dhe studentëve në kuadër të projekteve ndërkombëtare. <i>Evidenca Nr.43.1 "Të dhëna në lidhje me mobilitetet e stafit dhe studentëve 2020-2025";</i>

14

Konkluzione	<i>Brenda UET ekziston një marrëdhënie e ngushtë bashkëpunimi mes strukturave akademike dhe atyre administrative në nivel fakulteti dhe rektorati. Në aktet rregullatore përcaktohen roli dhe përgjegjësitë e strukturave për organizimin dhe ofrimin e programit të studimit. Në kuadër të mbarëvajtjes së realizimit të programit të studimit, nga UET janë vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me institucione që ushtrojnë veprimtari në fushën e drejtësisë, akademisë, mbrojtjes juridike, dhe administratës publike, kryesisht për realizimin e praktikës së studentëve por jo vetëm.</i> <i>UET është përfshirë në shumë projekte zhvilluese akademike dhe shkencore, veçanërisht në kuadrin e projekteve europiane të arsimit të lartë. Për zbatueshmërinë apo përfitimin nga marrëveshjet e lidhura, nga UET, Fakulteti apo Departamenti përgjegjës duhet të hartohen analiza dhe raporte të detajuara për çdo fushë të bashkëpunimit të parashikuar në marrëveshje dhe jo vetëm për mobilitetin e stafit dhe studentëve.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË CIKLIT TË DYTË

Standardi II.1	
Programi i studimit organizohet në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore kombëtare në fuqi dhe akteve të brendshme rregullatore.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit, veprimtaritë formuese, të	Programi i studimit Master i Shkencave në “Drejtësi” përmban elementë që respektojnë standartet më të mira kombëtare dhe ndërkombëtare të kurrikulës universitare. Elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit, veprimtaritë formuese dhe

vlerësuara në kredite, janë përcaktuar qartë në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe me Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).	kreditet e secilës lëndë janë përcaktuar qartë në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe me Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS). Programi i studimit “Master i Shkencave në Drejtësi” ka një kohëzgjatje 5 vjeçare, të cilës i përkojnë në total 300 kredite. Forma e studimit është me kohë të plotë. Mesatarisht për çdo vit student fiton 60 kredite (në vitin e dytë 61 dhe në vitin e pestë 59 kredite), duke respektuar kërkesat e VKM Nr. 41, datë 24.1.2018 “Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë”, pik 2.1, gërma (c), ku parashikohet se: “<i>Sasia mesatare e punës së kryer gjatë një viti studimesh në arsimin e lartë, nga një student me kohë të plotë, është 60 kredite ose 1 500 orë mësimore pune të studentit, të cilat përfshijnë orë në auditor dhe orë pune të pavarur të tij</i>”. Programi i studimit detajohet sipas planit mësimor, i cili përkthen çdo lëndë specifike në orë dhe kredite. Kjo ngarkesë përkthehet në total 7500 orë, nga të cilat 2927 orë mësimore në auditor dhe 4573 orë pune të pavarur të studentit. <i>Evidenca Nr.14 “Kurrikula e programit MSH “Drejtësi”; Evidenca nr.14.2 “Plani mësimor i programit të integruar të ciklit të dytë “Master i Shkencave në Drejtësi”;</i>
Kriteri 2. Programi i studimit synon formimin e shprehive të veçanta në larmi të gjerë profesionale, jep njohuri të përpunuara në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës, zhvillon njohuri, aftësi dhe kompetenca të përpunuara në një fushë akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të	Programi i studimit, 5-vjeçar, “Master i Shkencave në Drejtësi” synon formimin e shprehive të veçanta në një gamë të gjerë profesionistësh dhe specialitetesh, si avokatia, noteria, këshillimi juridik, sistemi gjyqësor. Nëse i referohemi “Planit strategjik për zhvillimin e programit të studimit të ciklit të dytë “Master i Shkencave” në “Drejtësi” (program i integruar i studimeve)” (Ref.Nr.4), misioni i programit të ciklit të dytë të studimit, “Master i Shkencave” në “Drejtësi” është të ofrojë një arsimim të kualifikuar dhe të thelluar në fushën e Drejtësisë, duke kontribuar në zhvillimin e njohurive teorike dhe praktike të studentëve, për t’i përgatitur ata për të qenë liderë dhe profesionistë të kualifikuar në sistemin ligjor kombëtar dhe ndërkombëtar (Pika 2 “Misioni”)

paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.	Objektivat e Programit të Studimit paraqiten në Rregulloren e Programit të Studimit, pika 3.3, ku parashikohet se “Programi i studimit synon ta pajisë studentin me: a. Njohje, thellim, zgjerim dhe specializim të koncepteve; b. Parapërgatitje për licencën e profesionit të rregulluar; c. Formim tematik dhe jopanoramik apo historik; d. Aftësi për kërkim të avancuar, të pavarur shkencor; e. Përvetësim i literaturës kryesore të fushës së studimit; f. Stazhe, internship në rreth 50 kompani ose te punëdhënësit më të mëdhenj; g. Aftësim i plotë për zhvillim karriere, si dhe për vazhdimin e studimeve të doktoratës; h. Diplomë me origjinalitet, me karakter teorik ose empirik, produkt krijues i studentit. Të diplomuarit në këtë program studimi formohen për profesionet/mundësi punësimi të cilat janë listuar në Aneksin përkatës bashkëlidhur”; Gjithashtu, ky program studimi ofron mundësi të mëtejshme studimit në ciklin e tretë të studimeve Master Ekzekutiv ose Doktoratë. UET ka miratuar dhe parimet e ndërtimit të programit të lëndës, për programet e ciklit të dytë, në pikën A.III.4.2.1 të dokumentit “Mbi parimet e ndërtimit të programit të lëndës”. <i>Evidenca Nr.7 “Rregullore e Programit të Studimit DIND”; Evidenca nr.14.2 “Plani mësimor i programit të integruar të ciklit të dytë “Master i Shkencave në Drejtësi”;</i> <i>Evidenca Nr.39 “Dokumenti A.III “Mbi parimet e ndërtimit te programit te lendes”;</i>
Kriteri 3. Programi i studimit ka të përcaktuara ngarkesën në kredite për realizimin e praktikës profesionale dhe të detyrimeve përmbyllëse.	Sipas Kurrikulës së Programit PIND Msc “Drejtësi”, lëndët ndahën në: - A - Lëndë Bazë/ 15% -20%/56 ECTS; - B - Lëndë Karakterizuese të Programit / 45% -55% /162 ECTS; - C - Lëndë ndërdisiplinore ose Integruese /12%-15% / 44 ECTS; - D - Lëndë plotësuese /6%-8%/23 ECTS; - E - Detyrime përmbyllëse / 3% - 5% /15 ECTS;

	<i>Evidenca Nr.14 "Kurrikula e programit MSH "Drejtësi"; Evidenca nr.14.2 "Plani mësimor i programit të integruar të ciklit të dytë "Master i Shkencave në Drejtësi";</i>
Kriteri 4. Programet e ciklit të dytë "Master" në Mësuesi, që formojnë mësues të arsimit fillor janë plotësuar i ciklit të parë Bachelor në arsimin Fillor. Programet Master në Mësuesi për formimin e mësuesve të arsimit të mesëm të ulët dhe të lartë organizohen si programe të ciklit të dytë të studimeve "Master", sipas fushave përkatëse të formimit.	N / A
Kriteri 5. Programet "Master" në fushën e mësuesisë organizohen me 120 kredite dhe duhet të përmbajnë 25 për qind të krediteve në shërbim të formimit të përgjithshëm psiko-pedagogjik. Programet "Master", që formojnë mësues të së njëjtës fushë të mësuesisë, duhet të kenë së paku 80 për qind të kurrikulës me përmbajtje të ngjashme.	N / A
Kriteri 6. Forma e organizimit të studimeve, pranimi i studentëve dhe financimi në institucionet e arsimit të lartë me status të veçantë realizohen në përputhje me ligjin e arsimit të lartë dhe specifikat përkatëse, të përcaktuara në	UET-i është një institucion jo-publik i Arsimit të Lartë dhe nuk gëzon status të veçantë në kuptim të kuadrit ligjor në fuqi. Forma e organizimit të studimeve dhe pranimi i studentëve kryhet në përputhje me aktet nënligjore në fuqi.

kuadrin ligjor të ministrisë përgjegjëse për arsimin.	
Kriteri 7. Programet e studimit, të ciklit të dytë Master, që ofrohen në të njëjtën fushë studimi, si dhe me të njëjtën emërtesë, duhet të kenë përmbajtje të ngjashme në nivel, së paku 70 për qind.	Programi i studimit 5-vjeçar “Master i Shkencave në Drejtësi” ofrohet në të njëjtën fushë studimi dhe me të njëjtën emërtesë me programe të tjera studimi (PIND MSH “Drejtësi”) të cilat ofrohen në universitete të tjera. Ky program respekton një përputhshmëri prej së paku 70% në përmbajtje për të siguruar një standard të unifikuar akademik dhe profesional (<i>kriter i parashikuar në pikën 2, të nenit 86, të Ligjit nr.80/2015</i>). Ky rregull synon të garantojë që studentët të marrin njohuri dhe aftësi të krahasueshme, pavarësisht universitetit ku ndjekin programin. Megjithatë, universitetet kanë hapësirë për të ofruar 30% fleksibilitet, që mund të përdoret për të përfshirë lëndë unike ose për të adresuar nevojat specifike të tregut të punës apo kërkimit shkencor. Kjo qasje balancuese promovon një harmonizim kombëtar të programit, duke ruajtur njëkohësisht diversitetin dhe konkurrencën ndërmjet institucioneve arsimore. Harmonizimi i programit të studimit lejon mundësinë e transferimit të studentëve. <i>Evidenca nr.14.2 “Plani mësimor i programit të integruar të ciklit të dytë “Master i Shkencave në Drejtësi”;</i>
Kriteri 8. Programi i studimit shoqërohet me kodin përkatës, sipas fushës së studimit dhe klasifikimeve të bëra publike nga ministria përgjegjëse për arsimin. Më tej kryhet kodifikimi i lëndëve të programit.	Në zbatim të nenit 86, të Ligjit nr.80/2015, Këshilli i Ministrave dhe Ministria përgjegjëse për arsimin kanë hartuar aktet nënligjore përkatëse dhe në bashkëpunim me Institucionet e Arsimit të Lartë në RSH, ka filluar së pari procesin e kodifikimit të programeve bazuar në ISCED-F 2013. UET ka bërë propozimet përkatëse në lidhje me kodifikimin e programeve të studimit dhe ka marrë miratimin e kodit 75MI0421S, nga Ministria përgjegjëse për arsimin, sipas kodeve dhe programeve për të gjitha IAL. <i>Evidenca Nr.31.4 “Shkresë e MAS Nr.7381/1, datë 30.12.2024 “Njoftim mbi procesin e kodifikimit të programeve të studimit”;</i> <i>VKM Nr. 310, datë 11.05.2022; Udhëzim i MAS Nr. 31, datë 15.11.2022;</i> <i>Evidenca nr.31.3 “Shkresë e UET “Propozimet për kodifikimin e programeve të studimit;</i>

Kriteri 9. Programet e studimit mund të jenë edhe programe të përbashkëta midis dy ose më shumë institucioneve të arsimit të lartë, vendas dhe të huaj, në përputhje me legjislacionin në fuqi.	UET ka parashikuar në Planin Strategjik të Zhvillimit ofrimin e programeve të përbashkëta të studimit me institucione vendase dhe veçanërisht të huaja. Për momentin ku program studimi nuk është i përbashkët midis dy ose më shumë institucioneve të arsimit të lartë, vendas dhe të huaj, në përputhje me legjislacionin në fuqi.			
Konkluzione	<i>Elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit, veprimtaritë formuese dhe kreditet e secilës lëndë janë përcaktuar qartë në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe me Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS). Programi i studimit detajohet sipas planit mësimor, i cili përkthen çdo lëndë specifike në orë dhe kredite. Programi i studimit, 5-vjeçar, "Master i Shkencave në Drejtësi" synon formimin e shprehive të veçanta në një gamë të gjerë profesionistësh dhe specialitetesh, si avokatia, noteria, këshillimi juridik, sistemi gjyqësor.</i> <i>Objektivat e Programit të Studimit paraqiten në Rregulloren e Programit të Studimit. IAL (UET) ka miratuar dhe parimet e ndërtimit të programit të lëndës, për programet e ciklit të dytë</i> <i>Ky program respekton një përputhshmëri prej së paku 70% në përmbajtje me programet e të njëjtës fushë dhe të njëjtit cikël, për të siguruar një standard të unifikuar akademik dhe profesional. Për programin e studimit UET ka marrë miratimin e kodit 75MI0421S, nga MAS.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.2

Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit	Programi i studimit Master i Shkencave (PI) në "Drejtësi" ofrohet nga Departamenti i Shkencave Juridike (njësia bazë) në Fakultetin e Shkencave Juridike, Politike dhe Marrëdhënieve

Adresa: "Rruga e Durrësit"
 Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
 Tel: +355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al




përbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, për organizimin dhe strukturën akademike, stafet akademike vlerësimin dhe akreditimin.

Ndërkombëtare. Bazuar Vendimit BA Nr. 82, datë 22.09.2023, UET është akredituar në nivel Institucional për 4 (katër) vite akademike (22/09/2023 deri në 21/09/2027), duke përbushur kërkesën ligjore për akreditim institucioni. Fakulteti i Shkencave Juridike, Politike dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare është organizuar në 3 njësi bazë si më poshtë:

1. Departamenti i Shkencave Juridike;
2. Departamenti i Shkencave Sociale të Aplikuara;
3. Qendra për Metodologjinë dhe Kërkimin Shkencor;

Në Fakultetin e Shkencave Juridike, Politike dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare, në vitin akademik 2024 – 2025, janë të angazhuar personel akademik efektiv dhe me kontratë, me kualifikimin si më poshtë:

Kualifikimi i stafit	Fakulteti i Shkencave Juridike, Politike dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare	
	PAE	PAK
Prof.Dr	2	1
Prof.Asoc	6	-
Dr/PhD	7	1
Msc	18	2
Gjithsej	33	4

Stafi akademik i Departamentit të Shkencave Juridike është i kualifikuar dhe përbërja e stafit i përbush kriteret ligjore të kërkuar nga kuadri ligjor për arsimin e lartë, si njësi bazë që ofron këtë program studimi (neni 25, pika 4 e Ligjit Nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”). Përbërja e departamentit për pesë vite akademike është si më poshtë vijon:

Tituj/ grada	2020-2021		2021-2022		2022-2023		2023-2024		2024-2025	
	PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK
Prof.Dr.	2	1	1	1	-	1	-	-	-	-
Prof. Asoc.	1	-	2	1	2	1	2	3	3	-
Dr./PhD.	7	3	6	4	5	6	4	8	4	1
Msc.	1	4	-	-	1	4	1	7	1	2

	<table><tr><td>Totali</td><td>11</td><td>8</td><td>9</td><td>6</td><td>8</td><td>12</td><td>7</td><td>18</td><td>8</td><td>3</td></tr></table> <i>Evidenca Nr.02 "Tabelat përmbledhëse për aneks-RVB", tabela 1, 2;</i> <i>Evidenca nr.54.2 "Urdhër për Riorganizimin e njesisë kryesore";</i>	Totali	11	8	9	6	8	12	7	18	8	3
Totali	11	8	9	6	8	12	7	18	8	3		
Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, duke angazhuar personel ndihmës akademik /administrativ për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike, etj.	Në këtë cikël të studimeve, studenti krahas orëve në auditor kryen praktikën mësimore i mbikqyrur nga pedagogu përgjegjës i departamentit, i cili ka rolin e Këshilluesit të Karrierës. Praktika profesionale është lëndë e detyrueshme për këtë program studimi dhe studenti nuk mund të diplomohet pa kryer detyrimin e praktikës. Të gjitha procedurat që lidhen me zhvillimin e praktikës profesionale janë të përcaktuara në dokumentat rregullatorë të institucionit. <i>Evidenca Nr.32.1 "Dokumenti B.I. Mbi praktikën profesionale";</i> <i>Evidenca nr.14.2 "Plani mësimor i programit të integruar të ciklit të dytë "Master i Shkencave në Drejtësi";</i>											
Kriteri 3. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij.	GVJ konstaston se në datë 22.10.2024, Fakulteti i Shkencave Juridike, Politike dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare ka përcaktuar koordinatorin e programit PIND MSH në "Drejtësi" (PhD. R. K), e cila është përgjegjëse për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale. Ajoshqyrton cilësinë e silabuseve të hartuara nga titullarët e lëndëve para miratimit të tyre, miraton temat e eseve dhe tezat e provimeve, si dhe ndjek ecurinë e zhvillimit të praktikave profesionale. <i>Evidenca Nr. 36.1 "Dokumenti F.V. Mbi organizimin dhe funksionimin e departamentit";</i> <i>Evidenca Nr.36 "Vendim për emërimin e kordinatorëve të programeve të studimit";</i>											
Konkluzione	<i>Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit i përmbush detyrimet ligjore për organzimin, strukturën akademike, cilësinë dhe akreditimin. Departamenti i Shkencave Juridike zhvillon veprimtarinë e tij në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe përmbush standardet e cilësisë në mësimdhënie dhe kërkim shkencor. Staf i akademik i Departamentit të Shkencave Juridike është i kualifikuar dhe përbërja e stafit i përmbush kriteret ligjore. UET është institucion i akredituar</i>											

	Në këtë cikël të studimeve, studenti krahas orëve në auditor kryen praktikën mësimore i mbikqyrur nga pedagogu përgjegjës i departamentit. Njesia bazë ka përcaktuar koordinatorin e programit PIND MSH në "Drejtësi", si dhe për të gjitha programet e studimit që mbulon, detyrat e të cilit përcaktohen në aktet rregullatore të UET.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.3

Programi i studimit është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit të ciklit të dytë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programin e studimit të ciklit të dytë, disponon informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit.	Njësia bazë (Departamenti i Shkencave Juridike) si dhe njësia kryesore (Fakulteti i Shkencave Juridike, Politike dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare) disponon të gjitha informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit PIND. Të gjitha këto informacione janë të publikuara dhe të aksesueshme në mënyrë transparente në faqen zyrtare të UET (https://uet.edu.al/programe-te-integruara/), duke siguruar transparencë dhe mundësi të plotë për konsultim për të gjithë palët e interesuara, përfshirë studentët, stafin akademik dhe administrativ. Çdo anëtar i personelit akademik ka akses të plotë dhe të menjëhershëm në materialet e rëndësishme që lidhen me programin e studimit, përfshirë Statutin dhe rregulloren e institucionit, rregulloren e programit PIND, kurrikulat e programeve të studimit, planet mësimore, silabuset, si dhe aktet e tjera rregullatore të UET. Ky proces i aksesit të informacionit është një aspekt i rëndësishëm i sigurisë dhe cilësisë së programit, duke ndihmuar kështu studentët të kenë një përvojë të plotë dhe të informuar gjatë studimeve të tyre. <i>Evidenca Nr. 46.1 "Urdhër mbi zbatimin e platformës LMS";</i>

Kriteri 2. Programi i studimit përmban planin mësimor, ku përfshihet informacioni i nevojshëm për ndarjen e lëndëve në semestral, ngarkesën mësimore të lëndëve/moduleve, orët në auditor/jashtë auditorit.	Plani mësimor i programit PIND MSH në “Drejtësi” jep informacion të plotë në lidhje me ndarjen e lëndëve në semestra, ngarkesën mësimore në auditor dhe orë punë individuale për çdo lëndë të programit (gjithsej 300 kredite, të ndarë në 5 vite akademike, secili me 2 semestra, në total 7500 orë ngarkesë, nga të cilat 2927 orë mësimore në auditor dhe 4573 orë pune të pavarur të studentit). Sipas rregullores së UET dhe rregullores së programit të studimit përcaktohen rregullat për nivelin e frekuentimit të mësimi (75%) në rastin e programeve të ciklit të dytë, dhe mënyrën e vlerësimit të dijeve dhe sistemin e vlerësimit, zhvillimin e provimeve, etj. <i>Evidenca Nr 5. RREGULLORE UET;</i> <i>Evidenca 7. Rregullore e programit të studimit DIND – shqip;</i>
Kriteri 3. Programi i studimit përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.	Në Rregulloren e programit të studimit PIND MSH në “Drejtësi” parashikohen në mënyrë të detajuar kriteret e pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve. Kështu në pikën 2 “Pranimi në programin e studimit” jepen detaje në lidhje me kushtet dhe kriteret që duhet të plotësohen për t’u pranuar në programin e studimit. <i>Për t’u pranuar në programin e integruar të ciklit të dytë të studimeve, kandidati/studenti duhet të ketë përfunduar me sukses provimet e detyrueshme të Maturës Shtetërore, të plotësojë kriterin e notës mesatare të përcaktuar sipas legjislacionit në fuqi, dhe të zotërojë një diplomë të shkollës së mesme të përgjithshme me kohëzgjatje tre vjet, ose sipas sistemit të vjetër me kohëzgjatje katër vjet, ose dhe shkollë të mesme profesionale. Kandidati mund të ketë edhe diplomë tjetër studimi të ndjekur në një institucion jashtë vendit që njihet dhe është e vlefshme, në përputhje me legjislacionin në fuqi.</i> Sipas pikës 9 të këtij dokumenti përcaktohet procedura dhe kriteret për transferimin e studimeve. UET-i, në përputhje me parimet e Kartës së Bolonjës, pranon transferime të studentëve në vitet ndërmjetëse nga shkollat e tjera universitare, vendase ose të huaja, publike ose jopublike, dhe lejon transferimin e studentëve të tij në shkolla të tjera. Procedura e transferimit, nga bërja e kërkesës me shkrim nga studenti, deri në njohjen e lëndëve dhe regjistrimin e tij në këtë program studimi, rregullohet me udhëzim të veçantë. Procesi i transferimit të studimit dhe ekuivalentimit të lëndëve të zhvilluar në një IAL/program të

	mëparshëm studimi rregullohet me dokumentin “D.II. Mbi transferimet, njohjen e krediteve dhe mobilitetin e studentëve”. <i>Evidenca nr.7 “Regullore e programit të studimit DIND”;</i> <i>Evidenca nr.28 “Mbi transferimet, njohjen e krediteve dhe mobilitetin e studentëve”;</i>
Kriteri 4. Programi i studimit përmban informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset) për secilën lëndë për praktikat, seminarët apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.	Programi i studimit PIND paraqet një strukturë të qartë dhe të organizuar për komponentët e tij akademikë, duke siguruar harmonizimin me standardet institucionale dhe praktikën e miratuar në arsimin e lartë. Ai përmban informacion të plotë mbi programet lëndore (syllabuset), praktikën, leksionet e seminarët, si dhe orët laboratorike, duke mbuluar të gjithë komponentët formues të programit, si brenda, ashtu edhe jashtë auditorit, si dhe kreditet e caktuara në ECTS, duke mundësuar kështu një orientim të saktë për kohën që studenti duhet të investojë për secilën lëndë. Syllabuset e lëndëve që përmban kurrikula e programit janë të strukturuar sipas formatit të miratuar, në nivel institucioni, ku paraqitet informacion i detajuar për objektivat e lëndës, temat për secilën javë, format e vlerësimit dhe kontrollit të dijeve, si edhe literaturën e detyrueshme dhe të rekomanduar që studenti duhet të lexojë. Informacioni i detajuar për secilën lëndë të programit të studimit paraqitet në silabusin e detajuar, i cili miratohet përpara fillimit të semestrit nga përgjegjësi i grup lëndës dhe përgjegjësi i departamentit. Gjithashtu, silabusi përmend detyrimet e studentit për lëndën, siç janë pjesëmarrja në leksione, detyrat e kursit, projektet, diskutimet, provimet dhe çdo aktivitet tjetër që është pjesë e procesit mësimor. Silabuset hartohen në përputhje me udhëzimet përkatëse (Shtojca Nr. 2 e VKM Nr. 41, datë 24.01.2008 “Për elementët e programeve të studimit” dhe Dokumentit A.III. Mbi parimet e ndërtimit të programit të lëndës). Syllabuset e çdo lënde janë të depozituara dhe mbahen nga koordinatori. <i>Evidenca Nr.39 “Mbi parimet e ndërtimit të lëndës”;</i> <i>Evidencat nr.19 “Syllabuset e lëndëve”;</i>
Kriteri 5. Përmbajtja e programit të studimit është në përmirësim dhe	Programi i studimit PIND MSH në “Drejtësi” është objekt i një procesi të vazhdueshëm përmirësimi dhe përditësimi, i cili garanton përputhshmërinë me zhvillimet më të fundit në fushën e

përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë në shqip dhe anglisht.	Shkencave Juridike dhe nevojat e tregut të punës. Në fillim të çdo viti akademik, realizohet një rishikim dhe miratim i ndryshimeve eventuale të përmbajtjes së programit. Të gjitha materialet përkatëse arkivohen në format të plotë në gjuhën shqipe dhe angleze (sipas rastit), duke siguruar qartësi dhe akses për të gjitha palët e interesuara. Përmirësimet që bëhen në syllabuse miratohen nga Përgjegjësi i Grupit mësimor dhe ruhen në departament si në format dixhital ashtu edhe në kopje fizike, duke siguruar kështu transparencën dhe aksesin e pedagogëve dhe studentëve në versionet e përditësuara të syllabuseve. Krijimi i mundësisë për lëndë me zgjedhje është një hap i rëndësishëm për t'iu përgjigjur ndryshimeve të tregut të punës dhe për të rritur fleksibilitetin e programit. Ky përmirësim, i cili është i kufizuar nga ligji i Arsimit të Lartë (Neni 35, Pika 1), që parashikon një kufi prej 20% për riorganizimin e programit i mundëson studentëve të zhvillojnë interesa të veçanta dhe të forcojnë aftësitë e tyre në fusha të caktuara të drejtësisë, duke u mundësuar atyre një formim të gjithanshëm dhe të përshtatur për mundësi të ndryshme karriere.
Konkluzione	<i>Njësia bazë, si dhe njësia kryesore disponon të gjitha informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit PIND. Të gjitha këto informacione janë të publikuara dhe të aksesueshme në mënyrë transparente në faqen zyrtare të UET. Plani mësimor i programit PIND MSH në "Drejtësi" jep informacion të plotë në lidhje me ndarjen e lëndëve në semestra, ngarkesën mësimore në auditor dhe orë punë individuale për çdo lëndë të programit. Në Rregulloren e programit të studimit PIND MSH në "Drejtësi" parashikohen në mënyrë të detajuar kriteret e pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.</i> <i>Programi i studimit PIND paraqet një strukturë të qartë dhe të organizuar për komponentët e tij akademikë, duke siguruar harmonizimin me standardet institucionale dhe praktikat e miratuara në arsimin e lartë. Programi i studimit PIND MSH në "Drejtësi" është objekt i një procesi të vazhdueshëm përmirësimi dhe përditësimi, i cili garanton përputhshmërinë me zhvillimet më të fundit në fushën e Shkencave Juridike dhe nevojat e tregut të punës.</i>

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.4

Struktura dhe organizimi i programit të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë, thellim të njohurive dhe aftësive për studime të mëtejshme dhe/ose punësimin e studentëve.	Programi PIND “Master i Shkencave në Drejtësi” është projektuar dhe zbatuar për të ofruar një edukim të thelluar dhe gjithëpërfshirës në fushën e drejtësisë. Emërtimi i programit është i qartë, përputhet me objektivat akademike dhe profesionale të tij, dhe reflekton qartësisht fushën e studimit që mbulon. Ky emërtim i ofron studentëve një qasje të integruar, duke u garantuar njohuri dhe aftësi të avancuara për të përmbushur kërkesat e tregut të punës ose për të ndjekur studime të mëtejshme. Programi i studimit është i strukturuar në mënyrë që të përmbushë objektivat e tij akademike dhe profesionale, duke siguruar një balancë mes komponentëve teorikë dhe praktikë. Shpërndarja e lëndëve përfshin një kombinim të mirëorganizuar të lëndëve bazë, të detyrueshme dhe me zgjedhje, të cilat mbulojnë të gjitha disiplinat kryesore të drejtësisë, si e drejta civile, penale, administrative, kushtetuese dhe ndërkombëtare. Praktikant profesional në program parashikon periudha intensive të praktikave, duke përfshirë punë praktike në institucione të administratës publike, si dhe në subjekte private. Këto module praktike janë të integruara në kurrikulë për të forcuar aftësitë e studentëve në zbatimin e njohurive teorike në situata reale. Për sa i përket rezultatet e të nxënit, theksi vihet në përgatitjen e studentëve për të arritur rezultate të matshme, duke përfshirë zhvillimin e mendimit kritik, analizën juridike dhe aftësitë komunikuese, të cilat janë të domosdoshme për praktikën profesionale dhe hulumtimet akademike. Kjo strukturë e përgatitjes siguron që studentët të kenë një kuptim të plotë të teorisë dhe praktikës në fushën e tyre dhe të jenë të gatshëm për të ndjekur mundësi punësimi ose zhvillim të mëtejshëm akademik. Program i studimit është hartuar dhe realizohet në

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel: +355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al

	përputhje me misionin dhe qëllimin e Universitetit, duke synuar ofrimin e një programi të avancuar akademik që përgatit studentët për të qenë profesionistë të kualifikuar në fushën e drejtësisë. Ky program është i orientuar për të zhvilluar aftësitë dhe njohuritë e thelluara të studentëve në fusha specifike të ligjit dhe për të siguruar një përgatitje të plotë teorike dhe praktike. Objektivat e Programit të Studimit, sipas pikës 3.3 të Rregullores së Programit të Studimit DIND, paraqiten si më poshtë: - Njohje, thellim, zgjerim dhe specializim të koncepteve; - Parapërgatitje për licencën e profesionit të rregulluar; (Nëse kjo kërkohet nga Ligji i Profesioneve të Rregulluara); - Formim tematik dhe jopanoramik apo historik; - Aftësi për kërkim të avancuar, të pavarur shkencor; - Përvetësim i literaturës kryesore të fushës së studimit; - Stazhe, internship në rreth 50 kompani ose te punëdhënësit më të mëdhenj; - Aftësim i plotë për zhvillim karriere, si dhe për vazhdimin e studimeve të doktoratës; - Diplomë me origjinalitet, me karakter teorik ose empirik, produkt krijues i studentit; <i>Evidenca nr.7 "Rregullore e programit të studimit DIND";</i>
Kriteri 2. Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit dhe kërkimit shkencor.	Programi PIND "Master i Shkencave në Drejtësi, me një total prej 300 kreditesh ECTS, është hartuar për të përmbushur standardet kombëtare dhe ndërkombëtare të arsimit të lartë dhe për t'i pajisur studentët me njohuri dhe aftësi të thelluara në fushën e drejtësisë sipas legjislacionit të arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë (neni 82 i ligjit për Arsimin e Lartë në Shqipëri). Organizimi i programit siguron shpërndarjen e balancuar të lëndëve/modulave në vite akademike dhe semestra. Ai mbulon të gjitha disiplinat kryesore të drejtësisë, përfshirë të drejtën civile, penale, publike, ndërkombëtare si dhe aspekte ndërdisiplinore si <i>Hyrje ne ekonomi dhe Shkrim akademik & Metoda kërkimi</i>. Programi i studimit ndjek rregullat e Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve ku 1 kredit ECTS i korrespondon 25 orëve të ngarkesës totale të studentit, përfshirë orët e kontaktit në auditor, studimin e pavarur dhe përgatitjen për vlerësim. Programi i studimit detajohet sipas planit mësimor, i cili përkthen çdo lëndë

	specifike në orë dhe kredite. Kjo ngarkesë përkthehet në total 7500 orë, nga të cilat 2927 orë mësimore në auditor dhe 4573 orë pune të pavarur të studentit. Struktura e organizuar dhe vlerësimi në kredite i programit sigurojnë përmbushjen e objektivave kryesore të tij: <u>formimin e plotë teorik dhe praktik, që studentët të pajisen me njohuri në fushat kryesore të drejtësisë dhe të zhvillojnë aftësi për zgjidhjen e problemeve ligjore në praktikë.</u> <i>Evidenca Nr.14 "Kurrikula e programit MSH "Drejtësi"; Evidenca nr.14.2 "Plani mësimor i programit të integruar të ciklit të dytë "Master i Shkencave në Drejtësi";</i>
Kriteri 3. Struktura e programit, lëndët, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit të studimit dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare. Në rastet e programit të studimit "Master Profesional", ky program duhet të sigurojë aftësi, kompetenca dhe formim të thelluar profesional.	Programi PIND "Master i Shkencave në Drejtësi" është ndërtuar me një strukturë të qartë, duke harmonizuar raportin teori-praktikë dhe duke përmbushur standardet e profilit të tij akademik dhe profesional. Ky program është i përafërt me programe të ngjashme të institucioneve të arsimit të lartë ndërkombëtar, duke garantuar konkurrueshmëri dhe krahasueshmëri në nivel global. Programi siguron një balancë të qëndrueshme midis formimit teorik dhe aftësimit praktik, duke u fokusuar në përgatitjen e studentëve për sfidat profesionale. Përmes integritetit të komponentëve praktikë në kurrikulë, studentët zhvillojnë kompetenca dhe aftësi të thelluara në zbatimin praktik të njohurive juridike. Nëse do ti referohemi silabuseve të lëndëve konstatojmë se përmbajtja teorike e tyre mbulon të gjitha disiplinat bazë dhe të avancuara të drejtësisë, duke u fokusuar në fushat kryesore si e drejta civile, penale, publike dhe ndërkombëtare. <i>Evidenca Nr.14 "Kurrikula e programit MSH "Drejtësi"; Evidenca nr.14.2 "Plani mësimor i programit të integruar të ciklit të dytë "Master i Shkencave në Drejtësi";</i> <i>Evidenca Nr.19 "Silabuset e lëndëve";</i>
Kriteri 4. Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues,	Studimet, në këtë program studimi, janë me kohë të plotë, të organizuara në module ose lëndë dhe të shprehura në kredite, sipas Sistemit European të Transferimit të Krediteve (ECTS), në frymën e Kartës së Bolonjës.

transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.	Sipas Kurrikulës së Programit PIND MSH "Drejtësi", lëndët ndahën në: A - Lëndë Bazë/ 15% -20%/56 ECTS; B - Lëndë Karakterizuese të Programit / 45% -55% /162 ECTS; C - Lëndë ndërdisiplinore ose Integruese /12%-15% / 44 ECTS; D - Lëndë plotësuese /6%-8%/23 ECTS; E - Detyrime përmbyllëse / 3% - 5% /15 ECTS; Sipas Planit Mësimor, praktika profesionale ka 8 kredite. Për të siguruar arritjen e objektivave formues, transferimin e studimeve, mobilitetin dhe punësimin pas përfundimit të tyre, programi i studimit ndërthur formimin teorik dhe praktik, duke u mbështetur në praktikat më të mira të universiteteve të huaja dhe duke lehtësuar kështu transferimin dhe mobilitetin akademik. Përmbajtja e kurrikulës dhe standardizimi i ngarkesës akademike sigurojnë krahasueshmëri me programe të ngjashme ndërkombëtare, duke mbështetur mobilitetin e studentëve përmes programeve si Erasmus+ dhe marrëveshjeve bilaterale me universitete të huaja. Megjithatë duhet evidentuar fakti se për këtë periudhë vetëm një student ka siguruar mobilitet për 5 muaj (në Hague) në kuadër të projekteve Erasmus + Credit Mobility. <u>GVJ sugjeron që duhet të punohet më shumë në këtë drejtim, duke siguruar pjesëmarrjen e sa më shumë studentëve të këtij programi studimi në projektet Erasmus +.</u> <i>Evidenca Nr. 43.1. Të dhëna në lidhje me mobilitetet e stafit dhe studentëve 2020-2025).</i> <i>Evidenca Nr.14 "Kurrikula e programit MSH "Drejtësi"; Evidenca nr.14.2 "Plani mësimor i programit të integruar të ciklit të dytë "Master i Shkencave në Drejtësi";</i>
Kriteri 5. Syllabuset (programet e lëndëve /moduleve) përditësohen në mënyrë të vazhdueshme për marrjen e kompetencave në përputhje me kërkesat e	Syllabuset (programet e lëndëve/modulet) të programit PIND përditësohen në mënyrë të rregullt, duke reflektuar zhvillimet më të fundit në fushën ligjore dhe kërkesat e tregut të punës. Përditësimet përfshijnë përdorimin e literaturës bazë dhe ndihmëse nga botimet më të reja, të njohura ndërkombëtarisht, që sigurojnë përputhshmëri me standardet bashkëkohore si dhe

tregut të punës, duke përfshirë literaturën bazë dhe ndihmëse të viteve të fundit.	përmirësimin e përmbajtjes së lëndëve për të garantuar kompetenca praktike dhe teorike, duke ndihmuar studentët të jenë të gatshëm për sfidat profesionale në drejtësi. Si rregull, programet e lëndëve/moduleve mbështeten në literaturë të detyruar dhe ndihmëse në pesë vitet e fundit. Programet e lëndëve rishikohen në fillim të çdo viti akademik nga titullari i lëndës, konsultohen me Përgjegjësin e grupit mësimor dhe miratohen nga Drejtuesi i Departamentit. <i>Evidenca nr.39 "Dokumenti A.III Mbi parimet e ndërtimit të programit të lëndës dhe përdorimit të literaturës, pika A.III.8".</i>
Kriteri 6. Përmbajtja e programit të studimit garanton përftimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara.	Programi PIND është dizajnuar për të garantuar përftimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të kërkuara për zhvillimin e karrierës profesionale të studentëve në fushën e drejtësisë. Struktura e programit siguron një përzierje të balancuar mes njohurive teorike dhe aftësive praktike, duke përfshirë lëndë të rëndësishme të ligjit dhe aktivitete praktike si praktika ligjore dhe klinikat juridike. Kjo mundëson që studentët të fitojnë një kuptim të thellë dhe të plotë të sistemit ligjor, duke e përgatitur ata për detyrat dhe përgjegjësitë profesionale në fushën e drejtësisë. Programi i studimit është plotësisht në përputhje me misionin e UET-së, që synon ofrimin e një edukimi cilësor dhe për të forcuar dijet e qëndrueshme. Lëndët e studimit përfshijnë jo vetëm teoritë dhe konceptet bazë të ligjit, por edhe praktikatat dhe procedurat e përdorura në sistemin gjyqësor, si dhe aplikimin e njohurive në raste konkrete. <i>Evidenca Nr.19 "Silabuset e lëndëve";</i>
Kriteri 7. Përmbajtja e programit të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.	Përmbajtja e programit PIND është krijuar për të siguruar që studentët jo vetëm të fitojnë njohuri të thelluara dhe aftësi praktike në fushën e drejtësisë, por edhe të zhvillojnë kompetenca që janë të kërkuara dhe të vlerësuara nga aktorët kryesorë në sektorin ligjor dhe më gjerë. Programi i studimit i pajis studentët me njohuritë e nevojshme për t'u punësuar në sektorët publik dhe privat, si më poshtë: <i>-Jurist-</i> Mund të konkurojnë për të zënë pozicionin e juristit në degë të ndryshme të administratës shtetërore, përfshirë edhe sektorin e marrëdhënieve me jashtë, ose të biznesit privat. Mund




	të angazhohen dhe të punësohen në çdo sektor ku kërkohen njohuritë e specialitetit të juristit; -<i>Gjyqtarë</i>- Të kenë mundësi për të konkuruar në Shkollën e Magjistraturës për t'u bërë gjyqtar ose prokuror në mbarim të studimeve. Prokurorë- Ndjekja penale e çështjeve kriminale në emër të shtetit; -<i>Avokatë</i>- Përfaqësimi i klientëve në çështje ligjore dhe ofrimi i këshillave juridike. Mund të konkurojnë për të ndjekur shkollën e avokatisë, noterisë ose kualifikimit për noter, për t'u pajisur me licensën e avokatit ose përmbaruesit; -<i>Këshilltarë ligjorë</i>- Ofrimi i këshillave juridike për organizata publike dhe private; -<i>Pedagogë/Lektor</i>-Mund të konkurojnë për t'u angazhuar në mësimdhënie, për të vazhduar kualifikimin pasuniversitar për programin e ciklit të tretë-doktoraturë, brenda ose jashtë vendit, angazhimi në institucione arsimore dhe kërkimore në fushën e drejtësisë; -<i>Noterë</i>- Çertifikimi dhe legalizimi i dokumenteve zyrtare, sipas legjislacionit në fuqi; - <i>Punonjës në administratën publike</i>- Pozicione të ndryshme në ministri, agjenci qeveritare dhe institucione të tjera shtetërore. Angazhimi në institucione arsimore dhe kërkimore në fushën e drejtësisë; Programi është i strukturuar gjithashtu për të mundësuar një kalim të përshtatshëm dhe të suksesshëm në nivele më të avancuara të studimeve, duke përfshirë studime post-universitare, si programet e ciklit të tretë (Doktoraturë) ose Master Ekzekutiv. <i>Evidenca Nr.7 "Rregullore e Programit të Studimit DIND"</i>
Konkluzione	<i>Programi PIND "Master i Shkencave në Drejtësi" është projektuar dhe zbatuar për të ofruar një edukim të thelluar dhe gjithëpërfshirës në fushën e drejtësisë. Programi i studimit PIND është i strukturuar në mënyrë që të përmbushë objektivat e tij akademike dhe profesionale, duke siguruar një balancë mes komponentëve teorikë dhe praktikë.</i>

	<i>Programi i studimit ndjek rregullat e Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve ku 1 kredit ECTS i korrespondon 25 orëve të ngarkesës totale të studentit.</i> <i>Ky program është i përafërt me programe të ngjashme të institucioneve të arsimit të lartë ndërkombëtar, duke garantuar konkurrueshmëri dhe krahasueshmëri në nivel global.</i> <i>Megjithatë duhet evidentuar fakti se për këtë periudhë vetëm një student ka siguruar mobilitet për 5 muaj (në Hague) në kudër të projekteve Erasmus + Credit Mobility.</i> <i>GVJ rekomandon se Departamenti dhe Zyra e Këshillimit të Karrierës dhe Kujdesit ndaj Studentit duhet të punojnë më shumë në këtë drejtim, duke siguruar pjesëmarrjen e sa më shumë studentëve të këtij programi studimi në projektet ndërkombëtare ("Erasmus +", etj.)</i> <i>Syllabuset e programit PIND përditësohen në mënyrë të rregullt, duke reflektuar zhvillimet më të fundit në fushën ligjore dhe kërkesat e tregut të punës. Program i integruar i ciklit të dytë Master i Shkencave në "Drejtësi" pajis studentët me njohuritë e nevojshme për t'u punësuar në sektorët publik dhe privat.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.5

Institucioni i arsimit të lartë nxit përfshirjen e studentëve dhe partnerëve, rrjeteve dhe organizmave të tjera në hartimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut të punës, gjatë hartimit dhe ecurisë së programit të studimit, njësitë përgjegjëse	Referuar statutit nenit 30, pika 30.4 "plani mësimor i cdo program studimi konsultohet në mënyrë të herpashershme me Bordet e tregut të punës, përfaqësues të bizneseve të profesioneve respective, dhe ai mund të ndryshojë për t'u përgjigjur sa më mirë kërkesave të tregut të punës". Kjo gjë u evidentua edhe gjatë vizitës në institucion.

konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e institucioneve partnere, të diplomuarve, dhe aktorëve të tjerë nga tregu i punës.	<i>Evidenca Nr.2 "Statuti UET, neni 30 pika 30.4";</i>
Kriteri 2. Institucioni nxit dhe përfshin në diskutime studentët dhe strukturat e tyre, mban kontakte dhe konsultohet vazhdimisht me studentët e diplomuar, për përmirësimin e programit të studimit, dhe reflektimin kur ato janë në ndihmë të përmirësimit të programit të studimit.	Referuar RVB-së, UET synon rritjen e përfshirjes së studentëve në nivelet vendimmarrëse të universitetit. Sipas Statutit të UET studentët përfaqësohen me anëtarë në Senatin Akademik, Këshilli Etikës dhe KSBC. Gjithashtu merren masa për sigurimin e përfshirjes së studentëve më të dalluar të departamenteve apo fakulteteve përkatëse në kërkimin shkencor, botimet akademike, revistat shkencore, konferencat dhe workshopet, aktivitetin kërkimor-shkencor, etj. Gjithashtu, prej disa vitesh, Bordi i Tregut të Punës që ngrihet pranë departamentit është krijuar me anëtarë nga radhët e UET Alumni, të cilët kanë zhvilluar një karrierë të spikatur profesionale pranë institucioneve ku janë punësuar. Një herë në muaj, Departamenti organizon mbledhje të hapura për studentët e programeve të tij, duke u ofruar mundësinë atyre të shprehin mendimet dhe sugjerimet për përmirësimin e programit të studimit dhe më gjerë. Kjo politikë është ndjekur vazhdimisht nga UET dhe mbetet një prioritet në Planin Strategjik 2021-2025. Ky kriter plotësohet përmes diskutimeve të tilla, të cilat zhvillohen gjatë mbledhjeve të hapura dhe nëpërmjet focus grupeve të organizuara. <i>Evidenca Nr.3 "Plani Strategjik 2021-2025, Kreu IV;</i> <i>Evidenca Nr. 30.4 "Urdhër Administrativ mbi përbërjen e KSBC";</i> <i>Evidenca Nr.55.2 "D.III. Mbi përfshirjen e studentëve në qeverisjen e UET-it";</i>
Kriteri 3. Njësia përgjegjëse përmirëson, përditëson, përshtat programin e studimit në përputhje me propozimet dhe zhvillimet e fundit në fusha të ndryshme në bashkëpunim me rrjete profesionistësh, shoqata, urdhra (veçanërisht në	Programi i studimit DIND MSH në "Drejtësi", në përfundim të këtij viti akademik, plotëson ciklin e plotë 5 vjeçar dhe ende nuk ka pësuar ndonjë përmirësim apo përshtatje të konsiderueshme. Mbledhjet që zhvillon departamenti me anëtarët e Bordit të Tregut të Punës, shërbejnë për të marrë rekomandimet e envojshme për përmirësimin e kurrikës, programit në përputhje me zhvillimet e fundit.

fushën e mjekësisë) dhe institucione publike e private.				
Konkluzione	<i>Institucioni analizon, për çdo fakultet dhe departament, ecurinë e programeve të studimeve, duke përfshirë mendimet e përfaqësuesve të tregut të punës dhe opinionet e studentëve. Kjo analizë mbështetet gjithashtu në mendimet e personelit akademik dhe të anëtarëve të Bordit të Tregut të Punës, i ngritur në nivel departamenti</i> <i>UET synon rritjen e përfshirjes së studentëve në nivelet vendimmarrëse të universitetit. Sipas Statutit të UET studentët përfaqësohen me anëtarë në Senatin Akademik, Këshilli Etikës dhe KSBC</i> <i>Gjithashtu merren masa për sigurimin e përfshirjes së studentëve më të dalluar të departamenteve apo fakulteteve përkatëse në kërkimin shkencor, botimet akademike, revistat shkencore, konferencat dhe workshopet, aktivitetin kërkimor-shkencor, etj.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.6

Programi i studimit garanton orientim në fushën e studimeve dhe kërkimit shkencor.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programi i studimit përcakton qartë prioritetet dhe objektivat kryesorë të studimit dhe kërkimit shkencor në përputhje me objektivat madhorë të institucionit.	Programi i studimit përcakton qartë prioritetet dhe objektivat kryesorë të studimit dhe kërkimit shkencor, në Rregulloren e Programit të Studimit si dhe në Planin Strategjik të Zhvillimit të Programit. Kështu, sikurse specifikohet në pikën 3.3 të Rregullores mësimore, një nga objektivat e programit të studimit është aftësimi i studentëve për kërkim të avancuar, të pavarur shkencor. Gjithashtu pjesë e veprimtarive mësimore në fushën përkatëse është edhe puna kërkimore, e cila është konceptuar në mbështetje të programit të studimit, si përgjatë zhvillimit të lëndëve nëpërmjet përgatitjes së detyrave të kursit dhe përdorimit të literaturës, ashtu edhe përgjatë punimit të diplomës.

	Gjithashtu “Plani Strategjik për zhvillimin e programit të studimit të ciklit të dytë “Master i Shkencave” në “Drejtësi” parashikon si objektiv prioritar inkurajimin e studentëve që të zhvillojnë aftësi për kërkime të pavarura dhe kontribut në fushat e ndryshme të Drejtësisë, duke u angazhuar në projekte kërkimore dhe publikime shkencore. Në funksion të arritjes së objektivave strategjike, Departamenti i Shkencave Juridike vlerëson si prioritet aftësimin për punë kërkimore – shkencore në fushën e studimit për Programin e Studimit të Ciklit të Dytë “Master i Shkencave” në “Drejtësi”. <i>Evidenca Nr.7 “Rregullorja e programit të studimit”;</i> <i>Evidenca Nr.4 “Plani strategjik i zhvillimit të programit”;</i>
Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë nxit, bashkërendon dhe administron veprimtaritë e mësimdhënies, veprimtaritë kërkimore ose artistike, duke respektuar lirinë akademike të personelit akademik dhe fushën e veçantë të studimit.	Sipas neneve 7, 8 të Statuti i UET-së, Fakulteti bashkërendon dhe administron veprimtaritë e mësimdhënies, veprimtaritë kërkimore, duke respektuar lirinë akademike të personelit akademik. Gjatë vizitës në institucion u konstatua se stafi akademik gjatë gjithë kohës ka një liri akademike të plotë në përzgjedhjen e literaturës, të rasteve praktike, të informacionit që diskutojnë dhe ndajnë me studentët në leksione dhe/apo seminare, në koordinim me njësinë kryesore. Gjithashtu zhvillohen edhe aktivitete përtej procesit normal akademik sic janë forumet, ku ftohen personalitete të fushave të ndryshme, të cilët vijnë dhe bashkëbisedojnë me pedagogë dhe studentë. <i>Evidenca Nr.55.3 “Kalendari i Aktiviteteve”;</i>
Kriteri 3. Programi i studimit mundëson, nxit dhe motivon studentët të angazhohen në studime, projekte dhe aktivitete kërkimore.	Nga GVJ konstatohet se nga strukturat përgjegjëse të programit të studimit promovohet pjesëmarrja studentëve në projekte dhe aktivitete kërkimore. Kështu nga UET, çdo vit, organizohet Konferenca Ndërkombëtare “Ditët e Studimit Shqiptar” dhe “Ditët e Studimit Shqiptar” Junior, ku studentët të marrin pjesë edhe me punimet e tyre. Një tjetër aktivitet në këtë kuadër është organizimi i përvitshëm i Gjyqit Simulues, një aktivitet kombëtar ku anagazhohen studentë të programit të studimit PIND “Drejtësi”, nën drejtimin e pedagogëve të programit. <i>Evidenca Nr.55 “Ditët e Studimeve Shqiptare 2020-2025”;</i> <i>Evidenca Nr.55.1 “Ditët e Studimeve Shqiptare 2021-2024”;</i>

Kriteri 4. Për realizimin e aktiviteteve studimore, kërkimore e shkencore, njësia bazë mbështetet financiarisht nga institucioni dhe administron të ardhurat nga aktivitete të ndryshme.	UET siguron financimin e kërkimit, duke dedikuar një sasi monetare çdo vit, për kërkimin shkencor. Nëse i referohemi “Strategjia e kërkimit shkencor në uet (2021-2025)”, pika 14, aktiviteti kërkimor i UET financohet nga një sistem i dyfishtë: burimet e brendshme dhe donacionet/financimet nga jashtë. Universiteti alokon fonde në mënyrë selektive për fakultetet, në mënyrë që ato të zhvillojnë kërkimin e tyre. UET vendos në dispozicion të stafit akademik një fond kërkimor tek i cili kërkuesit mund të aplikojnë për mbështetje për ndërmarrjen e projekteve kërkimore ose për shpërblim pas publikimit në revista dhe libra të botuara nga shtëpi botuese me reputacion ndërkombëtar në akademi. <i>Evidenca Nr.3.1 “Strategjia e kërkimit shkencor në UET (2021-2025)”</i>			
Konkluzione	<i>Programi i studimit përcakton qartë prioritetet dhe objektivat kryesore të studimit dhe kërkimit shkencor, në Rregulloren e Programit të Studimit si dhe në Planin Strategjik të Zhvillimit të Programit. Një nga objektivat e programit të studimit është aftësimi i studentëve për kërkim të avancuar, të pavarur shkencor.</i> <i>Fakulteti bashkërendon dhe administron veprimtaritë e mësimdhënies, veprimtaritë kërkimore, duke respektuar lirinë akademike të personelit akademik. Njësia bazë dhe fakulteti nxit dhe motivon studentët të angazhohen në studime, projekte dhe aktivitete kërkimore, përmes disa mënyrave.</i> <i>UET siguron financimin e kërkimit, duke dedikuar një sasi monetare çdo vit, për kërkimin shkencor.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht X

Standardi II.7

Programi i studimit garanton njohuri të thelluara, ndërkombëtarizim dhe kërkim shkencor.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
----------	------------------------

Kriteri 1. Njësia përgjegjëse mbështet grupet lëndore dhe projektet kërkimore-shkencore të reja dhe siguron bashkëpunimin me struktura të tjera kërkimore për realizimin e objektivave të programit të studimit në kërkim shkencor.	Kërkimi shkencor për këtë program studimi realizohet individualisht por dhe në grupe kërkuesish, duke u drejtuar nga njësia kryesore që mbulon PIND “Drejtësi” dhe që është Fakulteti i Shkencave Juridike, Politike dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare. Ka dhe projekte të mëdha ku synohet ndërdisiplinariteti dhe që mundësojnë koordinimin shkencor ndërmjet departamenteve. Marrëveshjet e bashkëpunimit të UET me IAL të tjera kanë në fokus, ndër të tjera, edhe angazhimin e personelit akademik për të realizuar kërkimore në bashkëpunimin me struktura të tjera kërkimore. <i>Evidenca nr.3.1 “Strategjia e kërkimit shkencor në UET, 2021-2025”;</i>
Kriteri 2. Njësia përgjegjëse angazhohet për t’iu përgjigjur kërkesave për analiza, studime e projekte me karakter kërkimor shkencor dhe angazhon personelin akademik dhe studentët për realizimin e këtyre objektivave.	Njesisë përgjegjëse (Departamenti i Shkencave Juridike) angazhohet për të adresuar kërkesat për studime dhe projekte kërkimore shkencore, duke përfshirë në këtë proces personelin akademik, sipas profilizimit të tyre akademik dhe shkencor, si dhe studentët. Projektet kërkimore i referohen dinamikave dhe fushave prioritare të financimit të projekteve ndërkombëtare dhe prioriteteve kombëtare (sipas kriterëve të AKKSHI). Grupet drejtuese të PMK-ve janë një mekanizëm i rëndësishëm për kontrollin e brendshëm të cilësisë së produktit shkencor. Këto grupe bëjnë edhe orientimin e studentëve për kërkimin shkencor.
Kriteri 3. Në fushën e programit të studimit, njësia përgjegjëse organizon konferenca ose aktivitete, të cilat ndihmojnë personelin dhe studentët për arritjen e objektivave.	Referuar Kalendarit të Aktiviteteve, GVJ konstaton se njësia kryesore organizon konferenca dhe aktivitete (leksione të hapura, psh), ku marrin pjesë pedagogët, studentët dhe të ftuar të tjerë, për të siguruar përmbushjen e objektivave të programit të studimit. IAL organizon dhe aktivitete periodike (vjetore) si psh konferenca “Ditët e Studimeve Shqiptare”, ku angazhohen edhe studentët. <i>Evidenca nr.55 “Ditët e Studimeve Shqiptare 2020-2025”;</i> <i>Evidenca nr.55.3 “Kalendari i Aktiviteteve 2022 – 2023”;</i>
Kriteri 4. Programi i studimit formon profesionistë konkurrues për tregun kombëtar dhe ndërkombëtar të punës.	Programi i studimit është ndërtuar në përputhje me prioritetet e UET dhe Strategjinë Kombëtare të Arsimit, duke u fokusuar në formimin e profesionistëve për tregun e punës, me synimin për punësimin e tyre pas diplomimit. Të diplomuarit të cilët zotërojnë një diplomë universitare “Master i Shkencave” në “Drejtësi” mund të punësohen si juristë në institucione të ndryshme publike,

	si specialistë apo këshilltarë ligjorë në ministri dhe agjenci shtetërore, duke ofruar shërbime ligjore për hartimin e akteve normative dhe interpretimin e ligjeve ekzistuese. Ata mund të punësohen si gjyqtarë, prokurorë, apo staf mbështetës në gjykata dhe prokurori, pas përfundimit të praktikave profesionale dhe kalimit të provimeve të nevojshme për të ushtruar si profesionistë në sistemin gjyqësor. Gjithashtu ata mund të punësohen në Agjencitë dhe institucionet shtetërore që merren me çështje ligjore, si Autoriteti i Konkurrencës dhe Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, etj. Për sa i përket institucioneve private të diplomuarit në këtë program mund të punësohen si konsulentë ligjorë brenda departamenteve të ligjit të kompanive të mëdha, duke ofruar mbështetje ligjore në lidhje me kontratat, transaksionet financiare dhe marrëdhëniet e punës. Pas kalimit të provimit të nevojshëm për t'u bërë avokatë, mund të ofrojnë shërbime për klientët që merren me çështje të ndryshme të ligjit komercial dhe të drejtës së tregtisë. <i>Evidenca nr.4 "Plani strategjik për zhvillimin e programit të studimit të ciklit të dytë "Master i Shkencave" në "Drejtësi";</i> <i>Evidenca nr.17 "Studim Tregu për Programin e Studimit të Ciklit të Dytë "Master i Shkencave" në "Drejtësi";</i>
Kriteri 5. Njësia përgjegjëse merr parasysht dhe zbaton rekomandimet e nxjerra nga urdhrat, shoqatat profesionale, rrjetet profesionale, për kompetencat e nevojshme për marrjen e licencës së profesionit përkatës, sipas akteve ligjore të fushës.	Ende nuk është rregulluar me akte normative organizimi i provimit të shtetit në drejtësi dhe marrja e licencës profesionale përkatëse, sipas parashikimit të nenit 82, pika 2 dhe 3 e Ligjit nr.80/2015. Gjithsesi në hartimin e programit është mbajtur parasysht që kurrikula e këtij programi studimi, të jetë në harmoni me legjislacionin në fuqi, duke iu dhënë mundësinë studentëve të aplikojnë për marrjen e licencës së profesionit përkatës si Avokat, Noter, Ndërmjetës, Përmbarues Gjyqësor etj. <i>Evidenca nr.14.4. Plani mësimor i ndarë sipas Veprimtarive Formuese (A-E);</i>
Kriteri 6. Programi i studimit për profesionet e rregulluara përputhet me aktet ligjore në vend dhe rekomandimet ndërkombëtare në direktiva	Programi i integruar i studimit i ciklit të dytë në Drejtësi është hartuar në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", Strategjinë Kombëtare për Arsimin 2021-2026, si dhe Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim Evropian 2022-2030.

39

dhe rregullore të Bashkimit Evropian (p.sh. Professional Qualifications Directive, 2005/36/EU).	Evidenca Nr.3 "Plani Strategjik UET 2021-2025"; Evidenca nr.4 "Plani strategjik për zhvillimin e programit të studimit";			
Konkluzione	Drejtimi i kërkimit shkencor realizohet nga njësia kryesore. Për projektet e mëdha Kërkimore (PMK) ngrihen grupet Kërkimore (5-7 anëtarë). Njesisë përgjegjëse (Departamenti i Shkencave Juridike) angazhohet për të adresuar kërkesat për studime dhe projekte kërkimore shkencore, duke përfshirë në këtë proces personelin akademik, sipas profilizimit të tyre akademik dhe shkencor, si dhe studentët. Programi i integruar i studimit i ciklit të dytë në Drejtësi është hartuar në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 80/2015, Strategjinë Kombëtare për Arsimit 2021-2026, si dhe Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim Evropian 2022-2030. Programi i studimit është i fokusuar në formimin e profesionistëve për tregun e punës, me synimin për punësimin e tyre pas diplomimit.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

Standardi III.1 Institucioni i arsimit të lartë garanton procesin e të nxënit dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira, me në qendër studentin, që sigurojnë arritjen e rezultateve.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve



Kriteri 1. Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, punët laboratorike, detyrat e kursit/estetë, projektet, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.	Format e mësimdhënies dhe mësimnxënies janë të përcaktuara qartë në Rregulloren e UET-së, në rregulloren specifike të programit PIND, si dhe në Planin mësimor të programit Gjithashtu dokumenti “Mbi parimet e ndërtimit të programit të lëndës dhe të përdorimit të literaturës” në pikën A.III.3 parashikon format e zhvillimit të procesit mësimor, duke përcaktuar se: Procesi mësimor zhvillohet me <i>leksione, seminare, leksion/seminare, punë laboratorike, praktika mësimore, detyra praktike, detyra kursi, provime të ndërmjetme, provime përfundimtare, praktika profesionale dhe me punim diplome</i>. Kontrolli i dijeve siguron vlerësimin e progresit të studentëve dhe përvetësimin e kompetencave profesionale të programit. Ai realizohet në mënyrë të vazhdueshme gjatë semestrit, duke ndihmuar studentët të identifikojnë dhe adresojnë mangësitë para përfundimit të tij. <i>Evidenca nr.5 “Rregullorja e UET”, neni 17;</i> <i>Evidenca nr.7 Rregullorja e programit të studimi” neni 4; Evidenca Nr.14.2 “Plani mësimor i programit të studimit”;</i>
Kriteri 2. Personeli akademik respekton dhe u përgjigjet larmisë dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies.	Personeli akademik luan një rol kyç në garantimin e një procesi të suksesshëm mësimdhënieje dhe mësimnxënieje, duke respektuar larminë dhe nevojat e studentëve. Në këtë kontekst, personeli përmbush detyrimet e veta duke ofruar forma, metoda dhe mundësi alternative për mësimdhënie, të cilat mundësojnë që secili student të arrijë potencialin e tij akademik dhe profesional. Kështu përpos metotave klasike të mësimdhënies, nga stafi akademik në lëndë të caktuara aplikohen kërkesa për <i>ese-të</i>, projekte të studimit në grup. Gjithashtu përdoren metoda alternative të mësimdhënies si mjetet audio-vizive.
Kriteri 3. Institucioni mbështet personelin akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike dhe në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit.	Universiteti European i Tiranës siguron një program trajnimi të strukturuar për stafin akademik, për botimin dhe kryerjen e kërkimeve në grup për stafin akademik, freskimin e njohurive mbi metodikën e mësimdhënies, por edhe njohjen dhe përputhjen me rregulloret e brendshme të UET. Këto trajnime synojnë përmirësimin e cilësisë së procesit mësimor dhe mbështetje për zhvillimin e kapaciteteve të stafit akademik. Në çdo fillim viti akademik, UET organizon aktivitetin trajnues për drejtuesit e departamenteve në kuadër të aktivitetit “Back to work”. UET organizon rregullisht Ditën e Zhvillimit të Stafit

	(Staff Development Day), me qëllim trajnimet në fusha të lidhura me mësimdhënien, kërkimin, projektet dhe metodologjinë. <i>Evidenca Nr.33. "Të dhëna për trajnimet profesionale të stafit dhe studentëve";</i>
Kriteri 4. Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënien në program është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies interaktive dhe diskutime me në qendër studentin, nxit te student mendimin krijues, atë kritik si dhe autonominë e përgjegjshmërinë. Në të njëjtën kohë siguron udhëheqjen, mbështetjen dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.	Personeli akademik i angazhuar në programin e studimit përfaqëson një burim të rëndësishëm ekspertize dhe profesionalizmi, duke garantuar një mjedis mësimor të bazuar në cilësi, bashkëpunim dhe inovacion. Puna e tyre shtrihet në disa drejtime të rëndësishme, të cilat mbështesin dhe përmirësojnë përvojën e të nxënësve për studentët. Personeli akademik demonstroi aftësi të larta në shpjegimin e qartë dhe sistematik të njohurive dhe koncepteve. Anëtarët e stafit akademik në përgjithësi kanë një ekspertizë të thelluar në fushën e tyre akademike, duke garantuar saktësi dhe thellësi gjatë shpjegimeve. Trajnimet e stafit akademik synojnë edhe përdorimin e metodave bashkëkohore krahas atyre tradicionale të mësimdhënies, në lëndë të caktuara, të cilat synojnë të nxënësit mendimin krijues dhe kritik të studentit. <i>Evidenca nr. 0.2, Tabela nr.6 "Cilësia e stafit mësimdhënës për programin e studimit";</i>
Kriteri 5. Njësia përgjegjëse për ofrimin e programit të studimit, vlerëson dhe përmirëson format e metodave të mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.	Njësia Kryesore (Fakulteti) kryen vlerësime sistematike të formave dhe metodave të mësimdhënies. Organizimi i pyetësorëve dhe marrja e mendimit të studentëve, në lidhje me format dhe metodat e mësimdhënies është një aktivitet periodik shumë i rëndësishëm, i organizuar nga strukturat përgjegjëse të programit të studimit. Rezultatet e këtyre pyetësorëve synojnë vlerësimin dhe përmirësimin e performancës akademike. Një tjetër metodë për vlerësimin e metodologjisë së mësimdhënies është dhe vlerësimi i performancës së pedagogut nga kolegu apo eprori, nëpërmjet formularit të vlerësimit të pedagogut nga eprori-kolegu. Ndër të tjera në këtë formular përfshihet rubrikë vlerësuese edhe për mënyrën e paraqitjes së materialeve nga pedagogu që i nënshtrohet vlerësimit.

	<i>Evidenca nr.30.1 "Plan veprimi për sigurimin e brendshëm të cilësisë në UET - Viti Akademik 2022-2023";</i> <i>Evidenca nr.30.16. G-III-4-1 "Formulari i vleresimit të pedagogut nga eprori-kolegu".</i>
Kriteri 6. Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies, trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe zbatimit të metodave të reja.	Në funksion të arritjes së objektivave strategjike, Departamenti i Shkencave Juridike vlerëson si prioritet mbështetjen e stafit akademik të programit të studimit, në kuadër të trajnimit të vazhdueshëm të tyre me qëllim përmirësimin e cilësisë. Ky prioritet synohet të arrihet në bashkëpunim me Zyrën e Projekteve, Zyrën e Marrëdhënieve me Jashtë, Zyrën e IT, Zyrën e Standardeve dhe Cilësisë, Komisionin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë, Drejtorinë e Zhvillimit të Kurrikulave. UET ka ngritur si strukturë autonome dhe të përhershme Komisionin e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, i cili kryen vlerësime periodike të rezultateve të veprimtarive mësimore dhe kërkimore-shkencore, duke propozuar ndryshime të nevojshme për përmirësimin e cilësisë, në përputhje me udhëzimet e sigurimit të cilësisë në hapësirën evropiane të arsimit të lartë dhe legjislacionin në fuqi. Kjo zyrë bashkëpunon me njësitë kryesore dhe realizon aktivitete të ndryshme të parashikuara në planin e saj të veprimit, për të monitoruar dhe përmirësuar cilësinë e mësimdhënies. Departamenti inkurajon zhvillimin e metodave të reja të mësimdhënies. Personelit akademik i kërkohet të shfrytëzojë në maksimum metodat inovative të mësimdhënies. Në formatin për hartimin e silabuseve, kërkohet që personeli akademik të specifikojë për çdo temë të mësimdhënies metodat dhe format pedagogjike që do të përdoren në seminarin përkatës. Aktivitete me fokus trajnimin e stafit akademik, për çështje didaktike dhe metodat e mësimdhënies, janë realizuar në mënyrë sistematike. Personeli akademik ka marrë trajnime edhe për përdorimin e platformave on linë të mësimdhënies Personeli akademik i këtij programi studimi ka patur mundësi të përmirësojë aftësitë e tij në mësimdhënie, duke shfrytëzuar edhe periudha e shkëmbimit të eksperiencës në universitete partnere, në kuadër të programeve Erasmus+KA1. <i>Evidenca Nr.4 "Plani Strategjik për zhvillimin e programit, Prioritetet në trajnimin e vazhdueshëm të stafit akademik";</i>

	<i>Evidenca nr.30.1 "Plan veprimi për sigurimin e brendshëm të cilësisë në UET";</i> <i>Evidenca nr.19.1 "Formati për hartimin e silabusit";</i> <i>Evidenca Nr.33 "Të dhëna për trajnimet profesionale të stafit dhe studentëve";</i> <i>Evidenca Nr.43.1 "Të dhëna për shkëmbimin e stafit";</i> <i>Evidenca Nr. 46.4 "Video-trajnime mbi sistemin Teams/LMS";</i>			
Konkluzione	<i>Format e mësimdhënies dhe mësimnxënies janë të përcaktuara qartë në Rregulloren e UET-së, në rregulloren specifike të programit PIND, në Planin mësimor të programit, si dhe në Dokumentin "Mbi parimet e ndërtimit të programit të lëndës dhe të përdorimit të literaturës".</i> <i>Personeli akademik luan një rol kyç në garantimin e një procesi të suksesshëm mësimdhënieje dhe mësimnxënieje, duke respektuar larminë dhe nevojat e studentëve. Universiteti Europian i Tiranës siguron një program trajnimi të strukturuar për stafin akademik</i> <i>Personeli akademik i angazhuar në programin e studimit përfaqëson një burim të rëndësishëm ekspertize dhe profesionalizmi, duke garantuar një mjedis mësimor të bazuar në cilësi, bashkëpunim dhe inovacion</i> <i>Njësia Kryesore kryen vlerësime sistematike të formave dhe metodave të mësimdhënies. UET ka ngritur si strukturë autonome dhe të përhershme Komisionin e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, i cili kryen vlerësime periodike të rezultateve të veprimtarive mësimore dhe kërkimore-shkencore. Departamenti inkurajon zhvillimin e metodave të reja të mësimdhënies.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.2

Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore dhe garanton zbatimin e tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
-----------------	-------------------------------



Kriteri 1. Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore përcaktohen në Rregulloren e programit të studimit/Rregulloren e Institucionit/rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.	Kontrolli i njohurive realizohet kryesisht nëpërmjet: a. Angazhimit në diskutime gjatë seminareve, por edhe në formë prezantimesh apo performancash të kryera përgjatë zhvillimit të lëndës; b. Detyrës së kursit, ose detyrave praktike që lidhen me problematikën e disiplinës; c. Provimit të ndërmjetëm dhe përfundimtar mbi bazën e materialeve të kaluara përgjatë zhvillimit të lëndës; Kriteret dhe metodat e testimit dhe vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale janë të detajuara në Rregulloren e Programit të Studimit, në pikën 5 “Verifikimi i dijeve të fituara nga studentët” si dhe në dokumente të veçanta rregullore të posaçme, të cilat bëhen publike dhe njihen nga të gjithë studentët. <i>Evidenca Nr.39 “Dokumenti A.III. Mbi parimet e ndërtimit të programit të lëndës dhe të përdorimit të literaturës”;</i> <i>Evidenca Nr.7;</i>
Kriteri 2. Në fillim të çdo lënde/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	Kriteret dhe mënyra e testimit të njohurive u shpjegohen studentëve gjatë javës së orientimit (për studentët e rinj), si dhe nga çdo pedagog në auditor për lëndët përkatëse, i cili i njofton studentët me përmbajtjen e syllabusit dhe formën e vlerësimit. Vlerësimi i përgatitjes akademike të studentit ka si komponent të rëndësishëm kontrollin e vazhdueshëm (Për shembull, vlerësimi mund të përfshijë detyra kursi, projekte, prezantime, apo provime të ndërmjetme). Kështu çdo syllabus përmban një seksion të titulluar “Kontrolli i Vazhdueshëm”, ku përcaktohet vlerësimi i studentëve në përputhje me tipologjinë e lëndës. Po ashtu, studentët mund të përfitojnë nga platforma LMS, si dhe nga shërbimi i kujdesit dhe këshillimit të vazhdueshëm, i ofruar nga Koordinatorja e Departamentit dhe Zyra e Kujdesit ndaj Studentit. Njoftimet e detajuara për detyrat dhe provimet e lidhura me lëndën janë të disponueshme në platformën LMS dhe dërgohen gjithashtu me email nga koordinatoresja e departamentit. <i>Evidenca Nr.19 “Silabuset e lëndëve”;</i> <i>Evidenca Nr.46.3 “Manuali i studentit – UET/LMS”;</i>

Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.	Testimi dhe vlerësimi i njohurive bazohet në vlerësimin e vazhdueshëm, duke përdorur metoda të larmishme, të cilat i japin mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara. Procesi i testimit dhe vlerësimit të njohurive të studentëve ndahet në disa komponentë, të cilët përcaktohen sipas rregullores së programit të studimit PIND: - Angazhimit në seminare; - Detyrës së kursit; - Provimit të ndërmjetëm dhe përfundimtar; Ky proces parashikon një larmi formash, si: diskutime, seminare, detyra kursi, ushtrime për raste gjyqësore, projekte dhe aktivitete të tjera të organizuara. Vlerësimi i vazhduar është një komponent i rëndësishëm i vlerësimit final, i cili jo vetëm nxit studentët të mësojnë gjatë gjithë vitit, por dhe krijon fleksibilitet për pedagogun që të përdorë atë formë vlerësimi që i përgjigjet më mirë përthithjes së dijeve në lëndën përkatëse.			
Konkluzione	<i>Kriteret dhe metodat e testimit dhe vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale janë të detajuara në Rregulloren e Programit të Studimit, në pikën 5 "Verifikimi i dijeve të fituara nga studentët" si dhe në dokumente të veçanta rregullore të posaçme, të cilat bëhen publike dhe njihen nga të gjithë studentët.</i> <i>Kriteret dhe mënyra e testimit të njohurive u shpjegohen studentëve gjatë javës së orientimit, si dhe nga çdo pedagog në auditor për lëndët përkatëse, i cili i njofton studentët me përmbajtjen e syllabusit dhe formën e vlerësimit.</i> <i>Vlerësimi i përgatitjes akademike të studentit ka si komponent të rëndësishëm kontrollin e vazhdueshëm. Kjo formë vlerësimi, e ndarë në disa komponentë, nxit studentët të mësojnë gjatë gjithë vitit dhe është një tregues për të kuptuar nëse studentët po e kuptojnë materialin që po u ofrohet dhe nëse po arrihen objektivat mësimor.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.3

Institucioni siguron vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti duke përfshirë dhe procesin e ankimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar, të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	Referuar RVB-së, nota përfundimtare është rezultante e kombinimit të elementeve të mëposhtëm: • Provimi i ndërmjetëm; • Niveli i diskutimit në seminare; • Detyra e kursit (ese, prezantime, projekte)/dy detyra praktike; • Provimi përfundimtar; Nota përfundimtare është rezultante e kombinimit të disa elementeve, në varësi të tipologjisë së lëndës. Kështu për lëndët e Tipologjisë I, nota është kombinim i: a. Provimit përfundimtar (40%); b. Detyrave praktike: 2 (dy) x 30% = (60%); Për lëndët e Tipologjisë II, nota është kombinim i: a. Provimit përfundimtar (40%); b. Provimit të ndërmjetëm (30%); c. Detyrës së kursit (20%); d. Nivelit të diskutimit në seminare (10%). Kjo metodologji vlerësimi synon të: a. Përfshijë aspekte të ndryshme të të nxënit – duke balancuar vlerësimet teorike dhe praktike. b. Nxisë angazhimin e vazhdueshëm të studentëve, përmes një kontrolli të shpërndarë gjatë gjithë semestrit. c. Sigurojë një vlerësim objektiv dhe të drejtë, duke shmangur varësinë vetëm nga provimi përfundimtar. Vlerësimi i njohurive dhe përcaktimi i notës parashikohet në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit. <i>Evidenca Nr.19 "Silabuset"; Evidenca Nr.7 "Rregullorja e programit të studimit, pika 5.2"; Evidenca Nr.5 "Rregullore UET", Neni 24;</i>
Kriteri 2. Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat shmangin forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.	Për lëndët e këtij programi studimi (PIND, MSH "Drejtësi") nuk përdoren sistemet elektronike të testimit dhe vlerësimit të provimeve. Provimet janë të sekretuara dhe vendosen barcode nga koordinatori dhe departamenti gjatë zhvillimit të provimit. Anëtarët e personelit akademik mund të përdorin sistemin e Anti-plagjiaturës (<i>Turnitin Ephorus</i>), për vlerësimin e detyrave të kursit.



Kriteri 3. Vlerësimi përfundimtar i lëndës bëhet në përputhje me syllabusin dhe bazën ligjore në fuqi.	Përcaktimi i notës si vlerësim përfundimtar i lëndës kryhet në përputhje me syllabusin, i cili përmban detaje të qarta mbi strukturën e vlerësimit dhe komponentët përbërës, bazuar në përcaktimet e akteve rregullatore. <i>Evidenca Nr. 7 "Rregullorja e programit të studimit MSH në Drejtësi";</i> <i>Evidenca Nr. 19 "Silabuset e lëndëve";</i>
Kriteri 4. Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/feedback (nëse është i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të nxëniet për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.	Institucioni ka përshtatur një qasje të detajuar dhe konstruktive për vlerësimin e detyrave dhe provimeve, duke u fokusuar në dhënien e feedback-ut cilësor për studentët. Në procesin e vlerësimit të njohurive përfshihen edhe komentet e pedagogut dhe këshillat e dhëna për përmirësimin në të ardhmen. Kështu, vlerësimi i detyrave të kursit shoqërohet me komente për t'i evidentuar studentëve pikat e tyre të dobëta dhe mënyrën se si ato mund të përmirësohen. Në fund të pyetjeve të çdo eseje, është një seksion i emërtuar "<i>vlerësimi i pedagogut</i>" ku pedagogu jep feedback mbi esenë e studentit. Ndërsa, në tezat e provimeve është seksioni "<i>Komente të pedagogut rreth përgjigjes së studentit për pyetjen e kategorisë C "Mbaj qëndrimin tënd"</i>" ku pedagogu jep feedback mbi zhvillimin e pyetjes nga studenti. Studentët kanë në dispozicion edhe seancat sqaruese, ku ata mund të shohin në detaje korigjimin e pedagogut dhe të marrin drejtpërdrejtë nga ai/ajo komente të detajuara mbi vlerësimin e tyre. <i>Evidenca Nr. 7.3 "Formati i tezës së provimit përfundimtar"</i>
Kriteri 5. Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin/nuk lejojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra.	Departamenti merr masa për monitorimin e provimeve. Gjatë zhvillimit të provimit, salla monitorohet nga dy ose më shumë pedagogë të caktuar me miratim nga Departamenti. Rregullat e moskopjimit parashikohen në mënyrë strikte: "<i>Studentët duhet të lënë në një vend të veçantë (në bankat e para) çantat, librat, leksionet dhe çdo material tjetër mësimor e informativ që ka lidhje të drejtpërdrejtë ose të tërthortë me lëndën e provimit. Telefonat celularë duhet të jenë të fikur dhe nuk lejohet përdorimi i tyre për asnjë lloj qëllimi. Mosrespektimi i këtij rregulli nga ana e studentit duke e mbajtur aparatin e telefonit celular në gjendje pune konsiderohet shkelje e rregullores dhe penalizohet me</i>

	<i>përfundimin e provimit për studentin në fjalë dhe vlerësimin e tij me notën 4".</i> Plagjiatura dhe kopjimi, sipas Rregullore së UET, ndëshkohet me marrjen e notës 4 (katër) si notë përfundimtare, pavarësisht vlerës së elementeve të tjera vlerësuese (Neni 33 Plagjiatura dhe kopjimi: 33.1. <i>Plagjiatura nënkupton paraqitjen pa citim të materialeve të shkruara, të marra në përmasa të konsiderueshme nga një autor tjetër si tekste personale, në formë të pandryshuar dhe/ose në formë të përshtatur. Plagjiatura e provuar në paraqitjen e esesë dhe të diplomës ndëshkohet me marrjen e notës 4 (katër) si notë përfundimtare në disiplinën ose veprimtarinë formuese përkatëse, pavarësisht vlerës së elementeve të tjera vlerësuese; 33.2. Kopjimi nga materiale të shkruara ose nga fleta e provimit të studentëve të tjerë si edhe çdo komunikim me të tjerët gjatë orës së provimit dënohet me ndërprerjen e provimit për studentin që shkel rregullin, dhe studenti vlerësohet me notën 4 (katër) në lëndën në fjalë; 33.3. Në rast përsëritjeje të plagjiaturës ose të kopjimit, emri i studentit shënohet në regjistrin e Këshillit të Etikës dhe studenti paralajmërohet për përjashtim nga Universiteti. Herën e tretë të përsëritjes së kopjimit ose të plagjiaturës studenti përjashtohet nga Universiteti dhe humbet çdo të drejtë financiare që mund t'i takojë në bazë të kontratës së lidhur me UET-in.</i> Gjithashtu UET ka implementuar sistemin antiplagjiaturë (Turnitin Ephorus), i cili mundëson që punimet e studentëve të kalojnë një kontroll elektronik cilësor, të shpejtë dhe efikas për plagjiaturë, para se të marrin vlerësimin përfundimtar nga pedagogët ose komisionet e vlerësimit përkatës. <i>Evidenca Nr.5 "Rregullore e UET";</i> <i>Evidenca Nr.7.2 "Dokumenti A.IV. Sistemi i vlerësimit të studentëve, pika A.IV.2.6";</i>
Kriteri 6. Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen në meritë dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.	Rregullorja e UET-së si dhe Rregullorja e programit PIND parashikon procedurën dhe afatet kohore për dorëzimin e rezultateve mbi vlerësimin e dijeve dhe aftësive profesionale të studentëve. Dorëzimi i vlerësimeve të provimeve bëhet brenda 2 (dy) javëve nga data e zhvillimit të tyre. Në rastin e riprovimeve, duke qenë se numri i studentëve pjesëmarrës është

	më i ulët se në sezonet normale, afati për dorëzimin e korrigjimeve është 1 (një) javë. Teza është e shoqëruar me formatin përmbledhës të vlerësimit të studentëve, ku mbledhen pikët e sejcilës pyetje. Vlerësimet paraprake të dhëna në vlerësimet e vazhdueshme, ndërkohë janë dorëzuar dhe janë hedhur në sistem. Kjo metodologji formalisht dëshmon se rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive të studentëve bazohen mbi meritën dhe performancën e tyre. <i>Evidenca Nr.5 "Rregullore e UET", neni 27;</i>
Kriteri 7. Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me me rregullat që përfshihen në statut, rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.	Studentë kanë të drejtë për t'u njohur me vlerësimin, si dhe për të bërë kërkesë për rishikim. Studenti informohet në kohë reale për rezultatet e vlerësimit, përmes sistemit online (<i>LMS dhe UMIS</i>). Rregullorja e studimeve për këtë program studimim në pikën 5, të saj parashikon procedurën që mundëson studentin të kërkojë rishikimin e vlerësimit. Kështu pika 5.3.6 e Rregullores parashikon shprehimisht se: <i>"Në javën në vijim të shpalljes së rezultateve, pedagogu i pret studentët për të sqaruar çdo ankesë ose pretendim të mundshëm që ata mund të kenë lidhur me vlerësimin. Pas këtij afati pedagogu plotëson dhe dorëzon procesverbalin përfundimtar në Sekretarinë Mësimore"</i>. <i>Evidenca Nr.7 "Rregullorja mësimore e Programit të Studimit MSH në "Drejtësi", pika 5.3.6;</i>
Kriteri 8. Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur duhet të jetë transparente për palët e përfshira, dokumentohet dhe arkivohet.	Procedura e rivlerësimit është e parashikuar në aktet normative të UET. Kjo procedurë zhvillohet në mënyrë transparente, dokumentohet dhe arkivohet. <i>"Në rast se studenti ka ankesë për pikët që ka marrë në një nga komponentët e vlerësimit (provim i ndërmjetëm, detyrë kursi, provim përfundimtar), pasi ka konsumuar procedurën e sqarimit me pedagogun e lëndës, ai mund t'i drejtojë Drejtuesit të Departamentit të programit një kërkesë me shkrim, ku të parashatrojë arsyet mbi të cilat ai bazon ankesën. Me marrjen e ankesës, Drejtuesi i Departamentit ose Dekani, kur pedagogu i lëndës është vetë Drejtuesi i Departamentit, ngre një komision për shqyrtimin e kërkesës dhe për rivlerësimin e komponentit të ankimuar. Vendimi i Komisionit, i marrë me shumicën e anëtarëve, është</i>

	<i>përfundimtar dhe mund të jetë i njëjtë, më i lartë ose më i ulët se vlerësimi fillestar i ankimuar". (Evidenca Nr.7 "Rregullorja e programit të studimit", pika 5.7).</i> Procesverbalet e vlerësimit firmosen dhe dorëzohen në Sekretarinë Mësimore, si dhe arkivohen në zyrën e Sekretarit të Përgjithshëm.			
Konkluzione	<i>Nota përfundimtare është rezultante e kombinimit të disa komponentëve, që synojnë vlerësimin e vazhdueshëm. Për lëndët e këtij programi studimi nuk përdoren sistemet elektronike të testimit dhe vlerësimit të provimeve.</i> <i>Përcaktimi i notës si vlerësim përfundimtar i lëndës kryhet në përputhje me syllabusin. Institucioni ka përshtatur një qasje të detajuar dhe konstruktive për vlerësimin e detyrave dhe provimeve, duke u fokusuar në dhënien e feedback-ut cilësor për studentët. Departamenti merr masa për monitorimin e provimeve. Rregullorja e UET-së si dhe Rregullorja e programit PIND parashikon procedurën dhe afatet kohore për dorëzimin e rezultateve mbi vlerësimin e dijeve dhe aftësive profesionale të studentëve.</i> <i>Studentë kanë të drejtë për t'u njohur me vlerësimin, si dhe për të bërë kërkesë për rishikim. Procedura e rivlerësimit është e parashikuar në aktet normative të UET. Kjo procedurë zhvillohet në mënyrë transparente, dokumentohet dhe arkivohet.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.4

Programi i studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese tek studentët dhe synojnë zhvillimin e thelluar të kompetencave profesionale e shkencore tek studentët.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programi i studimit duhet të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë	Programi PIND "MSH" në "Drejtësi" ka për qëllim të pajisë studentët me një bazë të gjerë dhe të thellë të njohurive juridike. Programi PIND ofron një kombinim të ekuilibruar mes teorisë, praktikës dhe kërkimit shkencor. Ai synon të përgatisë juristë të

profesionale dhe të veçanta shkencore të studentëve.	aftë, profesionistë, duke i pajisur ata me njohuritë dhe aftësitë e nevojshme për të kontribuar në zhvillimin e sistemit të drejtësisë dhe shoqërisë. Ky objektiv realizohet përmes një plani studimor të strukturuar, që mbulon fushat kryesore të drejtësisë, si e drejta civile, penale, publike dhe ndërkombëtare. Programi përqendrohet në formimin e aftësive praktike dhe profesionale të studentëve përmes mësimi të bazuar në raste studimore dhe analiza konkrete të praktikave juridike, simulimeve të proceseve gjyqësore (gjyqe simuluese) për zhvillimin e aftësive argumentuese dhe të zgjidhjes së konflikteve. Thellimi i njohurive dhe aftësive profesionale konsiderohen si objektiva të Programit të Studimit. <i>Evidenca nr.7 "Rregullore e Programit të Studimit Msh në "Drejtësi", pika 3.3;</i>
Kriteri 2. Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane, sociale, komunikimit dhe ndërveprimit (përfshirë edhe në gjuhë të huaj).	Sipas Kurrikulës së Programit, lëndët e programit ndahen sipas 5 kategorive: Kategoria A-Lëndë Bazë "Përgatitje metodologjike dhe kulturë e përgjithshme" - në këtë kategori ofrohen njohuri mbi metodat e kërkimit, gjë që i ndihmon dhe në kryerjen e punimeve shkencore. Kategoria B-Lëndë Karakterizuese të Programit "Përgatitje për disiplinën shkencore" - ofron zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e profilit (shkenca humane). Edhe aftësitë e tjera në fushat e komunikimit dhe ndërveprimit preken nga lëndët e programit, për aq sa i nevojitet profesionit për të cilin përgatiten studentët. Kategoria C-Lëndë ndërdisiplinore ose Integruese "Nëndisiplina, orientime dhe grup-lënde me zgjedhje" - studentët profilizohen në fushën specifike. Kategoria D - Lëndë plotësuese – ofron lëndët plotësuese: "Gjuhë e huaj Anglisht", "Bazat e informatikës" dhe "Praktika profesionale". Kategoria E, "Punimi i diplomës" – parashikohet përgatitja e studentit nëpërmjet hartimit të punimit të diplomës (<i>Evidenca Nr. 14.1 "Kurrikula e programit Master Shkencor në "Drejtësi"</i>).
Kriteri 3. Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të	Në syllabuset e çdo lënde paraqiten kompetencat dhe aftësitë që fiton student nga kjo lëndë. Këto kompetenca dhe aftësi

paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të lëndës. Personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për zbatimin e tyre, si dhe për detyrimet përmbyllëse.	analizohen dhe shqyrtohen në përfundim të lëndës nga pedagogu i lëndës, duke përfshirë në diskutim edhe studentët dhe duke marrë mendimin e tyre për çfarë mund të përmirësohet në vijim. Studentëve i bëhet një përmbledhje e të gjithë koncepteve, instituteve apo momenteve kryesore të trajtuara gjatë kursit të lëndës. Për këtë qëllim përmbledhës dhe koncentrues shërbejnë esetë/detyrat e kursit që realizojnë javën e 13-të.
Kriteri 4. Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problemeve/çështjeve të caktuara; krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të përparuara kërkimore e shkencore dhe i mbështet ato; ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.	Mësimdhënia në program realizohet mbi bazën e kompetencave, duke synuar zhvillimin e aftësive praktike dhe profesionale të studentëve. Ky model u mundëson studentëve të aplikojnë dhe zhvillojnë më tej njohuritë teorike në ambiente laboratorike dhe praktika profesionale. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup gjatë analizës dhe interpretimit të rasteve konkrete. Pedagogët krijojnë një klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative dhe angazhohen në kërkime shkencore të avancuara, duke u shërbyer si model studentëve. Gjatë orëve të seminarit, studentët angazhohen në zgjidhjen e rasteve studimore, duke zhvilluar aftësitë për të punuar në grup. Për të mundësuar mobilitetin dhe zhvillimin profesional të studentëve, personeli akademik bashkëpunon me institucione dhe kompani partnere, duke ndërthurur metodat e mësimdhënies me praktikën e tregut të punës. Programi përfshin lëndë të dedikuara për zhvillimin e aftësive praktike, duke përfshirë analizën e rasteve studimore gjatë seminareve. Qëllimi i seancave në institucione private apo organe të administratës publike është t'u ofrojnë studentëve njohuritë bazë mbi menaxhimin e karrierës dhe t'i informojnë për tregun e punës dhe qasjen ndaj tij, përmes ekspertëve të fushës të ftuar. Praktika profesionale është një komponent i detyrueshëm i programit dhe synon të lidhë njohuritë teorike me profesionin përkatës, duke i familjarizuar studentët me realitetin e tregut të punës. Studentët zhvillojnë praktikën në institucione private dhe administrata shtetërore. Institucioni ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi për të siguruar zhvillimin profesional të studentëve në ambiente pune reale. Personeli akademik

	inkurajon studentët, veçanërisht ata të vitit të IV dhe V, që të përfshihen në projekte kërkimore. <i>Evidenca Nr.34.1 deri Nr.34.32 "Marrëveshjet e bashkëpunimit";</i> <i>Evidenca Nr.35 "Raporti i përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit";</i>
Kriteri 5. Personeli akademik efektiv dhe me kontratë realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë brenda/jashtë strukturës së programit të studimit.	Referuar kalendarit të aktiviteteve në UET, pedagogët e UET (staf PAE ose PAK) realizojnë orë/leksione të hapura, mbi zhvillimet e reja që kanë ndodhur në fushën përkatëse të së drejtës, si dhe mbi kërkimin shkencor në këto fusha. Nga pedagogët të UET, si dhe nga ekspertë dhe personalitete të ftuara, zhvillohen takime për çështje të aktualitetit dhe zhvillimeve të reja në fushën e shkencës dhe teknologjisë. Këto leksione zhvillohen si pjesë e lëndëve të caktuara të programit të studimit, por edhe si aktivitete ekstrakurrikulare, dhe janë të hapura për t'u ndjekur nga të gjithë studentët e interesuar dhe personeli akademik. <i>Evidenca Nr.55.3 "Kalendari i aktiviteteve 2020-2023";</i>
Kriteri 6. Institucioni nxit zhvillimin e ideve inovative, studimeve të përparuara kërkimore nga studentët dhe i mbështet financiarisht ato.	Nga GVJ nuk u konstatua ndonjë rast, kur studimi apo kërkimi i realizuar nga studentët e programit të studimit (PIND "MSH" në "Drejtësi"), apo dhe studentë të UET-së në përgjithësi, të jëtë mbështetur financiarisht nga IAL. Por në vizionin e kërkimit shkencor, të parashikuar në strategjinë e kërkimit shkencor, UET inkurajon përfshirjen e studentëve në veprimtari kërkimore-shkencore. Kështu sipas "Strategjisë Kërkimore Shkencore", pika 1.2 "Vizioni", parashikohet se: <u>"Kërkimi shkencor në UET është në funksion të rritjes cilësore të mësimdhënies e mësimnxënies nëpërmjet ngritjes së kualifikimit dhe ekspertizës së stafit akademik, transferimit të arritjeve bashkëkohore në fushën e shkencës tek studentët si dhe përfshirjes së këtyre të fundit në veprimtari kërkimore"</u> <i>Evidenca Nr.3.1 "Strategjia e kërkimit shkencor 2021-2025";</i>
Konkluzione	<i>Programi PIND "MSH" në "Drejtësi" ka për qëllim të pajisë studentët me një bazë të gjerë dhe të thellë të njohurive juridike, si dhe ofron një kombinim të ekuilibruar mes teorisë, praktikës dhe kërkimit shkencor.</i>

	<i>Sipas Kurrikulës së Programit, lëndët e programit ndahen sipas 5 kategorive, ku përfshihen dhe zhvillimi i aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, komunikimit, si dhe gjuhës së huaj.</i> <i>Në syllabuset e çdo lënde paraqiten kompetencat dhe aftësitë që fiton student nga kjo lëndë, të cilat analizohen dhe shqyrtohen në përfundim të lëndës nga pedagogu i lëndës.</i> <i>Mësimdhënia në program realizohet mbi bazën e kompetencave, duke synuar zhvillimin e aftësive praktike dhe profesionale të studentëve. Pedagogët realizojnë orë/leksione të hapura, mbi zhvillimet e reja që kanë ndodhur në fushën përkatëse të së drejtës, si dhe mbi kërkimin shkencor në këto fusha.</i> <i>Nuk u konstatua ndonjë rast, kur studimi apo kërkimi i realizuar nga studentët të jetë mbështetur financiarisht nga IAL.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.5

Institucioni ndjek një procedurë të qartë të detyrimeve përmbyllëse të studentit në programin e studimit dhe e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton procedurë të posaçme për detyrimet përmbyllëse, para realizimit të tyre dhe i bën ato publike dhe e bën atë publike.	Rregullore e UET, si dhe Rregullorja e programit të studimit parashikon një procedure të posaçme për mbrojtjen e diplomës nga studentët. Për të përmbyllur detyrimet e tyre, studentët e programit duhet të mbrojnë diplomën. Referuar, Dokumenti B.II "Për punimin e diplomës" jep në mënyrë të detajuar çdo procedure që ndiqet nga aplikimi dhe miratimi i temës së diplomës, deri tek procesi i udhëheqjes së saj përmes seancave metodologjike, deri tek formati i dorëzimit dhe mbrojtja përpara komisionit. <i>Evidenca Nr.5 "Rregullore UET", neni 38;</i> <i>Evidenca Nr.7 "Rregullore e programit të studimit", neni 8;</i> <i>Evidenca Nr.10 "Dokument B.II, "Mbi punimin e diplomës";</i>

Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme në funksion të të detyrimeve përmbyllëse.	Dokumenti B.II, “Mbi punimin e diplomës” parashikon se Departamenti dhe stafi akademik asistojnë studentët në përzgjedhjen e temës, standartet metodologjike, formatin e shkrimit të punimit të displomës, citimet, dorëzimin e tij deri në prezantimin e temës. Plani kalendar i procesit të diplomave/disertacioneve hartohet nga Sekretari i Përgjithshëm. Në fillim të muajit tetor, Departamenti organizon mbledhjen e Bordit të Tregut të Punës për të konsultuar tematikat e ndryshme, që mund të shërbejnë si objekt studimi në nivel diplome, si edhe për të identifikuar udhëheqësit potencialë të këtyre studimeve. Çdo anëtar i personelit akademik, brenda muajit tetor, njofton/përditëson fushat e tij të ekspertizës dhe ofron propozime konkrete për tema diplome ku është i gatshëm të udhëheqë studentë, duke mundësuar krijimin e një inventari me tema diplomash. Brenda javës së pestë të semestrit të parë të vitit akademik, studentët pajisen nga Departamenti përkatës me formularin e aplikimit për temën e diplomës. E gjithë kjo procedurë është e detajuar plotësisht.
Kriteri 3. Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë gjithë viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/ modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.	Në këtë program studimi, PIND “Master i Shkencave” në “Drejtësi”, detyrimet përmbyllëse realizohen vetëm nëpërmjet mbrojtjes së punimit të diplomës, bazuar në kërkesat e nenit 75, pika 5 e Ligjit Nr.80/2015, ku parashikohet se: “<i>Studimet e ciklit të dytë “Master i shkencave” përmbyllen me punim diplome dhe në përfundim të tyre lëshohet diplomë “Master i shkencave” në fushën e arsimimit të kryer</i>”.
Kriteri 4. Personeli akademik/ Udhëheqësi i diplomës orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të punimit të diplomës. Udhëheqësi i asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e punimit përmbyllës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai	Pedagogu udhëheqës e orienton dhe ndihmon studentin, duke zhvilluar seanca metodologjike me grupin e studentëve që ai udhëheq. Nga UET është miratuar <i>Dokumenti për punimin e diplomës</i>, ku në pikën B.II.5.2. parashikohet zhvillimi i seancave metodologjike sipas silabusit të miratuar, që trajtojnë çështje të tilla si: - <i>Përcaktimin shkencor të objektit të studimit;</i> - <i>Diskutimin e dobisë së punimit;</i> - <i>Përzgjedhjen e tematikës dhe të problematikës që do të trajtohet;</i> - <i>Ndërtimin e hipotezave dhe saktësimin e tyre;</i>

garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit.	- <i>Trajtimin e aspekteve metodologjike; etj;</i> Punimi i diplomës përpara dorëzimit për mbrojtje nga studenti, duhet të marrë edhe firmën e pedagogut udhëheqës. Kështu dokumenti rregullator i sipërpërmendur, në pikën B.II.8.8 parashikon se <i>"Punimi i diplomës duhet të mbajë firmën e studentit dhe të pedagogut udhëheqës, përndryshe nuk pranohen nga Koordinatorja"</i>. <i>Evidenca Nr.10 "Dokumenti për punimin e diplomës", pika B.II.5.2. dhe B.II.8.8;</i>
Kriteri 5. Institucioni asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.	Përpos seancave metodologjike, ku studenti që punon diplomën trajtonohet për përpunimin e metodave të paraqitjes sasiore, në aktet rregullatore të IAL-së, parashikohet se IAL lëshon sipas rastit edhe vërtetime, me qëllim që të mbështesë studentin në procesin e mbledhjes së të dhënave jashtë institucionit. <i>Evidenca Nr.10 "Dokumenti për punimin e diplomës";</i>
Kriteri 6. Në përfundim të provimit përfundimtar të përgjithshëm ose të mbrojtjes së punimit të diplomës, studenti vlerësohet me notë.	Punimi i diplomës vlerësohet me notë. Kështu parashikohet se: Për secilën Diplomë, Kryetari i Komisionit plotëson formatin përkatës dhe bën mbledhjen e pikëve të vlerësimit të udhëheqësit, oponentit dhe të secilit anëtar të Komisionit, e përpjesëton atë me numrin e vlerësuesve dhe bën konvertimin e rezultatit në notë përfundimtare, sipas sistemit të vlerësimit në fuqi. Në rastin kur udhëheqësi është edhe anëtar i Komisionit, vlerësimi i tij llogaritet vetëm një herë. Rezultati përfundimtar shënohet në Proces-verbal dhe bëhet publik në fund të çdo seance të mbrojtjes së diplomave, në prani të diplomantëve. <i>Evidenca Nr.10 "Dokumenti për punimin e diplomës", pika B.II.13.4. Procedura e mbrojtjes;</i>
Kriteri 7. Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin. Në përfundim të studimeve,	Në përfundim të studimeve, studenti që ka plotësuar të gjitha kërkesat e planit mësimor, ka shlyer të gjitha detyrimet ndaj UET-it dhe ka përmbushur detyrimet përmbyllëse të programit të studimit, pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin. Në Rregulloren e UET (nenit 40), parashikohet se pajisja e studentit me diplomën përkatëse bëhet brenda 6 (gjashtë)

studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.	muajsh. Diploma plotësohet me shkrim të qartë e me bojë teknike dhe nënshkruhet nga Rektori dhe Dekani i Fakultetit. Gjithashtu Rregullorja e UET parashikon, në mënyrë të detajuar, procedurën e tërheqjes së diplomës, e cila bëhet personalisht nga i diplomuari, kundrejt nënshkrimit në regjistrin përkatës.			
Kriteri 8. Institucioni ruan në përputhje me legjislacionin në fuqi kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet rast pas rasti informacione për studentin nëse kërkohen.	Në përputhje me kërkesat ligjore (kuadrit rregullator për arkivat), institucioni i arsimit të lartë, ruan një kopje të dokumentacionit të regjistrimit të studentit. Gjithashtu UET disponon një databazë të plotë të të dhënave të studentëve, e cila mundëson informacione për studentët në çdo kohë.			
Konkluzione	<i>Në programin e studimit PIND "Master i Shkencave" në "Drejtësi", detyrimet përmbyllëse realizohen vetëm nëpërmjet mbrojtjes së punimit të diplomës, bazuar në kërkesat e kuadrit ligjor në fuqi.</i> <i>Rregullorja e UET, si dhe Rregullorja e programit të studimit parashikon një procedure të posaçme për mbrojtjen e diplomës nga studentët. Departamenti dhe stafi akademik asistojnë studentët në punimin e diplomës. Pedagogu udhëheqës e orienton dhe ndihmon studentin, duke zhvilluar seanca metodologjike me grupin e studentëve që ai udhëheq.</i> <i>Punimi i diplomës vlerësohet me notë. Studenti që ka plotësuar të gjitha kërkesat e planit mësimor, pajiset me diplomën përkatëse. Pas përfundimit të studimeve nga studenti, kopje e dokumentacionit të tij të regjistrimit arkivohet dhe ruhet për një periudhë pa afat.</i>			
Shkalla e përmbushjes sëstandardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.6

Në rastin e programit të studimit në "Master Profesional/Shkencor" institucioni ndjek një procedurë të qartë të zbatimit të njohurive nëpërmjet praktikës laboratorike, praktikës profesionale, praktikave klinike dhe stazheve.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësitë përgjegjëse, në funksion të mësimdhënies dhe përfutimit të njohurive, garantojnë mjedise brenda ose jashtë institucionit, të përshtatshme për realizimin e praktikës laboratorike, praktikës profesionale.	IAL me strukturat e saj, në funksion të mësimdhënies në këtë program studimi, ka garantuar praktikë laboratorike brenda ambjenteve të IAL-së, si dhe praktikë profesionale pranë institucioneve pritëse. Godinat dhe infrastruktura në dispozicion për zhvillimin e procesit mësimor, përfshirë edhe në këtë program studimi (PIND "MSH" në "Drejtësi") plotëson standardet dhe kriteret e cilësisë. -Godinat janë të pajisura me sistem wireless; -Labororët e informatikës janë të pajisura me softwarët përkatës, për të mundësuar mësimdhënien dhe kërkimin; -Sallat për leksionet dhe seminarët janë të gjitha të pajisura me mjete audio vizive si PC, projektorë dhe foni; <i>Evidenca Nr.32 "Lista e subjekteve dhe institucioneve bashkëpunuese për programin e studimit dhe praktikat profesionale";</i> <i>Evidencat Nr.34.1 deri Nr.4.32;</i> <i>Evidenca Nr.42 "Infrastruktura në funksion të programeve të studimit";</i> <i>Evidenca Nr.42.1 "Lista e Laboratorëve";</i>
Kriteri 2. Institucioni, në bashkëpunim dhe partneritet, garanton realizimin e praktikave klinike dhe stazheve me format dhe teknologjinë më të fundit bashkëkohore me qëllim përfitimin më mirë të njohurive dhe kompetencave profesionale.	Studentëve të këtij programi studimi, nëpërmjet marrëveshjeve bashkëpunimi që ka UET me institucione publike, apo organizma private, u mundësohet kryerja e praktikave profesionale, me qëllim përfitimin e kompetencave profesionale. <i>Evidencat Nr.34 "Marrëveshje bashkëpunimi";</i> <i>Evidenca Nr.32 "Lista e Subjekteve dhe institucioneve bashkëpunuese për programin e studimit dhe praktikat profesionale";</i>
Kriteri 3. Praktikrat profesionale, klinike dhe stazhet e zhvilluara gjatë studimeve, ekuivalentohen në kredite dhe dokumentohen në dokumente të posaçme duke e shoqëruar me mendimin e	Rregullorja e programit të studimit dhe aktet e tjera parashikon mënyrë e dokumentimit të praktikës nga student, si dhe vlerësimin e saj me notë nga komisioni, duke qënë se praktika profesionale është përfshirë në planin mësimor si lëndë e veçantë. Kështu në Dokumentin mbi praktikën profesionale, në pikën B.I.10.5, parashikohet detyrimi i studentit që të plotësojë

trajnerëve dhe vlerësimin përkatës.	dhe të dorëzojë të gjithë dokumentacionin e praktikës, sipas parashikimeve të këtij udhëzimi. <i>Evidenca Nr.32.1 "Dokumenti B.1 Mbi praktikën profesionale"; Evidenca Nr.7 "Rregullore e Programit të Studimit MSH në Drejtësi";</i>			
Konkluzione	<i>Në funksion të mësidhënies janë garantuar ambiente laboratorike, si dhe praktikë profesionale pranë institucioneve pritëse. Studentëve të këtij programi studimi, nëpërmjet marrëveshjeve bashkëpunimi që ka UET me institucione publike, apo organizma private, u mundësohet kryerja e praktikave profesionale, me qëllim përfitimin e kompetencave profesionale.</i> <i>Rregullorja e programit të studimit dhe aktet e tjera parashikon mënyrë e dokumentimit të praktikës nga student, si dhe vlerësimin e saj me notë nga komisioni, duke qënë se praktika profesionale është përfshirë në planin mësimor si lëndë e veçantë.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi IV.1	
Personeli akademik që mbulon programin e studimit, përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik në përputhje me fushën e programit për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve

Kriteri 1. Personeli akademik efektiv dhe me kontratë, personeli ndihmës akademik, që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbush kërkesat ligjore në fuqi, për nivelin e duhur të kualifikimit akademik, për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e lëndëve/moduleve mësimore të programit. Ka fushë kërkimore në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe veçorinë e moduleve të tij.

Sipas raportit të vlerësimit të brendshëm (RVB), dokumentacionit bashkëngjitur, deklarimeve të drejtuesve të Fakultetit të Shkencave Juridike, Politike dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare Drejtësisë dhe Departamentit të Shkencave Juridike, verifikimit në terren të akteve të brendshme dhe dokumentacionit të institucionit, rezulton se, në këtë program studimi, ka të angazhuar personel akademik me përvojën e duhur në fushën e së drejtës, si në aspektin teorik dhe shkencor, ashtu dhe në aspektin e praktikës. Kjo do të thotë se jo vetëm përmbushen kriteret ligjore formale, si ai i gradës shkencore, titullit akademik dhe eksperiences në punë, por edhe ato materiale, - të njohjes së fushës specifike.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion, kërkuar gjatë vizitës në institucion (*Ev Nr 0.2. Tabelat përmbledhëse për Aneks_RVB copy tab 6*).për realizimin e programit të ciklit të dytë të studimit Msc në Drejtësi janë angazhuar për pesë vite akademike staf akademik me kualifikimn si më poshtë:

Tituj/ grada	20 - 21		21 - 22		22 - 23		23 - 24		24 - 25	
	PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK
Prof.Dr.	1	-	2	-	-	1	1	-	2	-
Prof. Asoc.	1	-	3	-	3	1	3	3	3	-
Dr./PhD	5	-	7	2	6	5	5	5	4	1
Msc.	2	-	2	-	7	2	6	2	4	1
Totali	9	0	14	2	16	9	15	10	13	2

Nga sa më sipër rezulton se në procesin e mësimdhënies të programit të studimit të ciklit të dytë Msc (PI) në Drejtësi, janë angazhuar edhe staf akademik me Msc, në ndryshim nga parashikimi i nenit 59/6 të Ligjit nr. 80/2015 ku përcaktohet: *“Personeli akademik, që angazhohet në mësimdhënie, duhet të ketë së paku kualifikim të ciklit pasardhës”*.

GVJ konstaton se:

	▪ për vitin akademik 2020-2021 22.2 % e stafit janë me Msc; ▪ për vitin akademik 2021-2022 12.5 % e stafit janë me Msc; ▪ për vitin akademik 2022-2023 36 % e stafit janë me Msc; ▪ për vitin akademik 2023-2024 32 % e stafit janë me Msc; ▪ për vitin akademik 2024-2025 33.3 % e stafit janë me Msc; <i>Për sa më sipër <u>GVJ rekomandon</u> që institucioni duhet të marrë masat që në mësimdhënien e këtij program studimi të angazhohen vetëm staf akademik me kualifikimin “Doktor Shkencash” në përputhshmëri me aktet ligjore.</i> <i>CV- të e personelit akademik të brendshëm dhe të jashtëm, Dosjet e personelit akademik të brendshëm dhe të jashtëm;</i> <i>Ev. 0.2. Tabelat përmbledhëse për Aneks_RVB copy .pdf;</i>																														
Kriteri 2. Personeli akademik efektiv duhet të mbulojë ngarkesën mësimore për programin e studimit në përputhje me kornizën ligjore në fuqi.	Nga verifikimi i të dhënave statistikore (ref. Tabelave 12.1, - 12.5), u konstatua se për pesë vitet akademike mbulimi i ngarkesës mësimore sipas viteve akademike është si vijon: <table><tr><th>Viti</th><th>Total orësh</th><th>PAE</th><th>PAK</th><th>PAE/PAK (%)</th></tr><tr><td>20 - 21</td><td>549</td><td>549</td><td>0</td><td>100% / 0 %</td></tr><tr><td>21 - 22</td><td>1389</td><td>1292</td><td>97</td><td>93% / 7%</td></tr><tr><td>22 - 23</td><td>1712</td><td>1214</td><td>498</td><td>71% / 29%</td></tr><tr><td>23 - 24</td><td>2486</td><td>1924</td><td>562</td><td>78% / 22%</td></tr><tr><td>24 - 25</td><td>1415</td><td>1295</td><td>120</td><td>92% / 8%</td></tr></table> Nga sa më sipër rezulton se për të 5 vitet akademike, ngarkesa mësimore për këtë program studimi, është përballuar me <u>mbi</u> 70% nga stafi akademik me kohë të plotë, sipas VKM Nr. 418, datë 10.05.2017 ku citohet: “Personeli akademik me kohë të plotë duhet të mbulojë jo më pak se 70% të ngarkesës mësimore për cdo program studimi”, në përputhje me fushën e kualifikimit dhe fushën kërkimore të anëtarëve të stafit. <i>Ev. 0.2. Tabelat përmbledhëse për Aneks_RVB copy .pdf; më konkretisht tabelat nr. 12.1-12.5;</i>	Viti	Total orësh	PAE	PAK	PAE/PAK (%)	20 - 21	549	549	0	100% / 0 %	21 - 22	1389	1292	97	93% / 7%	22 - 23	1712	1214	498	71% / 29%	23 - 24	2486	1924	562	78% / 22%	24 - 25	1415	1295	120	92% / 8%
Viti	Total orësh	PAE	PAK	PAE/PAK (%)																											
20 - 21	549	549	0	100% / 0 %																											
21 - 22	1389	1292	97	93% / 7%																											
22 - 23	1712	1214	498	71% / 29%																											
23 - 24	2486	1924	562	78% / 22%																											
24 - 25	1415	1295	120	92% / 8%																											

Kriteri 3. Institucioni duhet të garantojë dhe të dëshmojë qëndrueshmërinë e personelit akademik të angazhuar në programin e studimit, për të gjithë periudhën e akreditimit, duke përfshirë kontratat e punësimit dhe mbulimin me sigurime shoqërore dhe shëndetësore.	Sipas raportit të vlerësimit të brendshëm (RVB), deklarimeve të drejtuesve, deklarimeve të drejtuesit të Burimeve Njerëzore, personelit akademik të pranishëm, vërehet se, jo vetëm të dhënat financiare, e dëshmojnë aftësinë e institucionit për të garantuar qëndrueshmëri, por edhe elementë të tjerë të menaxhimit të personelit, procedura transparente rekrutimi, vlerësimi i performances i orientuar drejt zhvillimit profesional dhe personal, incentive të ndryshme motivimi, si: mobilitetet, subvencionim i kërkimit shkencor, trajnime, etj. <i>Ev. 2. Statuti UET_struktura organizative aktuale_shqip.pdf;</i> <i>Ev. 5. RREGULLORE UET.pdf;</i> <i>Ev.41. G-I-12-1 Formular i vetevlerësimit te performancës së personelit akademik.pdf;</i> <i>Ev. 41. G-I-12-1 Formular i vetevlerësimit te performancës së personelit akademik.pdf;</i> <i>Ev. 33. Të dhëna për trajnimet profesionale për stafin dhe studentët.pdf;</i> <i>Ev. 28.2. Te dhëna ne lidhje me mobilitetin e stafit dhe studenteve 2020-2025.pdf;</i> <i>Ev. 1.Vendim BA Nr. 01, dt.31.01.2024, Për përfitimin e grantit kërkimor nga PAE.pdf;</i>
Kriteri 4. Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kritere të përgjithshme dhe specifike të shpallura e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.	Sipas raportit të vlerësimit të brendshëm (RVB), deklarimeve të drejtuesit të Burimeve Njerëzore, dhe vizitës në institucion, rezulton se, Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kritere të përgjithshme dhe specifike të shpallura dhe që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programeve të studimit që ofron. Pra, të gjithë elementët e menaxhimit të personelit, duke përfshirë edhe rekrutimin dhe vlerësimin e performances, realizohen jo vetëm formalisht, por edhe në respektim të standardeve, duke garantuar për zgjedhjen dhe mirëmbajtjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programeve të studimit. <i>Ev. 2. Statuti UET_struktura organizative aktuale_shqip.pdf;</i> <i>Ev. 5. RREGULLORE UET.pdf;</i>

	<i>Ev.11. Ev. Dokumenti G. Rregullore për burimet njerëzore.pdf; Ev. 11.1. Shembull thirrje per staf akademik.pdf;</i> <i>Ev. 12.Procedure rekrutimi - Staf akademik.pdf;</i> <i>Dosjet e personelit;</i>
Kriteri 5. Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës akademik të përshtatshëm dhe të mjaftueshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.	GVJ gjatë vizitës në ambientet e UET, përkatësisht laboratorëve, bibliotekes, zyrës së Këshillimit të Karrierës dhe Kujdesit ndaj Studentit, etj, të cilët përdoren dhe frekuentohen nga studentët, u shoqërua dhe u informua nga personeli ndihmës i UET, i cili merrej ekskluzivisht me punën e laboratorëve, apo informimin e studenteve për rëndësinë e tyre. Kishte laboratorë, klinikë ligjore, etj, në dispozicion të këtij programi studimi. <i>Pavarësisht sa më sipër, <u>GVJ sugjeron</u> që për Klinikën ligjore, të krijohet një hapsirë e posacme me infrastrukturën e nevojshme.</i> <i>RVB; Vizita në institucion;</i>
Kriteri 6. Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmës dhe administrativ.	Institucioni mbledh, dokumenton dhe përditëson dosjen e personelit akademik të brendshëm dhe të jashtëm dhe koordinatorit të programit çdo vit. Në vizitën e GVJ në Zyrën e Burimeve njerëzore nga vëzhgimi me zgjedhje rastësore të dosjes së një personeli akademik të brendshëm dhe një të jashtëm, rezultoi se dosjet e tyre kishin të gjithë dokumentacionin (CV, kontratë punësimi, diploma, certifikata, certifikata trajnimesh, listë botimesh, listë të konferencave, raport mjeksor, dëshmi penaliteti, vlerësimi i performances, etj). Mirëpo, rezultoi se në dosjen e personelit ndihmës akademik mungon i administruar vlerësimi i performances, i cili realizohej si proces. <i>GVJ sygjeron se në vijim, pjesë e dosjes se personelit të jenë edhe formulari vlerësimit institucional të performances apo ai i vetëvlerësimit për këtë kategori personeli.</i> <i>Vizita në institucion-takimi me drejtues së Zyrës së Burimeve Njerëzore;</i>
Kriteri 7. Institucioni, në marrëveshje e bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e	Sipas raportit të vlerësimit të brendshëm (RVB) dhe deklarimeve të drejtuesve të Departamentit, Fakultetit, vërehet se, janë lidhur memorandume bashkëpunimi me institucione publike, studio ligjore, shoqëri të ndryshme tregtare, duke mbajtur komunikim të vazhdueshëm me ta, për të garantuar akomodimin e studentëve të këtij programi, në këto institucione dhe për të ftuar ekspertë të

kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.	fushës në auditor. Po ashtu, vërehet se, prej këtyre marrëveshjeve bashkëpunimi janë krijuar lidhje konkrete ndërmjet UET dhe aktorëve të tregut të punës, në funksion të punësimit të studentëve por edhe për të qenë më pranë nevojave të tregut të punës dhe reflektimit të tyre në programin e studimit. <i>Evidencat: 34.1. Memorandum Bashkëpunimi mes UET dhe Tirana Bank.pdf;</i> <i>Evidencat 34.2. Marreveshje Bashkëpunimi mes UET dhe INSTAT.pdf;</i> <i>Evidencat 34.3. Marreveshje Bashkëpunimi midis UET dhe OSHEE.pdf;</i> <i>Evidencat 34.4. Marreveshje Bashkëpunimi mes Drejtorise se Ndhimes Juridike Falas dhe UET.pdf;</i> <i>Evidencat 34.5. Marreveshje bashkëpunimi ndërmjet Kuvendit të Shqiperise & UET.pdf;</i> <i>Evidencat 34.6. Marreveshje Bashkëpunimi Komisioneri MD-UET.pdf;</i> <i>Evidencat 34.7. Marreveshje Bashkëpunimi Halimi Foundation Institute-UET.pdf;</i> <i>Evidencat 34.8. Marrëveshje Bashkëpunimit Balfin shpk-UET.pdf;</i>
Kriter 8. Personeli mbikqyrës në ambientin pritesë që angazhohet në realizimin e praktikave profesionale në bazë të marrëveshjeve, duhet të ndihmojë studentët në përmbushjen e detyrimeve /raportin përfundimtar të praktikës si dhe të marrë pjesë në procesin e vlerësimit të tyre për praktikën profesionale.	Pavarësisht se, programi i studimit është në herën e parë të zhvillimit, vërehet se, institucioni garanton infrastrukturën e nevojshme për zhvillimin e veprimtarive praktike në institucion apo jashtë tij, sikurse ka lidhur marrëveshje bashkëpunimi me institucione dhe organizata të ndryshme, ku parashikohet edhe bashkëpunimi në funksion të kryerjes së praktikave profesionale të studentëve, por dhe ka përcaktuar edhe dokumentacionin e fillimit, zhvillimit dhe përmbylljes me sukses të praktikës. <i>Ev. 32. Lista e subjekteve dhe institucioneve bashkëpunuese për programin e studimit dhe praktikat profesionale.pdf;</i> <i>32.1. Dokumenti B.I Mbi praktikën profesionale.pdf;</i> <i>Evidencat: 32.2. B-I-4 Formulari i vetvlerësimit të praktikës (nga Studenti).pdf;</i> <i>32.2.B-I-2 Formulari i vlerësimit të praktikës (nga Pedagogu).pdf; 32.3. B-I-3 Formulari i vlerësimit të praktikës (nga Mbikëqyrësi).pdf;</i>
Konkluzione	<i>Personeli akademik dhe ndihmës akademik që mbulon programin e studimit, i përmbush kryesisht standardet sasiore përsa i përket nivelit të duhur të kualifikimit akademik, për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e lëndëve/moduleve mësimore të programit.</i>

	<u>GVJ rekomandon që institucioni duhet të marrë masat që në mësimdhënien e këtij program studimi të angazhohen vetëm staf akademik me kualifikimin "Doktor Shkencash" në përputhshmëri me aktet ligjore.</u> <u>GVJ sygjeron të bëhet pjesë e dosjes se personelit ndihmës akademik/ administrativ edhe formulari vlerësimit institucional të performances apo ai i vetëvlerësimit.</u> <u>Gjithashtu, GVJ sugjeron, që për Klinikën ligjore, në varësi të numrit të studentëve dhe atij të planifikuar, të shikohet mundësia të krijohet një hapësirë e posaçme me infrastrukturën e nevojshme.</u>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi IV.2

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.	UET ushtron aktivitetin e tij në kampusin, me adresë Rruga "Xhanfize Keko", Nd. 56, në Tiranë, i cili ka mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme, të pajisura me infrastrukturën e nevojshme për zhvillimin e veprimtarisë akademike. Sipërfaqja e godinave të Universitetit është rreth 7,545 m². Në këtë shifër nuk përfshihet sipërfaqja përreth godinave. Sipërfaqet janë të ndara në salla leksionesh, gjithsej 15 salla me sipërfaqe totale 1447 m² dhe 1138 vende. Salla seminari janë gjithsej 13, me sipërfaqe 561 m², dhe 353 vende. <i>Ev. 42. Infrastruktura në funksion të programeve të studimit – Rr. "Xhanfize Keko" Extract RV 22-23.pdf;</i>
Kriteri 2. Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjediset tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të	Sipas raportit të vlerësimit të brendshëm (RVB), deklarimeve të drejtuesve të Fakultetit të Shkencave Juridike, Politike dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare dhe Departamentit të Shkencave Juridike, si edhe verifikimeve në terren, UET ka në përdorim 7 laboratorë mësimore informatike, 1 salle interneti 70 vende, dhe

teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.	auditore të pajisur me mjete audio vizive si PC, projektore dhe foni në rastin e sallave të leksionit. Po ashtu, UET ka systemin MOODLE që mbështet personelin akademik dhe studentin në procesin mësimor. <i>Ev. Infrastruktura në funksion të programeve të studimit_Blv. Gjergj Fishta.pdf;</i> <i>Infrastruktura në funksion të programeve të studimit – Rr. “Xhanfize Keko”.pdf;</i> <i>Urdhër Mbi zbatimin e platformes LMS.pdf, UET LMS Guide per pedagogun.pdf;</i> <i>UET LMS Guide per studentet.pdf, Video-trajnime mbi sistemin TEAMSLMS.pdf;</i> <i>Ev. 42.1. Lista e laboratoreve.pdf;</i>
Kriteri 3. Laboratorët, studiot, atelierë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.	Në UET, mjediset ku zhvillojnë procesin mësimor studentët e programit të studimit Master i Shkencave në Drejtësi, garantonin realizimin e procesit mësimor. Gjatë vizitës GVJ u njoh konkretisht me paisjen e sallave dhe laboratorëve me smartboard dhe sistem projektimi digjital, përfshirë edhe të gjitha mjetet e tjera audio dhe video. Laboratorët janë të pajisur me kompjutera, printer/fotokopje/skaner, projektor. Institucioni ka një numër të konsiderueshëm laboratorësh dhe një klinikë ligji, e cila nuk ka një ambient të dedikuar dhe infrastrukturën e nevojshme. <i>Për Klinikën ligjore, në varësi të numrit të studentëve dhe atij të planifikuar, të shikohet mundësia të krijohet një hapësirë e posaçme me infrastrukturën e nevojshme.</i>
Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit të studimit që ofron.	Sipas raportit të vlerësimit të brendshëm (RVB), deklarimeve të drejtuesve të Fakultetit të Shkencave Juridike, Politike dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare dhe Departamentit të Shkencave Juridike, si edhe verifikimeve në terren, UET ka në përdorim laboratorë mësimorë informatike, të gjitha të pajisura me mjete audio vizive si PC, projektore dhe foni në rastin e sallave të leksionit, të cilët janë në dispozicion për programet e studimit të ciklit të parë dhe të dytë dhe mjaftueshëm salla mësimore për zhvillimin e procesit akademik (leksione, seminare, workshope).
Kriteri 5. Institucioni garanton, me kapacitetet që	Sipas raportit të vlerësimit të brendshëm (RVB), deklarimeve të drejtuesve të Fakultetit të Shkencave Juridike, Politike dhe



zotëron dhe/ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera (vërtetuar nëpërmjet marrëveshjeve të posaçme të bashkëpunimit), që mjediset janë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike. Në rastet e programeve të studimit në fushën mjekësore, institucioni duhet të sigurojë strukturat spitalore dhe ambulatorie me kapacitetet e nevojshme.	Marrëdhënieve Ndërkombëtare dhe Departamentit të Shkencave Juridike, si edhe verifikimeve në terren, UET garanton infrastrukturën e nevojshme për zhvillimin e veprimtarive praktike në institucion sikurse dhe ka lidhur marrëveshje bashkëpunimi me institucione dhe organizata të ndryshme, ku parashikohet edhe bashkëpunimi në funksion të kryerjes së praktikave profesionale të studentëve.			
Konkluzione	<i>UET vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik, sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit.</i> <i>GVJ sugjeron që për Klinikën ligjore, në varësi të numrit të studentëve dhe numrit të planifikuar, të shikohet mundësia të krijohet një hapësirë e posaçme me infrastrukturën e nevojshme</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.3

Programi i studimit duhet të përmbajë literaturën e nevojshme dhe të përditësuar në mbështetje të mësimdhënies dhe mjediset mbështetëse të mësimnxënies, (bibliotekën, mjedise të posaçme).

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në	Sipas raportit të vlerësimit të brendshëm (RVB), deklarimeve të drejtuesve të Fakultetit të Shkencave Juridike, Politike dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare dhe Departamentit të Shkencave

gjuhën e programit të studimit (fizike dhe digjitale) garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme, të parashikuara në programin e studimit.	Juridike, si edhe verifikimeve në terren, vërehet se, në syllabusin e secilës lënde, vendoset literature bazë dhe ndihmëse, të cilat i lejojnë studentëve marrjen e njohurive të nevojshme të parashikuara në programin e studimit. Literatura u vendoset studentëve në dispozicion, në mënyrë fizike ose elektronike (në sistemin LMS) nga pedagogu i lëndës. Për të rritur cilësinë e mësimdhënies, perdoren libra të botuara nga shtëpitë më të medha botuese kryesisht të huaja dhe të botuara kryesisht brenda 5 viteve te fundit. Në mungesë të teksteve të përditësuara të fushës së Drejtësisë në gjuhën shqipe, disa nga literaturat bazë ofrohen në gjuhën angleze. Biblioteka është e antarsuar për një periudhë 5- vjeçare në libraritë elektronike Sage & Ebsco si edhe Questia. Biblioteka e UET është pjesë e sistemit COBISS. <i>Silabuset e lëndëve;</i> <i>Mbi evidencat e kërkuara gjatë vizitës në vend - MSH E Drejtë Publike dhe Ndërkombëtare.pdf;</i> <i>Leksion_Roli dhe përgjegjësia e shtetit në mbrojtjen e të drejtave të njeriut.pdf;</i>
Kriteri 2. Njësia përgjegjëse duhet të raportojë përditësime të literaturës me botime të viteve të fundit.	Vërehet se, sipas raportit të vlerësimit të brendshëm (RVB), si edhe verifikimeve në terren, kryesisht perdoren libra të botuara nga shtëpitë më të medha botuese kryesisht të huaja dhe të botuara brenda 5 viteve te fundit dhe në gjuhën angleze. <i>Evidencat: 45. Inventari i teksteve ne Biblioteke per programin e studimit.pdf;</i> <i>45.1. Dokumenti E-IV Mbi funksionimin e bibliotekës.pdf; 45.2. E-IV-2 Formular per pasurimin e literatures ne biblioteke.pdf;</i> <i>45.3. Lista e abonimeve ne revista apo e botimeve shkencore periodike.pdf;</i> <i>45.3. Shembull procedure_blerje literature.pdf;</i> <i>45.4. Lista e bibliotekave te profilizuara.pdf;</i>
Kriteri 3. Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të	Referuar informacionit të paraqitur në RVB dhe vizitës në institucion, GVJ konstatoi se UET vë në dispozicion të gjithë studentëve të regjistruar në këtë program studimi bibliotekën e cila ndodhet në godinën kryesore (C). Biblioteka është e pajisur me kompjutera ku studentët kanë akses në mënyrë të barabartë.

barabartë nga studentët e programit të studimit.	<i>Evidencat: 45.1. Dokumenti E-IV Mbi funksionimin e bibliotekës.pdf;</i>
Kriteri 4. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me fond fizik, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.	Sipas raportit të vlerësimit të brendshëm (RVB), si edhe verifikimeve në terren, abonimi në bibliotekat elektronike apo revistat, dhe kapacitetet infrastrukturore në bibliotekë (PC, wi-fi, printer) janë për shfrytëzim të barabartë e pa pagesë për të gjithë studentët, pa dallim program. <i>Evidencat: 45.1. Dokumenti E-IV Mbi funksionimin e bibliotekës.pdf; Verifikim ne terren;</i>
Kriteri 5. Institucioni duhet të krijojë kushte për shfrytëzim të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat online të fushës së programit të studimit.	Aktualisht UET është i regjistruar në dy biblioteka online Sage, Ebsco dhe Questia. Studentët kanë mundësi të kërkojnë dhe aksesojnë libra, artikuj, studime, apo botime të tjera sipas fushës së interesit, si dhe moduleve të këtij programi studimi. Numri i titujve online në të cilin kanë akses studentët, është i konsiderueshëm, duke rritur cilësinë e programit, si dhe mundësinë e përdorimit të teknikave koherente dhe innovative në këtë proces mësimor-kërkimor.
Kriteri 6. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike, që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizim për të gjithë studentët.	GVJ vizitoi ambientet e Bibliotekës së UET. Salla e bibliotekës kishte internet dhe ishte e pajisur me kompjutera që kanë të instaluar programe që u mundësojnë studentëve aksesin në bibliotekën elektronike. GVJ iu konfirmua nga punonjësi i bibliotekës dhe studentët, se biblioteka frekuentohej vazhdimisht nga studentët jo vetëm për të tërhequr libra apo materiale mësimore por edhe si sallë studimi.
Kriteri 7. Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave,	Biblioteka ofron shërbimet për studentët në orare që përshtaten me oraret e zhvillimit të procesit mësimor, për këtë program studimi. Për tu ardhur në ndihmë studentëve biblioteka ofron shërbim edhe gjatë fundjavës. Orari i bibliotekës, nga e Hënë-Premte 9:00-20:00 e Shtunë 9:00-17:00, dhe është i afishuar edhe në website e UET.

numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj.	<i>Dokumenti E-IV Mbi funksionimin e bibliotekës.pdf;</i>			
Kriteri 8. Biblioteka dhe njësitë përgjegjëse të programit ndjekin dhe raportojnë për cilësinë e fondit fizik të bibliotekës dhe fondit online (titujt kryesorë të pranishëm në shërbim të programit), përditësimin, shkallën e shfrytëzimit të fondit fizik dhe fondit online nga personeli akademik dhe studentët e programit, shfrytëzimi i sallave të studimit, duke nxjerrë në pah sa të efektshme kanë qenë përpjekjet për pasurimin fondit fizik dhe atij online, cilat janë kërkesat për tituj, por edhe për performancën e personelit akademik.	Sipas raportit të vlerësimit të brendshëm (RVB), deklarimit të përfaqësuesit të Bibliotekës, si edhe verifikimeve në terren, pasurimi i fondit të bibliotekës është një proces i vazhdueshëm dhe sistematik, i cili zhvillohet kryesisht në fillim të çdo viti akademik (mbledhjen nevojat në secilen njësi bazë dhe përcillen për miratim në strukturat përkatëse). <i>Dokumenti E-IV Mbi funksionimin e bibliotekës.pdf;</i> <i>Inventari i teksteve në Bibliotekë për fushën e programit të studimit.pdf;</i> <i>Shembull procedure_blerje literature.pdf;</i> <i>Mbi evidencat e kërkuara gjatë vizitës në vend - MSH E Drejtë Publike dhe Ndërkombëtare.pdf;</i> <i>Leksion_Roli dhe përgjegjësia e shtetit në mbrojtjen e të drejtave të njeriut.pdf;</i> <i>Verifikim në terren;</i>			
Konkluzione	<i>UET për këtë program studimi garanton literaturën e nevojshme dhe të përditësuar në mbështetje të mësimdhënies, po ashtu dhe mjediset mbështetëse të mësimnxënies (bibliotekën, mjedise të posaçme).</i> <i>Biblioteka fizike dhe online vihet në dispozicion të të gjithë studentëve në mënyrë të barabartë, pa pagesë dhe në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor për këtë program studimi. Institucioni ka mundur ofrimin e këtij shërbimi edhe gjatë fundjavës.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.4

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel: +355 (04) 222-43423

Web site: www.asc.al

E-mail: info@asc.al

Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administron të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.	Sipas raportit të vlerësimit të brendshëm (RVB), deklaramit të drejtuesve, si edhe verifikimeve në terren, UET ka deri diku një sistem nëpërmjet të cilit administron të gjithë informacionin që lidhet me studentët, pedagogët dhe aktivitetin e tyre, kryesisht aktivitetin e tyre akademik, - i cili quhet Moodle. Po ashtu, kanë deklaruar se kanë hartuar struktura e një sistemi të përgjithshëm menaxhimi, i cili së shpejti do të fillojë të ndërtohet. Sistemi i ri do të ketë të integruar të gjithë komponentët e menaxhimit institucional. Pavarësisht, numrit të studentëve dhe kostove të larta, <u>GVJ, sygjeron ndërtimin e këtij sistemi menaxhimi, duke ja përshatur nevojave dhe aftësive të UET.</u> <i>Manuali i përdoruesit të sistemit UMIS.pdf;</i> <i>Vizita në terren;</i>
Kriteri 2. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmës akademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.	Sipas deklaramit të drejtuesve, si edhe verifikimeve në terren, UET nuk ka një sistem nëpërmjet të cilit administron të gjithë informacionin që lidhet me personelin, HRMS: pagesa, vlerësimi performances, etj. Por është në proces të ndërtimit të një sistemi të tillë. Ndërsa, aktiviteti i tyre akademik – mësimdhënës, administrohet prej sistemit LMS. <i>UET LMS Guide per pedagogun.pdf;</i> <i>Vizita në terren;</i>
Kriteri 3. Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.	Sipas sqarimeve të dhëna dhe verifikimit në terren, UET, si e kemi cituar, ka vënë në përdorim platformen UET LMS, për personelin dhe studentet e programit të studimit, duke filluar nga viti akademik 2016-2017. Aktualisht, sistemi UET LMS ka si zëra: regjistrimi i studentëve në lëndët e tyre përkatëse dhe kanë akses të plotë në literaturën e lëndëve që ndjekin. Ndërsa, personeli akademi është regjistruar në sistem në lëndët e veta dhe mund të shohë vetëm lëndët e veta dhe të menaxhojë krejt lehtësisht gjithë literaturën e lëndëve përkatëse. Sistemi ofron

	mundësi për çdo lloj kërkese që personeli akademik mund të ketë për organizimin e procesit të mësimdhënies, si p.sh. caktimi detyrave të kursit, të gjitha llojet e vlerësimit, pyetësorë të ndryshëm, evente, forum diskutimi online mes studentëve dhe pedagogut, dhe shumë funksione të tjera. <i>UET LMS Guide per pedagogun.pdf;</i> <i>UET LMS Guide per studentet.pdf;</i> <i>Vizita në terren;</i>
Kriteri 4. Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit akademik dhe studentëve.	GVJ-ja konstaton se sistemi LMS, është i organizuar për të ofruar akses të dedikuar për të gjitha kategoritë e përdoruesve të planifikuar në këtë platformë. Përdorimi i këtij sistemi, nga pedagogët e angazhuar në këtë program studimi ofron mundësi më të mëdha për një komunikim interaktiv me studentët, si edhe shkëmbim informacioni, ofrim materiale, si dhe realizim të Quizz-ve, Assignments, Case studies, në funksion të rritjes së cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies. <i>UET LMS Guide per pedagogun.pdf;</i> <i>UET LMS Guide per studentet.pdf;</i>
Kriteri 5. Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet dhe autoritetet drejtuese.	Aktet rregullatore të institucionit sigurojnë monitorimin e aktivitetit akademik e administrativ. Aktiviteti mësimor monitorohet nëpërmjet regjistrimit mësimor i cili plotësohet dhe nënshkruhet nga pedagogu i lëndës, në fillim dhe mbarim të procesit mësimor. Në rast mungese bëhet njoftimi i drejtuesit të njësisë bazë, si dhe plotësohet formulari për zëvendësimin e mësimit. Kontrolle të rastësishme në lidhje me zhvillimin e mësimit bëhen nga njësia bazë, njësia kryesore si dhe nga njësia e sigurimit të cilësisë. Sipas sqarimeve të dhëna prej personelit të IT-së, sistemet janë mjete efikase për të monitoruar mbarëvajtjen e procesit akademik, përmes gjenerimit në kohë reale të të dhënave statistikore. <i>Vizita në terren;</i> <i>Evid 5. RREGULLORE UET;</i>

Kriteri 6. Informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë, ku njëra prej tyre është gjuha shqipe.	Pas konsultimit të website të UET, GVJ konstatoi se janë bërë publike informacione që lidhen me programin e studimit, njësinë bazë që ofron programin e studimit, personelin akademik, si dhe një sërë informacione dhe aktivitete të tjera të cilat publikohen në faqen e internetit në dy gjuhë shqip dhe anglisht. https://uet.edu.al/ https://uet.edu.al/en/;			
Konkluzione	<i>GVJ konstaton se, Institucioni disponon sistem menaxhimi efektiv nëpërmjet të cilit administron informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.</i> <i>Sistemi i menaxhimit ka të integruar disa platforma të cilat mundësojnë një komunikim interaktiv me studentët, si edhe shkëmbim informacioni, në funksion të rritjes së cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies.</i> <i>Pavarësisht, numrit të studentëve dhe kostove të larta, <u>GVJ</u> sygjeron ndërtimin e një sistemi menaxhimi universal, duke ja përshtatur nevojave dhe aftësive të UET.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.5

Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton një raport financiar të kostove të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programeve të studimit për	UET është IAL jo publike që zhvillon aktivitetin e tij kryesisht mbi bazën vetëfinancimit dhe/ose financime të tjera. Burimet e financimit dhe menaxhimi i fondeve përcaktohen dhe aprovohen nga Bordi i Administrimit. Po ashtu, veprimtaria kërkimore e shkencore financohet nga vetë universiteti apo edhe nga projekte të ndryshme ku merr pjesë apo edhe donacione të ndryshme legjitime. UET harton çdo vit një raport në lidhje me transparencën financiare, ku pasqyrohen të dhënat dhe gjendja financiare. Në raport pasqyrohen të dhëna financiare në lidhje me

74

të paktën një cikël të plotë studimi.	koston për secilin program studimi, duke bërë kështu edhe një vlerësim të ecurisë dhe vazhdimësisë së programeve, në përputhje me kërkesat ligjore dhe standardet e vendosura, e duke analizuar shpenzimet operacionale dhe ato kapitale. Në to përfshihet kosto për çdo program studimi, kostot operacionale dhe të mirëmbajtjes, etj. Analiza e kostos së programeve shqyrtohet në raport me të ardhurat që burojnë nga këto programe. Sipas të dhënave të vëna në dispozicion nga universiteti, për tre vitet e fundit, të ardhurat janë gjernuar nga: tarifat për dhe gjatë shkollimit, grantet për kërkim dhe kontratat si dhe aktivitete tregtare. <i>Evidenca: Statuti i UET;</i> <i>Rregullore e UET-së;</i> <i>Vendim Senati Nr.Prot 15 Date 08.10.2019 Per miratimin e Broshures se dokumenteve dhe rregulloreve te PS.pdf;</i> <i>Raportet e Auditimit;</i> <i>Vizita në terren;</i>
--	---



75 

Kriteri 2. Plani i financimit të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programeve, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat online, detyrimet financiare, grantet vendase apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimit, projektet dhe zëra të tjerë.	Sipas sqarimeve të dhëna, vërehet se, UET ka qëndrueshmëri financiare dhe kapacitete financiare për të përballuar këtë program studimi, por mbetet të analizohet ecuria e këtij programi studimi dhe kostoja për mbajtjen e tij në të ardhmen. Kështu që <u>GVJ rekomandon</u> që të bëhet vlerësimi financiar mbi kosto-efektivitetin e këtij programi studimi të integruar MSH.
Kriteri 3. Institucioni kryen auditim periodik, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij.	Referuar dokumentacionit të paraqitur dhe vizitës në institucion, UET bën procesin e hartimit të pasqyrave financiare dhe kryen auditim e tyre çdo vit. Për këtë, çdo vit hartohet raport në lidhje me transparencën financiare, - të ardhura, shpenzime apo investime, të cilat çdo vit vlerësohen prej një audituesi ligjor të pavarur, i cili ka dhënë opinionin në lidhje me pozicionin financiar, performancën dhe përputhjen me standardet e kërkuara të kontabilitetit. UET, kryen auditim të pasqyrave financiare çdo vit. <i>Ev. 50.4 RAPORT AUDITIMI 2021.pdf;</i> <i>50.5 RAPORT AUDITIMI 2022.PDF;</i> <i>50.6 RAPORT AUDITIMI 2023.PDF;</i> <i>50.2 Pasqyrat Financiare 2022 me shënime.pdf;</i> <i>50.3 Pasqyrat Financiare 2023 me shënime.pdf;</i> <i>50.1 Pasqyrat Financiare 2021 me shënime.pdf;</i> <i>50.2 Pasqyrat Financiare 2022 me shënime.pdf;</i>

76

	<i>50.3 Pasqyrat Financiare 2023 me shënime.pdf;</i>			
Kriteri 4. Institucioni raporton deri në nivelin e njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit mbi realizimin e buxhetit të miratuar të vitit paraardhës.	UET, për të kontrolluar ecurinë dhe vazhdimësinë konform rregullave dhe standardeve, mban të dhëna krahasuese edhe për vitet e kaluara duke bërë të mundur evidentimin e elementeve kryesore që ndikojnë në performancën e qëndrueshme dhe rezultative të institucionit.			
Kriteri 5. Institucioni garanton qëndrueshmërinë financiare për zhvillimin e programeve të studimit të njësisë bazë dhe kapacitetet financiare të mjaftueshme për ecurinë normale të këtyre programeve. Në rastet e nevojave të përmirësimit të situatës financiare institucioni planifikon ndërhyrje të posaçme dhe diversifikimin eventuale të financimit të programeve të studimeve.	Nga informacioni dhe vizita institucionale, deklarohet se Institucioni ka stabilitet financiar dhe kapacitet financiar për të garantuar në vijim aktivitetin akademik dhe kërkimor-shkencor të tij. Ndarja dhe mënyra e përdorimit të fondeve bëhet duke mbajtur parasysh kërkesat e shprehura prej njësisë/strukturave, me qëllim arritjen e objektivave, si dhe realizimin e misionit të tij. Në buxhetin vjetor parashikohet edhe mënyra e përdorimit të fondeve, të ardhurat dhe shpenzimet e kryera. Të ardhurat e krijuara përdoren në funksion të veprimtarisë akademike, administrative e kërkimore-shkencore.			
Konkluzione	<i>Institucioni vlerëson dhe dokumenton gjendjen financiare të tij në përputhje me aktet e brendshme dhe rregullimet ligjore. Ai zbaton gjithashtu edhe detyrimet që lidhen me vlerësimin e situatës financiare nëpërmjet auditimit të brendshëm dhe auditimit të jashtëm të veprimtarisë financiare.</i> <i>GVJ rekomandon që të bëhet vlerësimi financiar mbi kosto-efektivitetin e këtij programi studimi, për një planifikim sa më të mirë të kostove të programit të studimit.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel: +355 (04) 222-43423

Web site: www.asc.al

E-mail: info@ascal.al

V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

Standardi V.1	
Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.	Programi i studimit i integruar Master i Shkencave në Drejtësi zhvillohet në përputhje me Ligjin e Arsimit të Lartë, statutin, rregulloren e UET, si edhe rregulloren e programit të studimit. Në këto akte të brendshme, rregullohet zhvillimi i këtij programi studimi, ku përcaktohen të gjitha strukturat, rolet dhe përgjegjësitë përkatëse për mbarëvajtjen e plotë të programit. Këto rregullore ju shërbejnë edhe studentëve të këtij programi studimi për t'u bërë me dije për të drejtat dhe detyrimet e tyre përgjatë gjithë kohës së studimit pranë këtij institucioni <i>Evidenca: Statuti i UET;</i> <i>Rregullore e UET-së;</i> <i>7. Rregullore e programit të studimit DIND - shqip.pdf;</i> <i>27.1. Dokumenti D.I. Mbi politikën, kriteret dhe procesin e pranimin të studentëve.pdf;</i> <i>Vizita në terren;</i>
Kriteri 2. Politikën dhe procedurat nga hyrja në dalje garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.	Referuar statutit dhe rregullores së institucionit, të programit të studimit dhe deklarimeve gjatë vizitës në institucion, dëshmohet se një ndër parimet e funksionimit të UET lidhet me faktin se kriteret dhe procedurat në hyrje e deri në dalje garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për student e më pas studentët e këtij institucioni. GVJ, vëren se pavarësisht, se ky program është relativisht i ri, studentët e tij janë të përfshirë në strukturat studentore apo në vendimarrje të tij. <i>Evidenca: Statuti i UET;</i> <i>Rregullore e UET-së;</i>

78

	<i>7. Rregullore e programit të studimit DIND - shqip.pdf;</i> <i>55.2. D.III Mbi përfshirjen e studentëve në qeverisjen e UET.pdf;</i> <i>5.Mbi përbërjen e Senatit Akademik të UET.pdf;</i>
Kriteri 3. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve për t'u pranuar në programin e studimeve. Institucioni bashkëpunon me strukturat e ngritura në zbatim të maturës shtetërore, sipas ligjit dhe udhëzimeve përkatëse.	Kriteret për pranim në program miratohen nga Senati akademik dhe i bëhet me dije QSHA. Referuar dokumentit Mbi politikën, kriteret dhe procesin e pranimit të studentëve, seksioni D.I.2, në këtë program mund të pranohen shtetas të huaj dhe shqiptar. Po ashtu, sipas dokumentit Mbi transferimet, njohjen e krediteve dhe mobilitetin e studentëve, në këtë program mund të transferohen edhe shtetas të huaj dhe shqiptar. GVJ e konfirmoi këtë edhe në takimin që zhvilloi me studentët e programit të studimit gjatë vizitës në institucion. <i>28. Dokumenti D.II. Mbi transferimet, njohjen e krediteve dhe mobilitetin.pdf;</i> <i>27.1. Dokumenti D.I. Mbi politikën, kriteret dhe procesin e pranimit të studentëve.pdf;</i> <i>Vizita në terren;</i>
Kriteri 4. Kriteret, procedurat e pranimit dhe përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjeshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.	Krahas të dhënave që jepen në RVB-në e programit të studimit dhe dokumentacionit shoqërues, GVJ konfirmoi ekzistencën e kriterëve e procedurave edhe gjatë vizitës në institucion ku studentët dakortësojnë ekzistencën dhe aksesueshmërinë e të gjithë informacionit që lidhet me procedurën që nga pranimi dhe përzgjedhja e studentëve, përparimit përgjatë programit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjeshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit, informacione këto që janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga studentët apo secili i interesuar. <i>7. Rregullore e programit të studimit DIND - shqip.pdf;</i> <i>28. Dokumenti D.II. Mbi transferimet, njohjen e krediteve dhe mobilitetin.pdf;</i> <i>27.1. Dokumenti D.I. Mbi politikën, kriteret dhe procesin e pranimit të studentëve.pdf;</i> <i>Vizita në terren;</i>
Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni informon	Informimi i të gjithë të interesuarve në lidhje me UET, programet e studimit dhe kriteret e pranimit në to, realizohet nëpërmjet fushatës sensibilizuese për tërheqjen e kandidatëve

publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.	për studentë në këtë program studimi. Në përshtatje me teknologjinë, UET është fokusuar në platformat e mediave sociale dhe ato të digjital marketingut në komunikimin e tij, jo vetëm të përditshëm por edhe në raste të fushatave të marketingut. UET nëpërmjet faqes zyrtare të tij, azhuron informacione të detajuara dhe të dhëna që i vijnë në ndihmë studentëve aktual dhe atyre potencial për studimet Master. Pranimi në këtë program studimi mbështetet në këto kriteret: - Kriteri i meritës (mesatarja e shkollës së mesme), etj; - Kuotat të paracaktuara nga UET dhe miratuara nga MAS; <i>7. Rregullore e programit të studimit DIND - shqip.pdf;</i> <i>27.1. Dokumenti D.I. Mbi politikën, kriteret dhe procesin e pranimit të studentëve.pdf;</i> <i>Vizita në terren;</i>
Kriteri 6. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të marginalizuara.	Institucioni dëshmon se nuk aplikon kriteret shtesë por zbaton aktet ligjore dhe nënligjore të MAS-it lidhur me përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të marginalizuara.
Kriteri 7. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve nga shtete të tjera.	Institucioni dëshmon se nuk aplikon kriteret shtesë por zbaton aktet ligjore dhe nënligjore të MAS-it lidhur me përzgjedhjen e kandidatëve nga shtete të tjera.
Kriteri 8. Institucioni harton politika të ndihmës/bursave për shtresa në nevojë dhe për të rritur cilësinë e pranimit në programe me përparësi për institucionin dhe për zhvillimin ekonomik të vendit.	GVJ nga dokumentacioni bashkëshoqërues konsaton se UET zbaton të gjitha aktet ligjore dhe VKM-të që lidhen me kategoritë e individëve që përjashtohen nga tarifat e shkollimit dhe kushtet e përfitimit të ndihmës/bursave për shtresat në nevojë.
Konkluzione	<i>UET ndjek dhe zbaton politika dhe procedura efektive për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin,</i>


	<i>njohjen, vlerësimin e dijeve, mbështetjen dhe diplomimin në programin e studimit.</i> <i>Politikat dhe procedurat që mbulojnë ciklin akademik të studentëve janë në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e tjera rregullatore.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.2

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.	Në bazë të dokumentacionit të shqyrtuar, por edhe gjatë takimit me studentët, GVJ konsatoi se që në hyrje të studimeve e deri në diplomim, studentët informohen vazhdimisht mbi çështje të rëndësishme që lidhen me veprimtarinë e tyre të përditshme akademike, si; kriteret e pranimit, procedurat e regjistrimit dhe tarifat, transferimi i studimeve dhe mobilitetet, këshillimin e studentëve, të drejtat e përfaqësimit, veprimtari akademike, kulturore, njoftime, sikurse dhe kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin. Këto kriteret dhe procedura janë pjesë e Rregullores së UET, rregullore të Fakultetit dhe rregullore të programit të studimit. Rregullore e UET është e publikuar në faqen zyrtare web të institucionit. <i>Evidenca: Statuti i UET; Rregullore e UET-së;</i> <i>7. Rregullore e programit të studimit DIND - shqip.pdf;</i> <i>55.2. D.III Mbi përfshirjen e studentëve në qeverisjen e UET.pdf;</i> <i>28. Dokumenti D.II. Mbi transferimet, njohjen e krediteve dhe mobilitetin.pdf;</i> <i>27.1. Dokumenti D.I. Mbi politikën, kriteret dhe procesin e pranimit të studentëve.pdf;</i>

	12. Dokumenti E.VII Mbi funksionimin e Zyrës së Këshillimit të Karrierës dhe Kujdesit ndaj Studentit.pdf; Vizita në terren;
Kriteri 2. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme.	Studentët informohen në lidhje edhe me njohjen e kualifikimeve të tyre të mëparshme ose të kryera herët në kohë, sikurse pranohen edhe transferime të studentëve nga institucione të tjera të arsimit të lartë brenda dhe jashtë vendit. E gjithë kjo procedurë është e rregulluar me dokumentacion dhe parashikohet në rregulloren e transferimeve, rregulloren e programit të studimeve si dhe nga Katalogu i UET por edhe pranë zyrës së Këshillimit të Karrierës. 28. Dokumenti D.II. Mbi transferimet, njohjen e krediteve dhe mobilitetin.pdf;
Kriteri 3. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.	Informimi i studentëve lidhur me kriteret e proceduarat e vlerësimit të dijeve realizohet në disa forma: - Njëpërjet rregulloreve të UET dhe rregullores programit të studimit (kreu v); - Njëpërjet praktikës së informimit të studentëve të viti të parë; - Njëpërjet personelit akademik në fillim të çdo semestri; GVJ konstaton se informimi i studentëve lidhur me proceduarat e vlerësimit është i larmishëm dhe i shtrirë në disa plane. Kjo u konfirmua edhe gjatë takimit me studentët në ditët e vizistës në institucion.
Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.	GVJ konstaton se institucioni i arsimit të lartë, njëpërjet rregullores programit të studimit (kreu 8), informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit përfundimtar dhe diplomimit në programin e studimit. Procedura e mbrojtjes së diplomës, për studentët e programit Master i Shkencave në Drejtësi është vetëm me mbrojtje tezë diplome.
Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni i arsimit të lartë publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon	Mbështetur në strategjinë e marketingut UET planifikon dhe zbaton kalendarin vjetor të aktiviteteve të cilat kanë si qëllim rekrutimin e studentëve të rinj në programet e studimit që ofrohen. Disa prej natyrës së aktiviteteve janë:



takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit.	- Turi i promovimeve, që përshin konferencë me maturantët dhe vizitat e stafit në institucionet arimore të arsimit parauniversitar; - Ditëve të hapura dhe panairët; <i>Ev. [12.2. Poster Panairi i Karrierës 2021_2022_2023_2024.pdf; 51. Politika e marketing-ut të programit të studimit,.pdf;.</i>			
Konkluzione	<i>UET vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program.</i> <i>UET informon studentët mbi kriteret dhe procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive në programin e studimit, praktikës profesionale, si dhe përmbylljes së tyre me tezë diplome.</i> <i>UET realizon një numër aktiviteteve dhe ofron informacion duke informuar përpara fillimit të çdo viti akademik të interesuarit dhe studentët e ardhshëm për programet e studimit.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.3

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënësve dhe mundësitë e punësimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit.	Institucioni ka disa forma të informimit të studentëve përsa i takon njohjes me strukturën dhe kohëzgjatjen e programit të studimit, si: - Nëpërmjet sesionit informues që realizohet në fillim të vitit akademik; - Nëpërmjet rregullores së programit të studimit; - Nëpërmjet personelit akademik të departamentit; - Nëpërmjet faqës së internetit ; <i>RVB; Vizita në Institucion;</i>

Kriteri 2. Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion dhe dokumentacion/ udhëzues të posaçëm për lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.	Që në momentin e regjistrimit, studenti pajiset me programin e studimit që përmban lëndët dhe modulet e tij. Institucioni siguron akses dhe informacion për studentët në lidhje me elementët e programit të studimit që ata ndjekin përmes rregulloreve përkatëse, sistemit UMIS/ platformes LMS dhe personelit akademik që realizon programin. Nga shqyrtimi i dokumentacionit GVJ konstaton se Institucioni kontrollon marrjen apo jo të informacionit nga studentët për modulet, lëndët, metodën e vlerësimit dhe detyrat detyrat që zhvillohen gjatë kursit, nëpërmjet pyetësorëve që i realizon në fund të çdo semestri. <i>Ev. 8. Dokumenti F.VII Mbi sigurimin e brendshëm të cilësisë.pdf ;</i>
Kriteri 3. Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës.	Institucioni ka disa struktura që adresojnë vënien në kontakt të studentëve me mundësitë e punësimit. Institucioni organizon panairë të tregut të punës, studimin e tregut të punës, marrëveshje bashkëpunimi me sektorin publik dhe privat, si dhe ka strukturën e këshillimit të karrierës që mundëson lidhjen e studentëve me tregun e punës. <i>Ev. 17. Studimi për tregun e punës për programin.pdf;</i>
Kriteri 4. Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar për zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.	GVJ gjatë vizitës në institucion dhe takimet e realizuara u informua mbi sistemin dhe strukturat përgjegjëse për informimin e studentëve mbi zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor. Institucioni, përmes koordinatorit të programit të studimit mban komunikim dhe informon, në mënyra të ndryshme, studentët për njoftimet që lidheshin me procesin mësimor. <i>Ev.36. Shembull Vendimi për Koordinatorin e Programit.pdf; 36.1. Për përcaktimin e detyrave të koordinatorit të programit.pdf;</i>
Kriteri 5. Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë.	Sipas raportit të vlerësimit të brendshëm (RVB), deklarimit të drejtuesve, si edhe verifikimeve në terren, UET ka deri diku një sistem nëpërmjet të cilit administron të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre, kryesisht aktivitetin e tyre akademik, - i cili quhet UMIS. Po ashtu, kanë deklaruar se kanë hartuar strukturën e një sistemi të përgjithshëm menaxhimi, i cili së shpejti do të fillojë të ndërtohet. Sistemi i ri do të ketë të integruar të gjithë komponentët e menaxhimit institucional.

	<i>Ev. 46. Manuali i perdoruesit te sistemit UMIS.pdf,</i>			
Konkluzione	<i>UET vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxëniet dhe mundësitë e punësimit.</i> <i>Studentët janë të përditësuar dhe kanë si akses fizik ashtu edhe online, në informacionin në lidhje me procesin mësimor, infrastrukturën, logjistikën dhe elementë të tjerë mbështetës të tij.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.4

Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilin e studentëve që ndjekin programin e studimit, nga pranimi deri në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve, në programin e studimit.	Pavarësisht se, programi i studimit është në hapat e tij të zhvillimit, vërehet se, institucioni mban dokumentacionin që lidhet me statistikat vjetore për numrin e studentëve të regjistruar, transferuar, cilësinë në hyrje apo të dhëna të tjera të nevojshme. <i>Ev. 28.2. Te dhena ne lidhje me mobilitetin e stafit dhe studenteve 2020-2025.pdf;</i> <i>33. Të dhëna për trajnimet profesionale për stafin dhe studentët.pdf;</i> <i>43.1. Raporti i mobiliteteve _staf_student.pdf;</i> <i>27. Cilësia në hyrje PIND DREJTESI.pdf;</i>
Kriteri 2. Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit, deri në diplomimin	Në vizitën e realizuar në institucion dhe takimin me sekretarinë mësimore, GVJ iu vu në dispozicion të dhëna që lidheshin me numrin e studentëve të regjistruar në program, si edhe u konsultua regjistri përkatës. Gjithashtu përmes sistemit Moodle apo programit të avancuar excel, institucioni i disponon

e tyre, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.	statistikat në çdo kohë. Gjatë vizitës në sekretari, GVJ verifikoi me zgjedhje dosjet personale dhe të ecurisë akademike të dy studentëve të programit të studimit Master i Shkencave në Drejtësi dhe konstatoi plotësinë e tyre. Referuar të dhënave të marra në sekretarinë mësimore gjatë vizitës në institucion numri i studentëve në këtë program studimi është si më poshtë vijon: <table><tr><th>Viti akademik</th><th>Nr i të regjistruarve</th><th>Nr i të ç’regjistruarve</th><th>Nr aktual</th></tr><tr><td>2020-2021</td><td>31</td><td>6</td><td>25</td></tr><tr><td>2021-2022</td><td>40</td><td>5</td><td>35</td></tr><tr><td>2022-2023</td><td>31</td><td>3</td><td>28</td></tr><tr><td>2023-2024</td><td>38</td><td>2</td><td>36</td></tr><tr><td>2024-2025</td><td>39</td><td>1</td><td>38</td></tr></table> <i>Vizita në institucion; Takimi në sekretarinë mësimore; RVB;</i>	Viti akademik	Nr i të regjistruarve	Nr i të ç’regjistruarve	Nr aktual	2020-2021	31	6	25	2021-2022	40	5	35	2022-2023	31	3	28	2023-2024	38	2	36	2024-2025	39	1	38
Viti akademik	Nr i të regjistruarve	Nr i të ç’regjistruarve	Nr aktual																						
2020-2021	31	6	25																						
2021-2022	40	5	35																						
2022-2023	31	3	28																						
2023-2024	38	2	36																						
2024-2025	39	1	38																						
Kriteri 3. Të dhënat statistikore të studentëve duhet të menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.	Sipas raportit të vlerësimit të brendshëm (RVB), deklarimeve të drejtueseve të Fakultetit dhe Departamentit, dhe personelit akademik të angazhuar, vërehet se, përmes sistemit Moodle apo programit të avancuar excel, institucioni i disponon statistikën në çdo kohë. Po ashtu, kanë deklaruar se kanë hartuar strukturën e një sistemi të përgjithshëm menaxhimi, i cili së shpejti do të fillojë të ndërtohet. Sistemi i ri do të ketë të integruar të gjithë komponentët e menaxhimit institucional. <i>Vizita në institucion; Takimi në sekretarinë mësimore; RVB;</i>																								
Kriteri 4. Institucioni mbështet me akte, kontrollin periodik pranë gjithë njësive përgjegjëse për menaxhimin (sekretaritë mësimore, sistemin e menaxhimit të brendshëm të informacionit, etj.), vlerëson dhe dokumenton gjendjen dhe saktësinë e informacionit	Sipas raportit të vlerësimit të brendshëm (RVB), deklarimeve të drejtueseve të Fakultetit dhe Departamentit, dhe personelit akademik të angazhuar, vërehet se, institucioni mbështetur në akte, kryen kontroll periodik të përvitshëm pranë gjithë njësive përgjegjëse për menaxhimin (sekretaritë mësimore, sistemin e menaxhimit të brendshëm të informacionit, etj.). Po ashtu, vlerëson dhe dokumenton gjendjen dhe saktësinë e informacionit dhe të dokumentacionit që lidhet me studentët, dhe me veprimtarinë e tyre përkatëse.																								

dhe të dokumentacionit që lidhet me studentët, dhe me veprimtarinë e tyre përkatëse.	<i>Evidenca: Statuti i UET;</i> <i>Rregullore e UET-së;</i> <i>7. Rregullore e programit të studimit DIND - shqip.pdf;</i> <i>8. Dokumenti F.VII Mbi sigurimin e brendshëm të cilësisë.pdf; 30.2.1. Vendim Senati Nr. 03.1, date. 27.10.2017, Vendim per miratimin e strategjise dhe manualit te cilesise.pdf;</i>			
Kriteri 5. Njësia bazë duhet të hartojë raporte analitike, periodike, mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.	Sipas raportit të vlerësimit të brendshëm (RVB), deklarimeve të drejtuesve të Fakultetit dhe Departamentit, dhe personelit akademik të angazhuar, vërehet se, është hartuar raport analitik, mbi profilin dhe cilësinë në hyrje të studentëve, si dhe shkallën e ndërmjetësimit të tyre për punësim, apo perfitimeve të tjera. <i>Evidencat: 27. Cilësia në hyrje PIND DREJTESI.pdf;</i> <i>38. Analiza e departamentit përgjegjës mbi arritjen e objektivave formuese të programit të studimit.pdf;</i>			
Konkluzione	<i>Institucioni mban dokumentacionin që lidhet me statistikat vjetore për numrin e studentëve të regjistruar, transferuar, cilësinë në hyrje apo të dhëna të tjera të nevojshme.</i> <i>Të dhënat statistikore të studentëve menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit, janë të sigurt dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar, duke siguruar respektimin e konfidencialitetit dhe mbrojtjen e të dhënave personale.</i> <i>Departamenti përgjegjës për këtë program studimi analizon në mënyrë periodike të dhënat mbi cilësinë në hyrje dhe në dalje të studentëve, punësimin e tyre, duke nxjerrë rekomandimet në funksion të rritjes së cilësisë së programit.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.5

Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programit të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë institucionit.	Bazuar në Statutin e UET, dhe rregullore të tjera, studentët përfshihen në disa struktura drejtuese me karakter mësimor-kërkimor dhe shërbime. Në rastin e programit në fjalë; marrin pjesë në mbledhjet e departamentit, kemi një student KSBC, etj. Dokumentacioni shoqërues tregon se UET është në zbatueshmëri të Ligjit 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në IAL në Republikën e Shqipërisë”, dhe garanton se në të ardhmen, me konsolidimin e programit, studentët kanë të drejtë të përfaqësohen në Senatin Akademik, në Komisionin e Etikës, etj. <i>Ev. 55.2. D.III Mbi përfshirjen e studentëve në qeverisjen e UET.pdf;</i>
Kriteri 2. Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.	Krahas detyrimeve të përcaktuara në Statut dhe Rreguloren e UET, institucioni përdor disa forma të përfshirjes së studentëve në vlerësimin e procesit akademik përmes pyetësorësh në përfundim të çdo semestri. Nga shqyrtimi i disa modeleve pyetësorësh GVJ konstaton se studentëve Ju kërkohet të vlerësojnë lëndët e zhvilluara, - lidhja e tyre ose jo me programin; realizimin e orëve mësimore; vlerësimin e performancës së personelit akademik, vlerësimin e materialeve mësimore, etj. <i>Evidenca: Statuti i UET; Rregullore e UET-së;</i> <i>7. Rregullore e programit të studimit DIND - shqip.pdf;</i> <i>8. Dokumenti F.VII Mbi sigurimin e brendshëm të cilësisë.pdf; 30.2.1. Vendim Senati Nr. 03.1, date. 27.10.2017, Vendim per miratimin e strategjise dhe manualit te cilesise.pdf;</i>
Kriteri 3. Njësia përgjegjëse garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributin e tyre në to, në mbledhje të përbashkëta në departament,	Përfshirjen e studentëve në procesin e rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit në bazë të rregullt vihet re në, realizimin e pyetësorit që iu bëhet studentëve në fund të çdo semestri mbi lëndën, pedagogun apo praktikën. Në këto pyetësorë, ka disa pyetje si: “Si e vlerësoni ju cilësinë e prezantimit të leksioneve/ seminareve/etj”. Në këtë rubrikë studentët nëpërmjet pyetjeve të shtruar në pyetësor japin mendimet e tyre lidhur me: - Sa të dobishme janë materialet lëndore; - Qartësia e mënyrës së shpjegimit të leksioneve; - Qartësia e mënyrës së shpjegimit të seminareve/ushtimeve;

me pyetësorë, grupe fokusimi, etj.	- Vlerësimi i rregullsisë së mësimi; - Gadishmërinë e pedagogut për tu shpjeguar për pyetjet në lidhje me procesin mësimor; - Mardhëniën e pedagogut në lidhje me kodin e etikës; Po ashtu, ky pyetësor ka edhe një rubrike <i>Sugjerim</i>, ku studentit i kërkohet të japë sqarime shtese, për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies. <i>Evidenca: Statuti i UET; Rregullore e UET-së;</i> <i>7. Rregullore e programit të studimit DIND - shqip.pdf;</i> <i>8. Dokumenti F.VII Mbi sigurimin e brendshëm të cilësisë.pdf; 30.2.1. Vendim Senati Nr. 03.1, date. 27.10.2017, Vendim për miratimin e strategjise dhe manualit te cilesise.pdf;</i> <i>40. G-III-4-2 Formati i vlerësimit të pedagogut nga studentët_online.pdf;</i> <i>32.2. B-I-4 Formulari i vetvlerësimit te praktikës (nga Studenti).pdf;</i>
Kriteri 4. Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit dhe kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimit të rezultetit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës.	Gjatë vizitës në institucion dhe takimit me studentët si dhe nga kqyrja e dokumentacionit vërehet se studentëve u mundësohet transparenca dhe barazia në procesin e vlerësimit dhe kontrollit të dijeve. Sipas kësaj procedure, studenti realizon ankesën pas shpjegimeve përkatëse gjatë seancës sqaruese me pedagogun e lëndës. Studenti mund t'i drejtojë Përgjegjësit të Departamentit një kërkesë me shkrim, për rivlerësimin e komponentit përkatës në tezë. Drejtuesi i njësisë bazë ose Dekani, kur pedagogu i lëndës është vetë drejtuesi i njësisë, ngre një komision të përbërë nga pedagogë, për shqyrtimin e kërkesës dhe për rivlerësimin e komponentit të ankimit, etj. <i>Ev. 7. Rregullore e programit të studimit DIND - shqip.pdf;</i>
Konkluzione	<i>UET përfshin dhe angazhon edhe studentët e këtij programi në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programit të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.</i> <i>Studentët përfshihen në këshillim, sugjerim për rishikim dhe përmirësim të programit të studimit kryesisht bazuar në përpunimin e të dhënave të pyetësorëve nga NJSBC.</i> <i>Studentët kanë të drejtën e ankimit për shkelje të rregullave gjatë zhvillimit të provimit dhe për vlerësimin në provim.</i>

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.6

Institucioni i arsimit të lartë ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimimeve e problematikave, të cilat ushtrojnë veprimtarinë në mënyrë të përhershme e janë lehtësisht të arritshme nga studentët.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të institucionit.	Strukturat përkatëse që realizojnë informimin e studentëve janë sekretaria mësimore, zyra e Këshillimit të Karrierës dhe Kujdesit ndaj Studentit, koordinatori i programit, të cilët ofrojnë shërbim ditor të nevojave për shërbime nga ana e studentëve. <i>Ev. 12. Dokumenti E.VII Mbi funksionimin e Zyrës së Këshillimit të Karrierës dhe Kujdesit ndaj Studentit.pdf;</i> <i>36. Shembull Vendimi për Koordinatorin e Programit.pdf;</i> <i>36.1. Për përcaktimin e detyrave të koordinorit të programit.pdf;</i>
Kriteri 2. Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.	Rolin e njësisë për këshillimin e karrierës e luan zyra e këshillimit të karrierës, e cila zhvillon veprimtarinë e saj mbështetur në Ligjin e Arsimit të Lartë, Statutin dhe Rregulloret e tjera të UET. Format e shërbimit që ofron për studentë janë Informin dhe Orientim profesional siç është informimi për praktika profesionale, mundësi punësimi apo mundësi trajnimi. <i>Ev. 12. Dokumenti E.VII Mbi funksionimin e Zyrës së Këshillimit të Karrierës dhe Kujdesit ndaj Studentit.pdf;</i> <i>36. Shembull Vendimi për Koordinatorin e Programit.pdf;</i> <i>36.1. Për përcaktimin e detyrave të koordinorit të programit.pdf;</i>
Kriteri 3. Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe	GVJ konstaton se shërbimi i këshillimit të karrierës për studentët e UET ofrohet nga Zyra e Këshillimit të Karrierës dhe Kujdesit ndaj Studentit, dhe në nivel program studimi nga Koordinatorin për Programin e studimit. Nëpërmjet organizimit të aktiviteteve të ndryshme si: trajnime me fokus përgatitjen për intervistë pune, panairin e punës, leksione të hapura (me të ftuar) me

periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.	përfaqësues nga bota akademike, përdorimin e faqes web të UET, etj, duke synuar rritjen e pjesëmarrjes aktive, të promovimit të studentëve, si dhe të rritjen e mundësive të punësimit të tyre. Gjatë vizitës me përfaqësues të kësaj njësie dhe në takimin me studentët e programit mësuam për orientimin që kjo njësi u jep studentëve për realizimin e praktikave profesionale në institucionet vendase dhe te huaja. <i>Ev. 12. Dokumenti E.VII Mbi funksionimin e Zyrës së Këshillimit të Karrierës dhe Kujdesit ndaj Studentit.pdf;</i> <i>36. Shembull Vendimi për Koordinatorin e Programit.pdf;</i> <i>36.1. Për përcaktimin e detyrave të koordinatorit të programit.pdf;</i>			
Kriteri 4. Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse.	Pavarësisht se, ky program studimi është në fillimet e tij vërehet se, institucioni garanton infrastrukturën e nevojshme për zhvillimin e praktikave apo punësimin në institucion apo jashtë tij, sikurse ka lidhur marrëveshje bashkëpunimi me institucione dhe organizata të ndryshme, ku parashikohet edhe bashkëpunimi në funksion të kryerjes së praktikave profesionale të studentëve, por dhe ka përcaktuar edhe dokumentacionin e fillimit, zhvillimit dhe përmbylljes me sukses të praktikës			
Konkluzione	<i>Institucioni garanton infrastrukturën e nevojshme për zhvillimin e praktikave apo punësimin në institucion apo jashtë tij, sikurse ka lidhur marrëveshje bashkëpunimi me institucione dhe organizata të ndryshme, ku parashikohet edhe bashkëpunimi në funksion të kryerjes së praktikave profesionale të studentëve, por dhe ka përcaktuar edhe dokumentacionin e fillimit, zhvillimit dhe përmbylljes me sukses të praktikës.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
---	-----------------------	------------------------------	-----------------------------	------------------------------

				X
--	--	--	--	---

VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi VI.1

Institucioni i arsimit të lartë ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/moduleve.	Veprimtaria e UET mbështetet nga strukturat akademike dhe administrative të tij, sipas detyrave dhe përgjegjësi të mirëpërcaktuara në aktet e brendshme rregullatore të funksionimit të tij. UET ka përcaktuar modalitetet dhe procedurën përmes të cilave realizohet sigurimi i cilësisë dhe ndjekja periodike e vlerësimit të veprimtarive të kryera akademike, në përmbushje të standardeve të kërkuara. Institucioni monitoron dhe vlerëson periodikisht programet që ofron dhe garanton se janë përmbushur objektivat e tyre si dhe nevojat e studentëve. Këto vlerësime duhet të çojnë në përmirësimin e vazhdueshëm të këtyre programeve. Përmes dokumentave të hartuar, përcaktohen formatet dhe mënyrat e hartimit të syllabuseve, të vlerësimeve të ndryshme, të përdorimit të platformës Learning Management System, si dhe organizohen trajnime të personelit akademik, duke synuar kështu metoda inovative të mësimdhënies. <i>Evidenca: Statuti i UET; Rregullore e UET-së;</i> <i>7. Rregullore e programit të studimit DIND - shqip.pdf;</i> <i>8. Dokumenti F.VII Mbi sigurimin e brendshëm të cilësisë.pdf; 30.2.1. Vendim Senati Nr. 03.1, date. 27.10.2017, Vendim per miratimin e strategjise dhe manualit te cilesise.pdf;</i>
Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe	Referuar RVB-së, vlerësimi i procesit të mësimdhënies realizohet, në mënyrë periodike gjatë vitit. Ky vlerësim synon përmirësimin dhe rritjen e cilësisë të procesit të mësimdhënies. Procesi i vlerësimit realizohet nëpërmjet metodave direkte dhe të tërthorta të tilla si pyetësorët që ruajnë anonimin e studentëve, focus grupet, ndjekja e mësimdhënies në auditor nga

inovative të personelit akademik dhe ndihmës akademik.	drejtuesi i departamentit ose një profesor i fushës, etj, për të gjitha lëndët dhe personelin akademik që aktivizohet në këtë program studimi. Për sigurimin e brendshëm të cilësisë vepron Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NJSBC) konform kërkesave të Ligjit nr. 80/2015, “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, si dhe në përputhje me aktet e brendshme rregullatore të UET-së. Sistemi i sigurimit të brendshëm të cilësisë mbështetet në garantimin e pjesëmarrjes së personelit akademik dhe të studentëve në procesin e vetëvlerësimit dhe në përfitimin prej ekspertizës së jashtme për sigurimin e cilësisë. <i>Evidenca: Statuti i UET; Rregullore e UET-së;</i> <i>7. Rregullore e programit të studimit DIND - shqip.pdf;</i> <i>8. Dokumenti F.VII Mbi sigurimin e brendshëm të cilësisë.pdf; 30.2.1. Vendim Senati Nr. 03.1, date. 27.10.2017, Vendim per miratimin e strategjise dhe manualit te cilesise.pdf;</i> <i>40. G-III-4-2 Formati i vlerësimit të pedagogut nga studentët_online.pdf;</i> <i>40.1. Shembull_Vlerësimi nga studentët online.pdf;</i> <i>40.2.D-VI-3-3 Formular per ankesat e studenteve .pdf;</i>
Kriteri 3. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimeve.	Institucioni vlerëson në mënyrë periodike cilësinë, përmes instrumentave të adoptuar për këtë qëllim, duke përfshirë këtu edhe studentët. Për këtë, UET përfshin edhe studentët në vlerësimin periodik, të formave e metodave të mësimdhënies dhe të vlerësimit të dijeve. Studentët kryejnë vlerësimin çdo fund semestri nëpërmjet sistemit LMS, duke ruajtur anonimin e tyre si dhe nëpërmjet fokus-grupeve. Gjithashtu, studentët bëhen pjesë e mbledhjeve të hapura të Departamentit, ku mund të shprehin mendimet dhe shqetësimet e tyre, në lidhje me procesin e mësimdhënies apo shqetësime të tjera që mund të ngrihen. <i>Evidenca: Statuti i UET;</i> <i>Rregullore e UET-së;</i> <i>7. Rregullore e programit të studimit DIND - shqip.pdf;</i>

	8. Dokumenti F.VII Mbi sigurimin e brendshëm të cilësisë.pdf; 30.2.1. Vendim Senati Nr. 03.1, date. 27.10.2017, Vendim per miratimin e strategjise dhe manualit te cilesise.pdf; 40. G-III-4-2 Formati i vlerësimit të pedagogut nga studentët_online.pdf; 40.1. Shembull_Vlerësimi nga studentët online.pdf; 40.2.D-VI-3-3 Formular per ankesat e studenteve .pdf;
Kriteri 4. Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.	Politika për sigurimin e cilësisë e UET-së është transparente dhe ndikon në punën e përditshme të vlerësuesve dhe në cilësinë e raporteve të vlerësimit që ata hartojnë. Hartimi dhe ndryshimi i politikës për sigurimin e cilësisë është po ashtu një proces gjithëpërfshirës, i hapur dhe transparent për të interesuarit, përfshi edhe studentët. Rezultatet që merren prej procesit të vlerësimit të cilësisë përpunohen nga KSBC, nga zyra e IT në rastin e vlerësimeve online dhe më pas i komunikohen autoriteteve drejtuese të UET, si edhe anëtarëve të personelit akademik nga Drejtuesi i Departamentit. Departamenti, ku është nevoja, analizon rezultatet dhe merr masa për përmirësimet e nevojshme. <i>Evidenca: Statuti i UET;</i> <i>Rregullore e UET-së;</i> <i>7. Rregullore e programit të studimit DIND - shqip.pdf;</i> <i>8. Dokumenti F.VII Mbi sigurimin e brendshëm të cilësisë.pdf; 30.2.1. Vendim Senati Nr. 03.1, date. 27.10.2017, Vendim per miratimin e strategjise dhe manualit te cilesise.pdf;</i>
Kriteri 5. Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.	Politika për sigurimin e cilësisë është një proces që përfshin: rishikimin, përditësimin e parimeve, të standardeve, të treguesve, përmirësimin e sistemit të menaxhimit të cilësisë, të procedurave të vlerësimit, përditësimin dhe përmirësimin e udhëzimeve dhe të instrumenteve të monitorimit dhe të vlerësimit. Në këtë proces, institucioni synon të promovojë praktikën e mira dhe përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies. Të dhënat e përftuara nga vlerësimet periodike shërbejnë jo vetëm për analizimin e situatës, por edhe për identifikimin e problematikave me synim marrjen e masave për përmirësimin dhe garantimin e cilësisë së brendshme.
Konkluzione	UET ka përcaktuar modalitetet dhe procedurën përmes të cilave realizohet sigurimi i cilësisë dhe ndjekja periodike e vlerësimit

	të veprimtarive të kryera akademike, në përmbushje të standardeve të kërkuara. UET monitoron dhe vlerëson periodikisht programet që ofron dhe garanton se janë përmbushur objektivat e tyre si dhe nevojat e studentëve. Institucioni garanton edhe përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik, të formave e metodave të mësimdhënies dhe të vlerësimit të dijeve. Këto vlerësime shërbejnë në përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit, si dhe të promovohen praktikatat e mira dhe përmirësimi i mëtejshëm i mësimdhënies.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.2

Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.	UET ka tashmë të ngritur dhe funksional Sistemin e tij të Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë si dhe ka adoptuar procedurat dhe instrumentat përkatës për këtë qëllim. Komisioni i Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (KSBC) është organ kolegjal, autonom, që vepron në nivel institucioni dhe është struktura përgjegjëse për garantimin e standardeve të cilësisë të institucionit dhe programeve të studimit. Kjo njësi vlerëson periodikisht rezultatet e veprimtarive mësimore dhe kërkimore-shkencore. Programet e studimit që ofrohen në nivel njësie bazë/kryesore rishikohen në nivel të brendshëm të kësaj njësie për t'i përshtatur ato me nevojat specifike të këtij program studimi dhe me nevojat e tregut të punës. Sigurimi i Brendshëm i Cilësisë synon garantimin e cilësisë gjatë ushtrimit të veprimtarive akademike, kërkimore, kulturore, shoqërore të personelit akademik dhe të studentëve, si edhe veprimtarive administrative dhe financiare të UET.

	<i>Evidenca: 30. Të dhëna për anëtarët e KSBC.pdf;</i> <i>30.1. Plani veprimit KSBC.pdf;</i> <i>30.4. Vendim Senati mbi përbërjen e KSBC.pdf;</i> <i>30.5. Metodologjia e punës së KSBC për Provimet.pdf;</i> <i>30.7. Shembull_Komunikime dhe shpërndarja e raportit të KSBC mbi provimet.pdf;</i>
Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur, mban në funksion Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.	UET ka gjithmonë në vëmendjen e tij përmirësimin e cilësisë së veprimtarisë mësimore dhe kërkimore-shkencore që ofron. Sigurimi i cilësisë është pjesë e politikave dhe strategjisë së përgjithshme të zhvillimit institucional. Strukturat përgjegjëse për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë janë: Strukturat hierarkike organizative (organet drejtuese dhe autoritetet) të UET. a) Zyra e Standardeve dhe Cilësisë, e cila kujdeset për hartimin, përditësimin dhe rishikimin e kuadrit rregullator të institucionit dhe procedurave, në përputhje me legjislacionin në fuqi, standardet e cilësisë dhe praktikën e mira kombëtare dhe ndërkombëtare, si edhe monitoron zbatueshmërinë e tyre nga strukturat dhe personeli i institucionit. b) Komisioni i Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë – KSBC, funksionon në nivel institucional, dhe bën vlerësimin e efikasitetit të veprimtarive që ushtrohen në UET, me synim përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë. Komisioni përbëhet nga Kryetari i Komisionit, një përfaqësues nga pedagogët e çdo Fakulteti, një përfaqësues nga personeli ndihmës akademik, ose administrativ, një përfaqësues nga Këshilli i Studentëve, si dhe të paktën një përfaqësues ekspert i jashtëm.
Kriteri 3. Institucioni përdor instrumentet dhe treguesit e duhur për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i jashtëm i cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë	UET ka realizuar tre procese vlerësimi të jashtëm në kuadër të akreditimit Institucional pranë ASCAL. - Vlerësimi i parë u bë në vitin 2009, ku UET u akreditua për 6 vite akademike, me Urdhër MASH nr. 246, datë 24.07.2009; - vlerësimi i dytë u bë në vitin 2017, ku UET u akreditua për 5 vite akademike, me vendim të Bordit të Akreditimit nr.12, datë 07.04.2017; - vlerësimi i tretë u bë në vitin 2023, ku UET u akreditua për për 4 vite akademike, me vendim të Bordit të Akreditimit nr.82, datë 22.09.2023; - Gjithashtu, UET ka marrë edhe akreditim institucional nga Quality Assurance Agency for Higher Education (QAA);

cilësinë në programin e studimit.	KSBC-ja, si strukturë e dedikuar, mban komunikim të rregullt me Agjencinë për Sigurimin e Cilësisë në Arsimin e Lartë (ASCAL) dhe Kryetari i KSBC-së është njëkohësisht edhe koordinatori institucional i UET për marrëdhëniet me ASCAL-in. KSBC-ja ka autonomi operative dhe akses në të dhënat e Institucionit. Për vlerësimin e jashtëm të cilësisë, programet e studimit i nënshtrohen procesit të akreditimit, në mënyrë periodike. Për këtë qëllim, institucioni bashkëpunon ngushtë me ASCAL. Rezultatet e KSBC publikohen përmes raporteve që i dërgohen Rektorit, Administritorit të UET, si dhe raporteve përkatëse që i dërgohen Dekanit dhe Përgjegjësit të Departamentit. KSBC-ja krijon dhe mban në vijimësi marrëdhënie me institucione pjesëmarrëse në Rrjetin Europian të Sigurimit të Cilësisë, të cilat pas vendimit të Rektoratit, mund të ftohen të zhvillojnë kontrollin e jashtëm të UET. Aktualisht UET ka akreditim institucional si dhe ka të akredituar programet e studimit që ofron përfshin dhe këtë program studimi.
Kriteri 4. Institucioni përdor tregues të qartë, të matshëm në mësimdhënie dhe kërkim, për pasqyrimin gjendjes, arritjeve dhe dobësive, të parashikuara dhe në aktet rregullatore institucionale. Mbi bazën e treguesve cilësorë, institucioni bën promovime nxitëse për arritjet më të mira në programin e studimit.	UET ka përcaktuar përgjegjësitë funksionale të strukturave dhe autoriteteve përgjegjëse për sigurimin e brendshëm të cilësisë në të gjitha nivelet. Ato kanë lirinë dhe autoritetin të identifikojnë problemet, të marrin nisma nëpërmjet hartimit të plan-veprimeve, të japin rekomandime dhe të paraqesin zgjidhje për çështje të cilësisë. Nëpërmjet strukturave të brendshme të Universitetit, është vënë në funksion një sistem që ofron performancë dhe i përgjigjet pyetjeve mbi saktësinë dhe eficientësinë e procedurave të sigurimit të cilësisë. Sistemi i sigurimit të brendshëm të cilësisë fokusohet në: kontrollin e cilësisë, llogaridhënien dhe përmirësimin. Fusha të vlerësimit të brendshëm në kuadër të sigurimit të cilësisë janë: - Programet e studimit dhe mësimdhënia - Studentët dhe arritjet e tyre - Personeli dhe performanca e tij - Kërkimi shkencor - Shërbimet për studentët - Menaxhimi i Institucionit.
Konkluzione	<i>UET ka të ngritur dhe funksional Sistemin e tij të Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë si dhe ka adoptuar procedurat dhe instrumentat përkatës për këtë qëllim. Sistemi i sigurimit të brendshëm të cilësisë fokusohet në: kontrollin e cilësisë, llogaridhënien dhe përmirësimin.</i> <i>Fusha të vlerësimit të brendshëm në kuadër të sigurimit të cilësisë janë: Programet e studimit dhe mësimdhënia; Studentët dhe arritjet e tyre; Personeli dhe performanca e tij; Kërkimi</i>

	<i>shkencor; Shërbimet për studentët; Menaxhimi i Institucionit. Sigurimi i cilësisë realizohet përmes përfshirjes së personelit akademik dhe atij ndihmës akademik, tërheqjes së mendimit të studentëve, të anëtarëve të Bordeve të Tregut të Punës si dhe bashkëpunimit me ASCAL-in dhe struktura të tjera shtetërore.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.3

Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programin e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënës.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen periodike të programit të studimit të ciklit të dytë, që i shërbejnë akreditimit të tij. Në këtë proces realizon evidentimin e arritjeve dhe dobësive, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe planin e masave për përmirësim. Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.	Raportet vjetore periodike i përcillën rektoratit të UET-së për hartimin e raportit vjetor institucional. KSBC harton një raport vjetor institucional ku përfshihen informacione dhe vlerësime për mësimdhënien dhe kërkimin shkencor në institucion, cilësinë e shërbimeve të ofruara për studentët si dhe rekomandon masa për përmirësimin e cilësisë. Ky raport i paraqitet Senatit Akademik. Në përfundim të çdo viti akademik, UET harton raportin e veprimtarisë mësimore e kërkimore-shkencore mbi analizën e programeve të studimit, ku përfshihet edhe ky program studimi që po riakreditohet. Ky raport miratohet nga senati akademik i UT, dhe gjithashtu i dërgohet MASR. UET me qëllim vlerësimin e cilësisë të veprimtarisë mësimore dhe të studentëve, zhvillon anketime/pyetsorë me studentët duke ruajtur anonimin. Po ashtu këto pyetsorë shërbejnë edhe për të marrë mendimin dhe feedback-un e studentëve për programin përkatës të studimit që ndjekin në funksion të përmirësimit të cilësisë së tij; zhvillon fokus-grupe me studentë si dhe vlerësime të ndryshme të stafit akademik dhe ndihmës akademik si dhe të shërbimeve që ofron institucioni. Të gjitha këto të dhëna përpunohen dhe përmbledhen në formën e një raporti periodik vlerësimi mbi shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e programeve të studimit, i cili u vihet në dispozicion strukturave drejtuese, por edhe pedagogëve, sikurse dhe aktorëve të tjerë të

	interesuar. Këto raporte janë pjesë e diskutimit/prezantimit në nivel institucional dhe në nivel department. <i>Evidencat: 30.7. Shembull Komunikime dhe shpërndarja e raportit të KSBC mbi provimet.pdf;</i>
Kriteri 2. Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë, si dhe motivimin e arritjeve më të mira në mësim dhe kërkim nga personeli akademik dhe studentët.	Raporti i vlerësimit përpilohet në fund të vitit akademik dhe paraqet të gjitha rezultatet e agreguara. Në mënyrë periodike, KSBC informon njësinë kryesore dhe përgjegjësin e departamentit rreth rezultateve të dala, me qëllim marrjen e masave për përmirësimin e vazhdueshëm të performancës së njësisë dhe stafit akademik në të ardhmen. Në përfundim të këtij procesi, hartohet një raport vjetor që analizon dhe bën një vlerësim të brendshëm të institutit dhe të programit të studimit, përkundrejt standardeve shtetërore të cilësisë. KSBC dhe strukturat e tjera të përfshira në sigurimin e brendshëm të cilësisë monitorojnë procesin e marrjes së masave në kuadër të adresimit të mangësive. Raportet e vlerësimit evidentojnë përputhshmërinë e aktiviteteve me aktet rregullatore dhe standardet e cilësisë. Të dhënat e monitorimeve dhe vlerësimeve të parashikuara në aktet e UET-së përdoren për: përgatitjen e raporteve të vlerësimit të brendshëm; për akreditimin; për përmirësimin e cilësisë së programeve të studimit, të mësimdhënies, të kërkimit, të shërbimeve dhe të menaxhimit; për planifikimin vjetor dhe strategjik të UET-së; për përmirësimin e performancës së personelit akademik, ndihmës akademik dhe administrative
Kriteri 3. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor, metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës,	UET në kuadër të vlerësimit, të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit, përdor disa metoda të drejtpërdrejta. Impakt të drejtpërdrejtë në sigurimin e cilësisë japin mendimet e studentëve të shprehura në pyetësorët që organizohen për këtë qëllim në fund të çdo semestri, nga ku merret mendimi i studentëve mbi programin e studimit në tërësi, mbi çdo lëndë të veçantë dhe çdo pedagog që angazhohet në auditor në procesin e mësimdhënies, cilësinë e mësimdhënies dhe syllabuset, etj. Institucioni përdor disa metoda të dpd, si: teste të standardizuara; dëgjime në auditor (veçanërisht për stafin e ri të kategorisë lektor/asistent-lektor); vlerësimi me pikë; testime paraprake dhe përfundimtare; vlerësimi i detyrave të kryera nga studentët; vlerësim i praktikës.

testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndërinstitutionale apo kombëtare, si: provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.	Të dhënat e përftuara nga sa më sipër, pas përpunimit statistikor dhe cilësor, shfrytëzohen në mbështetje të procesit të vlerësimit të performancës akademike të secilit pedagog në përfundim të vitit akademik, si dhe në lidhje me lëndët e programit që ndjekin, por edhe të kurseve që ofrohen. Në raportet vjetore të njësisë evidentohen dhe rezultat e vlerësimit për programin që dalin nga format e ndryshme direkte dhe indirekte të vlerësimit të mësimdhënies. Departamenti bashkëpunon me KSBC në këtë drejtim. GJV gjatë vizitës në institucion u njoh me këtë proces vlerësimi dhe diskutoi për aspekte të caktuara të vlerësimit mbi cilësinë e programit të studimit që është objekt i këtij akreditimi. <i>Evidenca: 30. Të dhëna për anëtarët e KSBC.pdf;</i> <i>30.1.Plani veprimit KSBC.pdf;</i> <i>30.4.Vendim Senati mbi përbërjen e KSBC.pdf;</i> <i>30.5. Metodologjia e punës së KSBC për Provimet.pdf;</i> <i>30.7. Shembull_Komunikime dhe shpërndarja e raportit të KSBC mbi provimet.pdf</i>
Kriteri 4. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi, si: sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuar (alumni), të personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përftuara nga ky program.	Institucioni nëpërmjet KSBC-së përdor edhe metoda të tërthorta vlerësimi, si: sondazhe/pyetsorë të studentëve që ndjekin programet e studimeve apo të diplomuar; pyetsorë/sondazhe të vlerësimit të didaktikës, kurrikulës, mbi vlerësimin e mësimdhënies, procesit mësimor, infrastrukturës etj; raport vetvlerësimi nga stafi akademik i përfshirë në programin e studimit. Po ashtu këto instrumenta shërbejnë edhe për të marrë mendimin dhe feedback-un e studentëve për programin përkatës të studimit që ndjekin në funksion të përmirësimit të cilësisë së tij. Rezultatet e tyre i vihen në dispozicion autoriteteve drejtuese të institucionit, të fakulteteve si dhe reflektohen në vlerësimin e performancës së çdo pedagogu në përfundim të vitit akademik. <i>Evidenca: 30. Të dhëna për anëtarët e KSBC.pdf;</i> <i>30.1.Plani veprimit KSBC.pdf;</i> <i>30.4.Vendim Senati mbi përbërjen e KSBC.pdf;</i> <i>30.5. Metodologjia e punës së KSBC për Provimet.pdf;</i> <i>30.7. Shembull_Komunikime dhe shpërndarja e raportit të KSBC mbi provimet.pdf;</i>

Konkluzione	<i>UET me qëllim vlerësimin e cilësisë të veprimtarisë mësimore dhe të studentëve, zhvillon anketime/pyetsorë me studentët duke ruajtur anonimin. Po ashtu këto pyetsorë shërbejnë edhe për të marrë mendimin dhe feedback-un e studentëve për programin përkatës të studimit që ndjekin në funksion të përmirësimit të cilësisë së tij; zhvillon fokus-grupe me studentë si dhe vlerësime të ndryshme të stafit akademik dhe ndihmës akademik si dhe të shërbimeve që ofron institucioni.</i> <i>Të gjitha këto të dhëna përpunohen dhe përmbledhen në formën e një raporti periodik vlerësimi mbi shqyrtimin, miratimin dhe mbikqyrjen e programeve të studimit, i cili u vihet në dispozicion strukturave drejtuese, por edhe pedagogëve, sikurse dhe aktorëve të tjerë të interesuar. Këto raporte janë pjesë e diskutimit/prezantimit në nivel institucional dhe në nivel departamenti.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.4

Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, personelin akademik e studentët në proceset e SBC-së të programit të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni duhet të parashikojë dhe të garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuara për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.	Vërehet se, institucioni të mbledh mendime e të dhëna nga aktorë të ndryshëm, si dhe përqendrohet në përvojën e studentit dhe se si janë adresuar çështjet specifike të ngritura gjatë një viti akademik, me qëllim përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së programit të studimit. Si edhe ka gjithmonë në vëmendjen e tij përmirësimin e cilësisë së veprimtarisë mësimore dhe kërkimore-shkencore që ofron, dhe sigurimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së programit të studimit, ku merr parasysh mendimin e aktorëve të brendshëm por edhe të jashtëm që shprehet në Bordet e Tregut të Punës dhe ekspertin e jashtëm si pjesë e KSBC-së. <i>Evidenca: 30. Të dhëna për anëtarët e KSBC.pdf;</i>

	30.1. <i>Plani veprimit KSBC.pdf;</i> 30.4. <i>Vendim Senati mbi përbërjen e KSBC.pdf;</i> 30.5. <i>Metodologjia e punës së KSBC për Provimet.pdf;</i> 30.7. <i>Shembull_Komunikime dhe shpërndarja e raportit të KSBC mbi provimet.pdf;</i>
Kriteri 2. Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.	Organet, autoritetet dhe strukturat konkrete të përfshira në sigurimin e brendshëm të cilësisë, detyrat dhe përgjegjësitë e tyre janë përcaktuar në aktet e brendshme rregullatore të institucionit, në Statutin dhe Rregulloren e UET-së, dhe në dokumentat që lidhen me sigurimin e cilësisë në UET. Sistemi i sigurimit të brendshëm të cilësisë përbëhet nga organe, autoritete dhe struktura në nivel institucional dhe të njëjve kryesore. Sistemi i sigurimit të brendshëm të cilësisë fokusohet në: kontrollin e cilësisë, llogaridhënien dhe përmirësimin e cilësisë. <i>Evidenca: 30. Të dhëna për anëtarët e KSBC.pdf;</i> 30.1. <i>Plani veprimit KSBC.pdf;</i> 30.4. <i>Vendim Senati mbi përbërjen e KSBC.pdf;</i> 30.5. <i>Metodologjia e punës së KSBC për Provimet.pdf;</i> 30.7. <i>Shembull_Komunikime dhe shpërndarja e raportit të KSBC mbi provimet.pdf;</i>
Kriteri 3. Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohej përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarëve të personelit akademik, ndihmës akademik e administrative dhe studentëve të programit të studimit.	Për sigurimin e cilësisë, UET ka ngritur strukturat përkatëse që shkojnë deri në nivel njësie kryesore e bazë, që merren me monitorimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, nëpërmjet përdorimit të instrumentave të duhur, gjithmonë në përputhje me Rregulloren e UET-së dhe dokumentat për sigurimin e cilësisë në UET. Vlerësimi zhvillohet në bashkëpunim me struktura të caktuara institucionale dhe në këtë proces përfshihen edhe anëtarët e personelit akademik, ndihmës akademik e administrativ dhe studentët e programit të studimit. <i>Evidenca: 30. Të dhëna për anëtarët e KSBC.pdf;</i> 30.1. <i>Plani veprimit KSBC.pdf;</i> 30.4. <i>Vendim Senati mbi përbërjen e KSBC.pdf;</i> 30.5. <i>Metodologjia e punës së KSBC për Provimet.pdf;</i> 30.7. <i>Shembull_Komunikime dhe shpërndarja e raportit të KSBC mbi provimet.pdf;</i>

Kriteri 4. Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.	Vlerësimi është transparent, siguron të dhëna të vlefshme dhe respekton integritetin akademik të personelit akademik apo studentëve. Politika për sigurimin e cilësisë e UET-së është transparente, publike dhe ndikon në punën e përditshme të vlerësuesve dhe në cilësinë e raporteve të vlerësimit që ata që i hartojnë. KSBC ngrihet në nivel universiteti dhe Komisioni përbëhet nga Kryetari i Komisionit, një përfaqësues nga pedagogët e çdo Fakulteti, një përfaqësues nga personeli ndihmës akademik, ose administrativ, një përfaqësues nga Këshilli i Studentëve, si dhe të paktën një përfaqësues ekspert i jashtëm. Në përzgjedhjen e anëtarëve merren parasysh kriteret e mëposhtme: a. Kompetencat profesionale; b. Cilësitë personale (si ndershmëria, korrektesa, serioziteti, përgjegjshmëria, etj); c. Ngarkesa mësimore apo ngarkesa me kryerjen e funksioneve të tjera administrative; d. Eksperiencia e mëparshme në detyrë të njëjtë apo të përafërt; e. Të mos jenë pjesë e autoriteteve drejtuese të UET-it. <i>Evidenca: 30. Të dhëna për anëtarët e KSBC.pdf;</i> 30.1.Plani veprimit KSBC.pdf; 30.4.Vendim Senati mbi përbërjen e KSBC.pdf; 30.5. Metodologjia e punës së KSBC për Provimet.pdf; 30.7. Shembull Komunikime dhe shpërndarja e raportit të KSBC mbi provimet.pdf;
Kriteri 5. Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë, duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime të vryera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj.	Për përmirësimin e cilësisë së veprimtarisë mësimore dhe kërkimore-shkencore që ofron dhe për sigurimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së programit të studimit institucioni merr parasysh mendimin e aktorëve të brendshëm por edhe të jashtëm që shprehet në: Bordin e Tregut të Punës që funksionon pranë Departamentit të Shkencave Juridike dhe ekspertit të jashtëm si pjesë e KSBC-së. Në mbledhjet e këtij Bordi të Tregut të Punës ndër të tjera është trajtuar edhe aspekte mbi tematikën “Ngritja e Cilësisë në Kurrikulat e Programeve të Drejtësisë”. <i>Evidenca: 30. Të dhëna për anëtarët e KSBC.pdf;</i> 30.1.Plani veprimit KSBC.pdf; 30.4.Vendim Senati mbi përbërjen e KSBC.pdf;

	30.5. Metodologjia e punës së KSBC për Provimet.pdf; 30.7. Shembull_Komunikime dhe shpërndarja e raportit të KSBC mbi provimet.pdf;			
Konkluzione	UET ka gjithmonë në vëmendje përmirësimin e cilësisë së veprimtarisë mësimore dhe kërkimore-shkencore që ofron dhe sigurimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së programit të studimit ku merr parasysh mendimin e aktorëve të brendshëm por edhe të jashtëm që shprehet në Bordet e Tregut të Punës dhe ekspertin e jashtëm si pjesë e KSBC-së. Sistemi i sigurimit të brendshëm të cilësisë përbëhet nga organe, autoritete dhe struktura në nivel institucional dhe të njësive kryesore/bazë. Sistemi i sigurimit të brendshëm të cilësisë fokusohet në: kontrollin e cilësisë, llogaridhënien dhe përmirësimin e cilësisë.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.5

Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.	Politika për sigurimin e cilësisë e UET-së është transparente dhe ndikon në punën e përditshme të vlerësuesve dhe në cilësinë e raporteve të vlerësimit që ata hartojnë. Hartimi dhe ndryshimi i politikës për sigurimin e cilësisë është po ashtu një proces gjithëpërfshirës, i hapur dhe transparent për të interesuarit, përfshi edhe studentët dhe synon krijimin e një tabloje të qartë dhe reale rreth gjendjes aktuale të UET-së. Ngritja e sistemit të brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe krijimi i kulturës së cilësisë në institucion është po ashtu qëllim i politikave dhe strategjisë së UET-së në lidhje me cilësinë; garantimi i transparencës me qëllim informimin e të gjithë partnerëve dhe publikut të gjerë për performancën e UET-it, njësive të tij, programeve, kurrikulave, shërbimeve etj.

	<i>Evidenca: 30. Të dhëna për anëtarët e KSBC.pdf;</i> <i>30.1.Plani veprimit KSBC.pdf;</i> <i>30.4.Vendim Senati mbi përbërjen e KSBC.pdf;</i> <i>30.5. Metodologjia e punës së KSBC për Provimet.pdf;</i> <i>30.7. Shembull_Komunikime dhe shpërndarja e raportit të KSBC mbi provimet.pdf;</i>
Kriteri 2. Institucioni i arsimit të lartë publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.	UET dhe njësitë kryesore kanë përgjegjësinë për komunikimin dhe për publikimin e rezultateve të monitorimit, të vlerësimit të programit të studimit. Komunikimi dhe publikimi i rezultateve të monitorimit, të vlerësimit dhe të akreditimit bëhet në përputhje me format e miratuara nga UET, duke e trajtuar në nivel njësie kryesore dhe bazë, e duke respektuar lirinë dhe etikën akademike dhe të dhënat personale, përsa vlejnjë. Sipas akteve rregullatore, UET publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë akademike, transparencën dhe etikën akademike, LAL dhe akteve të tjera rregullatore në fuqi. Në dokumentacionin e paraqitur, nuk ka një dokument të KSBC-së që lidhet me gjetjet e këtij programi studimi objekt riakreditimi, apo një analizë departamenti në lidhje me këto gjetje. <i>Evidenca: 30. Të dhëna për anëtarët e KSBC.pdf;</i> <i>30.1.Plani veprimit KSBC.pdf;</i> <i>30.4.Vendim Senati mbi përbërjen e KSBC.pdf;</i> <i>30.5. Metodologjia e punës së KSBC për Provimet.pdf;</i> <i>30.7. Shembull_Komunikime dhe shpërndarja e raportit të KSBC mbi provimet.pdf;</i>
Kriteri 3. Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.	Në përfundim të semestrit/vitit akademik, hartohet raporti mbi vlerësimet periodike dhe vjetore, në të cilin pasqyrohen rezultatet dhe bëhet një analizë e ecursisë së programeve të tij, me qëllim përmirësimin e mangësive dhe problemeve të vërejtura. Institucioni përfshin të dhënat që lidhen me studentët dhe vlerësimin, apo realizimin e objektivave në raportin e vlerësimit të brendshëm për programin e studimit dhe po ashtu pasqyrohen në raportin vjetor institucional që i paraqitet autoriteteve drejtuese.

	Në këto raporte pasqyrohen rezultatet dhe bëhet një analizë krahasimore për ndryshimet dhe ecurinë e të dhënave të shqyrtuara, me qëllim përmirësimin e mangësive dhe problemeve të vërejtura. Në dokumentacionin e paraqitur, nuk ka një dokument të KSBC-së që lidhet me gjetjet e këtij programi studimi objekt riakreditimi, apo një analizë departamenti në lidhje me këto gjetje. Formatet e pyetësorëve përpunohen përmes programit për vlerësimin online dhe i vihen në dispozicion drejtuesëve të Universitetit, si dhe në mënyrë të personalizuar për secilin pedagog. Të dhënat e fituara nga instrumentet e vetëvlerësimeve periodike, pas përpunimit shfrytëzohen gjerësisht në mbështetje të procesit të follow-up, që shërbejnë për vlerësimin e performancës akademike në fund të vitit. <i>Evidenca: 30. Të dhëna për anëtarët e KSBC.pdf;</i> 30.1.Plani veprimit KSBC.pdf; 30.4.Vendim Senati mbi përbërjen e KSBC.pdf; 30.5. Metodologjia e punës së KSBC për Provimet.pdf; 30.7. Shembull Komunikime dhe shpërndarja e raportit të KSBC mbi provimet.pdf;
Kriteri 4. Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe ndikimin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.	UET çdo vit harton një raport vjetor, ku synon të analizojë situatën dhe impaktin e veprimtarive në funksion të cilësisë, duke analizuar performancën dhe përmirësimin e vazhdueshëm të standarteve të cilësisë. Përdorimi i të dhënave të monitorimit dhe vlerësimit përdoret ndër të tjera për: përgatitjen e raporteve të vlerësimit të brendshëm, dhe akreditimin; për përmirësimin e cilësisë së programeve të studimit, të mësimdhënies, të kërkimit, të shërbimeve dhe të menaxhimit; për planifikimin vjetor dhe strategjik të UET-së; për përmirësimin e performancës së personelit akademik, ndihmësakademik dhe administrativ. Në kuadër të cilësisë, monitorimi sigurohet nga struktura dhe aktorë të brendshëm në UET, duke filluar nga departamenti, te strukturat e sigurimit të brendshëm të cilësisë në nivel institucional, Zyra e Standardeve dhe Cilësisë e KSBC. <i>Evidenca: 30. Të dhëna për anëtarët e KSBC.pdf;</i> 30.1.Plani veprimit KSBC.pdf; 30.4.Vendim Senati mbi përbërjen e KSBC.pdf; 30.5. Metodologjia e punës së KSBC për Provimet.pdf;

	30.7. Shembull_Komunikime dhe shpërndarja e raportit të KSBC mbi provimet.pdf;			
Kriteri 5. Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.	Në UET ka një komunikim të vazhdueshëm me stafin akademik dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin e cilësisë dhe përmirësimin e programeve të studimit. Janë organizuar në mënyrë periodike disa veprimtari me personelin akademik për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së programeve të studimit. Informacioni shpërndahet përmes rregulloreve, studentëve në struktura të ndryshme përfaqësuese, këshillit studentor, javës së orientimit, guidës UET. [Evidenca: 30. Të dhëna për anëtarët e KSBC.pdf; 30.1.Plani veprimit KSBC.pdf; 30.4.Vendim Senati mbi përbërjen e KSBC.pdf; 30.5. Metodologjia e punës së KSBC për Provimet.pdf; 30.7. Shembull_Komunikime dhe shpërndarja e raportit të KSBC mbi provimet.pdf;			
Konkluzione	<i>Ngritja e sistemit të brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe krijimi i kulturës së cilësisë në institucion është qëllim i politikave dhe strategjisë së UET-së në lidhje me cilësinë; garantimi i transparencës me qëllim informimin e të gjithë partnerëve dhe publikut të gjerë për performancën e UET, njërive të tij, programeve, kurrikulave, shërbimeve etj.</i> <i>Në UET ka një komunikim të vazhdueshëm me stafin akademik dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin e cilësisë dhe përmirësimin e programeve të studimit.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Përfundime të Vlerësimit të programit të integruar të studimit të ciklit të dytë “Master i Shkencave në Drejtësi”

a. Pikat e forta dhe afirmime:

1. Institucioni i arsimit të lartë përdor një sistem bashkohor të menaxhimit të informacionit, platforma LMS (Learning Management System), i cili siguron për personelin akademik dhe studentët e këtij programi një informim dhe komunikim cilësor e transparent, si dhe ndihmon në përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies;
2. Institucioni dhe njësia bazë (Departamenti i Shkencave Juridike) mbledh dhe shfrytëzon, nëpërmjet pyetësorëve on line, opinionin e studentëve për të përmirësuar aspekte të veçanta të programit të studimit;
3. Institucioni i arsimit të lartë (UET) ka lidhur marrëveshjeve të shumta bashkëpunimi me biznese, organizata, institucione publike etj., të cilat mundësojnë zhvillimin e praktikave dhe punësimin e studentëve;
4. Institucioni është në administrim të një infrastrukture të përshtatshme, me mjedise të mjaftueshme (salla për leksione, seminare, laboratorë, etj.), të pajisura konform standarteve bashkëkohore, me mjetet dhe paisjet e nevojshme për zhvillimin e procesit mësimor për programin e studimit PIND “Master i Shkencave në Drejtësi”;

b. Pika të dobta:

1. Angazhimi në procesin e mësimdhënies në këtë program studimi edhe të stafit akademik me Msc, ndërkohë që kërkohet që stafi akademik të ketë të paktën gradë shkencore (Dr), sipas parashikimit të nenit 59/6 të Ligjit nr. 80/2015 ku përcaktohet niveli i kualifikimit akademik; (*Standarti IV.1, Kriteri 1*)

Rekomandime

1. IAL-ja nuk duhet të angazhojë në mësimdhënie, për këtë program studimi, staf akademik qoftë si PAE apo si PAK, me kualifikimin “Master Shkencor”, pasi kjo bie ndesh me kërkesat e nenit 59, pika 6 Ligjit Nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”;
2. Departamenti dhe Zyra e Këshillimit të Karrierës dhe Kujdesit ndaj Studentit të marrin masa efektike, për të siguruar pjesëmarrjen e sa më shumë studentëve të programit të studimit PIND “Master i Shkencave në Drejtësi” në projektet ndërkombëtare, si dhe në mobilitete “Erasmus +”, etj;

3. Nga IAL të sigurohet mbështetje financiare promovuese për të nxitur sa më shumë studentë për të marrë pjesë në aktivitete e publikime shkencore;
4. Të krijohet një hapësirë e posaçme në ambjentet e godinës së Fakultetit të Shkencave Juridike, Politike dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare me infrastrukturën e nevojshme për të siguruar veprimtarinë e Klinikës Ligjore, si formë bashkëkohore e të mësuarit praktik e domosdoshme për studentët në programet e studimit në fushën e drejtësisë;
5. Të bëhet pjesë e dosjes së personelit ndihmës akademik/administrativ edhe formulari i vlerësimit institucional të performancës apo ai i vetëvlerësimit;

Evaluation's conclusions for the Integrated Program of Second Level (IPSL) "Master of Science in Law"

a. Strengths and affirmations:

1. The higher education institution (UET) uses a contemporary information management system, the LMS (Learning Management System) platform, which provides academic staff and students of this program with quality and transparent information and communication, and helps to improve the quality of teaching;
2. The institution and the basic unit (Department of Legal Sciences) collects and uses, through online questionnaires, student opinion to improve specific aspects of the study program;
3. The higher education institution (UET) has entered into numerous cooperation agreements with businesses, organizations, public institutions, etc., which enable the development of internships and the employment of students;
4. The institution is in the administration of an appropriate infrastructure, with sufficient facilities (lecture halls, seminars, laboratories, etc.), equipped by contemporary standards, with the necessary tools and equipment for the development of the teaching process for the Integrated Program of Second Level (IPSL) "Master of Science in Law";

b. Weaknesses:

1. Engagement in the teaching process in this study program also of academic staff with MSc. degree, while it is required that academic staff have at least a scientific degree (PhD), according to the provisions of Article 59/6 of Law No. 80/2015, which determines the level of academic qualification; (*Standard IV.1, Criterion 1.*)

Recommendations

1. The HEI should not engage academic staff (neither full time nor part-time) with the "Master of Science" qualification in teaching, as this conflicts with the requirements of article 59, par.6, of Law No. 80/2015 *"On higher education and scientific research in higher education institutions in the Republic of Albania"*;
2. The Department and the Office of Career Counseling and Student Care should take adequate measures to ensure the participation of as many students of the IPSL "Master of Science in Law" as possible in international projects, as well as in "Erasmus +" mobilities, etc;
3. The HEI should provide promotional financial support to encourage as many students as possible to participate in scientific activities and publications;
4. Create a special space in the premises of the Faculty of Law, Political Sciences, and International Relations building with the necessary infrastructure to ensure the activity of the **Legal Clinic** as a contemporary form of practical learning required for students in study programs in the field of justice;
5. Make the institutional performance evaluation form or self-evaluation form part of the support academic/administrative staff files;

Shkalla e përmbushjes së standardeve të cilësisë së programit

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Nuk përmbushen	Përmbushen pjesërisht	Përmbushen kryesisht	Përmbushen plotësisht
I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË CIKLIT TË DYTË				X
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT				X
IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				X
VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
VLERËSIMI TËRËSOR				X